
standardet
e përfaqësimit
në partitë politike

STANDARDET E PËRFAQËSIMIT NË PARTITË POLITIKE

Instituti i Studimeve Politike

Autor i studimit
Prof. Afrim Krasniqi

Stafi kontribues në studim
Dr. Klea Faniko, konsulente kryesore
Dr. Dorina Berdufi, eksperte për metodologjinë
Prof. Ervin Karamuço, ekspert për bazën ligjore
Dr. Edlira Gjoni, eksperte për media & fokus grupet
Msc. Lufti Dervishi, ekspert për media & fokus grupet
Msc. Silvana Jaupaj, eksperte për KQZ & sondazhin
Msc. Luljeta Progni, realizimi i intervistave
Dr. Arta Sakja, eksperte për politikat gjinore
Msc. Megi Llubani, eksperte për modelet ndërkombëtare
Msc. Rigels Xhemollari, koordinimi organizativ

Redaktore
Dr. Ada Hyso, kërkuese shkencore
Msc. Albana Veizi, kërkuese shkencore

Hedhja e të dhënave
Msc. Rudina Niklekaj
BA. Elba Krasniqi

Instituti i Studimeve Politike
Rr. Luigj Gurakuqi, Shk.A, Pall. 89, Kati 3, Ap.16
Tirana, Albania
Email contactaips@isp.com.al
www.isp.com.al

Të drejtat e publikimit
© Leja për të riprodhuar ose përkthyer të gjithë ose një pjesë të këtij studimi
duhet marrë vetëm nga UN Women Shqipëri dhe ISP.

UN Women Albania
Ma. Fiorela Shalsi, Drejtuese Kombëtare e Programit “Leadershipi
dhe Pjesëmarrja në Politikë”
Konceptuese e raportit dhe kontribuese në rishikimin nga
këndvështrimi gjinor

Raporti “Standardet e përfaqësimit në partitë politike” bazohet
në gjetjet para dhe gjatë zgjedhjeve parlamentare 2017. Ai
është përgatitur me mbështetjen teknike të Entit të Kombeve
të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN
Women) dhe është zbatuar nga Instituti i Studime Politike në
kuadër të programit “Leadershipi dhe Pjesëmarrja Politike”.
Ky program është financuar nga Qeveria Suedeze nëpërmjet
Fondit të Koherencës së Kombeve të Bashkuara dhe është
pjesë e “Programit të Bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së
Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2012-2016”.

Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë të
autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet
e UN Women, të Agjencive të Kombeve të Bashkuara apo të
Qeverisë Suedeze.

Faqosja dhe dizajno: Eduart Cani

Fotot: ISP

UN Women Country Office Albania
Rr. Skenderbej, Pall. 8, ap. 29-31, Tirana
Tirana, Albania
Tel: +355 4 450 2555 / 7575
Facebook: [unwomenalbania](https://www.facebook.com/unwomenalbania)

Copyright © UN Women
ISBN 978-9928-4418-2-9

PËRMBAJTJA E STUDIMIT

SHKURTIMET	4
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
2. GJETJET KRYESORE: BILANCI, PROBLEMATIKA DHE SFIDAT	6
Rekomandime kryesore	19
4. HYRJA, QËLLIMI DHE METODOLOGJIA	21
5. BAZA LEGJISLATIVE MBI PËRFAQËSIMIN GJINOR	26
6. INSTITUCIONET E PËRFAQËSIMIT TË GRAVE NË PARTITË POLITIKE	29
7. PËRFAQËSIMI I GRAVE NË PARTITË POLITIKE DHE NË ZGJEDHJE	43
8. GJETJET KRYESORE NGA INTERVISTAT DHE FOKUS GRUPET	64
9. GJETJET KRYESORE NGA PYETËSORËT E ZHVILLUAR	81
10. REKOMANDIME TË SPECIFIKUARA	95
Aneks A - Baza kushtetuese dhe ligjore të përfaqësimit gjinor	102
Aneks B - Pjesëmarrja e grave në parti politike - raste suksesi nga Kroacia dhe Sllovenia	110

SHKURTIME

AK	Asamble Kombëtarë
BE	Bashkimi Evropian
EDU	Bashkimi Demokratik Evropian
EPP	Partia Popullore Evropiane
GN	Grupet e Numërimit
FGS	Forumi i Grave Socialiste
ISP	Instituti i Studimeve Politike
KiE	Këshilli i Evropës
KD / KK	Këshilli Drejtues / Këshilli Kombëtar
KZGJ	Kodi Zgjedhor
KMD	Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi
KQV	Komisioni i Qendrës së Votimit
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KZAZ	Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor
LDG	Lidhja Demokratike e Gruas
LGI	Lëvizja e Gruas për Integrim
LSI	Lëvizja Socialiste për Integrim
ODIHR	Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

OJF	Organizata Jo Fitimprurëse
OSBE	Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim Evropian
MMSR	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
PBDNJ	Bashkimi për të Drejtat e Njeriut
PD	Partia Demokratike
PDIU	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet
PES	Internacionalja Socialiste
PKD	Partia Kristian Demokrate
PPSH	Partia e Punës së Shqipërisë
PR	Partia Republikane
PS	Partia Socialiste
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
UN Women	Programi për Gratë i Kombeve të Bashkuara
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Barazia gjinore pranohet gjerësisht nga institucionet dhe aktorët politikë përmes legjislacionit shqiptar, në përputhje me detyrimet e shtetit si anëtar i institucioneve ndërkombëtare dhe nënshkrues i akteve të miratuara nga këto struktura¹ si dhe në përputhje me përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së. Arritja e përfaqësimit të barabartë në rang kombëtar synon përmbushjen e të drejtave të njeriut, barazisë ligjore dhe forcimit të parimit të mos-diskriminimit në shoqëri.

Përfaqësimi i barabartë brenda partive politike lidhet me standardet demokratike, me detyrimin kushtetues dhe përgjegjësinë shtetërore kundër çdo forme diskriminimi gjinor, me legjislacionin zgjedhor dhe atë të partive politike, me sfidat e Shqipërisë në procesin integruar, dhe me natyrën e sistemit politik shqiptar.

Përfaqësimi i grave në parlament, në qeveri dhe në drejtimin e pushtetit vendor u rrit në mënyrë të konsiderueshme në shkallë vendi pas zbatimit të sistemit të kuotave gjinore më 2013 dhe 2015. Pavarësisht se kurba e rritjes reflektohet në të gjithë vendin, ka diferencë të dukshme midis qarqeve dhe midis subjekteve politike konkurruese.

Përfaqësimi i barabartë në strukturat partiake lidhet ngushtë me vendosjen e kuotave gjinore. Me gjithë tendencat në rritje dhe premtimet e partive, përfaqësimi i grave në organet vendimmarrëse partiake është ende i ulët. Pengesat kryesore për këtë përfaqësim lidhen me kulturën patriarkale që mbizotëron në shoqërinë dhe klasën politike në vend, me zërin ende të dobët të grave në media dhe me një shoqëri civile që nuk i ka maksimalizuar mundësitë e saj për të promovuar barazinë gjinore.

Megjithatë, ekzistenca e modeleve pozitive të grave politikane dhe e segmenteve shoqërore, politike dhe mediatike që promovojnë gratë në politikë e vendimmarrje, tregon se një investim i mëtejshëm në promovimin e barazisë gjinore dhe të përfaqësimit të barabartë politik është i nevojshëm për të arritur qëndrueshmëri dhe sukses.

1 Marrëveshjet e Shqipërisë me KiE http://www.punetejashtme.gov.al/files/userfiles/Aktet_e_KiE-se.pdf dhe lista e marrëveshjeve ndërkombëtare të Shqipërisë, www.punetejashtme.gov.al/dokumenta/akte-nderkombetare/traktate-dhe-konventa-shumepalëshe.

2. GJETJET KRYESORE: BILANCI, PROBLEMATIKA DHE SFIDAT


- Sistemi i votimit proporcional, si në zgjedhjet lokale ashtu edhe në zgjedhjet parlamentare rezultoi më pozitiv për përfaqësimin e grave në parlament dhe në këshillat bashkiakë, por në sistemin mazhoritar (votimi për kryetar bashkie) numri i grave konkurruese ishte në përqindje shumë më i vogël sesa kuota 30% e përcaktuar si standard minimal përfaqësimi. Ndryshimet ligjore më me ndikim në Kodin Zgjedhor ishin më 2008, me përcaktimin e kuotës gjinore 30% të kandidimit në zgjedhjet parlamentare, si dhe në prag të zgjedhjeve lokale 2015 me zbatimin e kuotës gjinore 50% në listat e kandidimit dhe të zgjedhjes në këshillat bashkiakë. Kjo përvojë pozitive e ndryshimit përmes ligjit e bën emergjente shqyrtimin e mundësisë për aplikimin e kuotës gjinore të detyruar edhe në zgjedhjen e deputetëve në zgjedhjet parlamentare.
- Më 2017 për herë të parë në historinë e tranzicionit gratë dhe vajzat kanë 28% të vendeve në parlament. Për herë të parë në historinë e Shqipërisë kemi numrin më të lartë të grave ministre (10 nga 20 ministra në qeverinë me prurje teknike dhe 7 nga 14 ministra në qeverinë e re 2017). Janë zgjedhur 39 gra deputete, 22 prej të cilave për herë të parë si përfaqësuese në parlament. Ky përfaqësim është një arritje e rëndësishme e grupeve lobuese politike e civile për kuotë përfaqësimi 30% në parlament dhe një referencë frymëzuese për qëndrueshmërinë dhe rritjen e përfaqësimit të barabartë të grave në të gjitha sferat e politikës vendimmarrëse.
- Gjatë legjislaturës 2013-2017, rritja e numrit të grave deputete erdhi më shumë si pasojë e detyrimit në Kodin Zgjedhor për zëvendësimin e mandateve me gjininë më pak të përfaqësuar sesa përmes fitores direkt të mandateve. Konkretisht, nga 36 mandate parlamentare të ndryshuara gjatë kësaj legjislature, 17 mandate i kaluan grave deputete të listës, shifër shumë më e lartë sesa numri i grave që u zgjedhën direkt nga mandatet e fituara në shtator 2013. Në legjislaturën e sapo filluar 2017-2021 nuk u zbatua ndarja e mandateve ministër – deputet, duke provuar tezën se aplikimi pozitiv i dispozitës përkatëse të Kodit Zgjedhor mund të mos ketë rezultate të njëjta nuk ka dorëzime të mandateve, ndaj nuk përbën garanci të qëndrueshme për zgjedhjet e ardhshme.

- Në fillim të legjislaturës 2013-2017 Lezha kishte shifrën më të lartë të grave deputete, 42% ose 3 nga 7 deputetët, por gjatë legjislaturës ndodhën ndryshime në përbërjen parlamentare. Në vitin e fundit, qarku i Shkodrës kryesoi përfaqësimin me 36,63% ose 4 gra nga 11 deputetë, ndjekur nga Elbasani e Lezha me 28%, përkatësisht me 4 nga 14 dhe 2 nga 7 deputetë. Më pas vijojnë qarqet Berat, Korçë, Kukës e Vlorë me nga 25%. Rrethet me përfaqësim më të ulët ishin Durrësi me 23% ose 3 nga 13 deputetë, pasuar nga Tirana me 21,87% ose 7 nga 32 deputetë, dhe Dibra me 16,66% ose 1 nga 6 deputetë. Qarku i vetëm pa asnjë deputete në parlament ishte Gjirokastra, e përfaqësuar vetëm nga pesë deputetë.
- Të dhënat e fundvitit 2016 shprehin ndryshimet e ndodhura në disa qarqe, ku zëvendësimi i deputetëve dhe lëvizjet në parlament sollën ndryshime edhe në raportin e përfaqësimit gjinor. Qarqet me rritjen më të madhe në përqindje ishin Kukësi me 25%, 21,4% Elbasani, 15,6 Dibra, 12,5% Berati etj. Kurse qarku i vetëm që pësoi ndryshim negativ ishte Lezha, e cila pësoi rënie nga 42% më 2013 në 28% më 2016 dhe fillimin e vitit 2017.

A. PËRFAQËSIMI GJINOR NË PARLAMENTIN E RI

- Në zgjedhjet parlamentare 2017 u regjistruan 18 parti politike dhe 2,666 kandidatë, nga të cilat 1,073 gra ose 40%. Partitë politike kryesore nuk e respektuan parimin e përfaqësimit të barabartë, ndryshe nga premtimet dhe angazhimet para-zgjedhore. Raporti zyrtar i ODIHR/OSBE vlerësoi se pavarësisht rritjes, gratë vijuan të jenë të nën-përfaqësuar. Asnjë nga kryetarët e partive konkurruese nuk ishte grua. Përqindja e grave në nivelet e administrimit zgjedhor ishte e ulët, vetëm 20%.
- KQZ zbatoi sanksionet e parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe fillimisht vendosi gjobë prej 1 milionë lekë për LSI për mosrespektim të kuotës gjinore në Tiranë dhe po kaq për PS për qarkun Berat. Pas zgjedhjeve PD u gjobit me 12 milion lekë për mosrespektim të këtij parimi në 12 qarqet e vendit. Kjo është shifra më e lartë financiare penalizuese për një parti politike që prej aplikimit të sistemit të kuotave.
- Sistemi i gjobave nuk ka qenë efektiv sa duhet në të kaluarën, por me rritjen e nivelit të penalizimit mund të jetë më efektiv në të ardhmen për të ecur drejt sistemit të kandidimit të detyruar linear me përbërje mikse, ose sistem zebër (një në dy) në të gjithë listën e kandidatëve.

Tabela 1. Diferenca e numrit të grave të zgjedhura në qarqe përgjatë legjislaturës 2013-2017



Qarku	2013	Fundi i legjislaturës 2017	Diferenca 2013-2017
Tiranë	18.75	21.8	3.05
Berat	12.5	25	12.5
Durrës	15.38	23	7.62
Fier	18.75	18.75	0
Korcë	25	25	0
Lezhë	42.85	28.57	-14.28
Dibër	0	16.66	16.66
Elbasan	7.14	28.57	21.43
Gjirokastër	0	0	0
Kukës	0	25	25
Shkodër	27.22	36.63	9.41
Vlorë	25	25	0

Tabela 2. Të dhënat mbi përqindjen e grave deputete në tri proceset e fundit zgjedhore 2009, 2013, 2017, si dhe gjendja e tyre në fundin e legjislaturës së kaluar (2016)




Tabela 3. Kandidatët për deputetë sipas gjinisë, zgjedhjet parlamentare 2017.




Tabela 4. Përqindja që zënë gratë deputete të zgjedhura në qarqe në zgjedhjet parlamentare 2017




Tabela 5. Përfaqësimi sipas qarqeve pas zgjedhjeve parlamentare 2017

Qarku	Meshkuj	Femra	Femra %
Berat	3	3	50%
Dibër	20	14	41%
Durrës	9	5	36%
Elbasan	2	1	33%
Fier	5	2	29%
Gjirokastër	8	3	27%
Korcë	4	1	20%
Kukës	13	3	19%
Lezhë	9	2	18%
Shkodër	10	2	17%
Tiranë	6	1	14%
Vlorë	12	2	14%
Gjithësej		39	27%

- Gjatë legjislaturës së re 2017-2021, qarku Dibër kryeson me shifra rekord duke arritur kështu përfaqësimin e barabartë 50% me 50%, ndjekur nga Tirana me 41% të grave në listën fituese, Durrësi 36%, Kukësi 33%, Lezha 29%, Korça 27%, Gjirokastra 20%, Fieri 19%, Shkodra 18%, Vlora 17% dhe dy qarqet me përfaqësim minimal të grave dhe vajzave në parlamentin e ri janë Berati e Elbasani me nga 14%. Gjithsesi ky është mandati i parë në të cilin të gjitha qarqet përfaqësohen nga

14% në 50% me gra deputete. Dibra kryeson me përqindjen më të lartë 50% dhe Tirana me numrin më të lartë të grave, 14 ndërsa qarqet me përfaqësimin më të ulët Berati dhe Elbasani përfaqësohen respektivisht me një grua në 7 mandate, dhe dy gra në 14 mandate.


B. PROBLEMATIKA TË VEÇANTA TË PËRFAQËSIMIT GJINOR

- Partitë nuk e zbatojnë njësoj parimin e përfaqësimit të barabartë dhe kuotën gjinore. Subjektet politike me përqindjen më të lartë të grave kandidatë ishte dy parti rivale historike, ish-të përndjekurit politik të grupuar në Aleanca Popullore për Drejtësi (APD) dhe Partia Komuniste, secila me 48% të listës. Nga partitë parlamentare PDIU kryesonte me 45%, ndjekur nga LSI me 42% dhe PS me 36%. PD renditet partia me përqindjen më të ulët të grave kandidatë me 20% të listës shumë-emërore. Dy partitë kryesore aplikuan standarde të dyfishta në listimin e grave deputete, secila parti pati gra në krye të listave në disa qarqeve, por tek secila parti kryesonte lista e kandidatëve burra në zona kandidimi me shanse maksimale për zgjedhje si deputet.
- Përveç zbatimit të kuotës dhe përfaqësimit të barabartë në listat e kandidimit, rëndësi ka dhe vendosja në lista dhe zona me mundësi më të lartë për fitimin e mandatit. Në zgjedhjet 2017 partia që kryeson me përfaqësimin më të lartë të grave është PS me 27% ndjekur nga PD me 25% dhe LSI me 21%.
- Referuar ligjit zgjedhor, kandidatët në vendet e para të listës kanë shanse reale për t'u zgjedhur. Ndërkohë detyrimin për kuotën 30% përgjatë listës së kandidatëve, partitë shpesh e kanë zbatuar duke i vendosur gratë në fund të listës. Në zgjedhjet parlamentare 2013, gratë kryesonin listat vetëm në dy qarqe me potencial fitues në Lezhë dhe Shkodër, kurse

në Kukës dhe Gjirokastrë po me potencial të lartë fitues, partitë nuk kishin vendosur asnjë grua në listën shumë-emërore. Në vendet e dyta, gratë u renditën në 10 raste dhe në vendet e treta në 13 raste (për tri partitë kryesore). Skema të tilla taktike tregojnë se partitë, shpesh nuk i mbajnë premtimet apo nuk zbatojnë frymën e ligjit.

- Më 2017 pati përmirësime. Partitë, sidomos ato me potencial minimal fitoreje, u treguan më të hapura dhe më të gatshme të promovojnë gratë dhe vajzat në zgjedhje. Ndërsa tri partitë e mëdha, për herë të parë vendosen më shumë gra dhe vajza në krye të listave shumë-emërore në disa qarqe. Konkretisht, PS vendosi katër kandidatë në vendet e para në Lezhë (Lindita Nikolla), Kukës (Mimi Kodheli) e Durrës (Englantina Gjermani), PD dy kandidatë në Dibër (Dhurata Çupi) dhe në Korçë (Valentina Duka, dhe LSI tre kandidatë në Tiranë (Klajda Gjoshja), Elbasan (Monika Kryemadhi) dhe në Kukës (Selvi Beçaj). Qarqet me numrin më të lartë të kandidatëve në vendin e parë janë Kukësi dhe Berati ndjekur nga Tirana, Lezha dhe Elbasani.
- Rreth 90% e partive politike, të cilat hynë në garë elektorale, nuk kanë struktura funksionale apo bazën e nevojshme për të fituar mandate parlamentare. Sistemi zgjedhor stimulon kufizimin e partive politike me shtrirje kombëtare dhe vetë partitë nuk kanë mbështetje të atillë në burime njerëzore dhe në infrastrukturë sa të jenë funksionale në të njëjtën kohë në të gjithë vendin dhe me të gjitha strukturat. Pjesa më e madhe e tyre

Tabela 6. Numri i grave kandidate në krye të listave në qarqe, 2017.



bëhen aktive vetëm në prag të fushatave elektorale. Në mënyrë që të shmangin gjobën dhe të zbatojnë detyrimin ligjor të kuotës gjinore, këto parti përfshinin gra dhe vajza,

në disa raste me lidhje të afërta familjare me drejtuesit partiakë qendror apo kandidatin e parë në listën proporcionale në qarq. Në zgjedhjet 2017 ISP evidentoi se kjo praktikë u

ndoaq nga mbi 60% e partive politike, kryesisht atyre të vogla. Kalimi nga qëllimi pozitiv i kuotave ligjore për të ndihmuar progresin e grave në praktika të tilla spekulative përbëjnë një dukuri negative dhe dëmtoese, për të cilën legjislacioni dhe KQZ duhet të përmirësojnë aktet verifikuese e kushtëzuese.

- Në jetën parlamentare, deputetet janë shumë më aktive sesa deputetet sipas të dhënave krahasuese të monitorimit të Kuvendit (2016 dhe 2017). Konkretisht, sipas këtyre të dhënave, rezultoni se 90% e grave deputeteve kanë diskutuar apo mbajtur fjalë në parlament në krahasim me 71% të deputetëve meshkuj. Të dhënat e ISP tregojnë se 30 gra dhe 77 deputetë meshkuj kanë diskutuar në parlament përgjatë viteve 2016-2017. Përqindja më e lartë e grave aktive në parlament është tregues i cilësisë në përfaqësimin e grave në parlament dhe argument kundër skepticizmit në drejtim të rritjes së numrit të grave deputete.

C. PËRFAQËSIMI GJINOR NË PARTITË POLITIKE

- Kuotat gjinore janë pjesë e strukturave të dy partive kryesore politike (PS e PD) që prej mesit të viteve '90. Niveli i përfaqësimit të barabartë gjinor ka pasur trend rritës dhe më 2017 dy nga tri partitë kryesore politike në Shqipëri zbatojnë kuota kandidimi dhe kuota zgjedhore nga 30 në 50% në strukturat e tyre qendrore (Kryesi dhe Këshill Kombëtar

i Asamblesë Kombëtare). Partitë politike parlamentare, sidomos tri partitë e mëdha, PS, PD e LSI kanë sanksionuar në statutet dhe dokumentet e tyre të brendshme praktika pozitive të kuotave dhe angazhime për promovimin e grave në politikë, por mungon vullneti dhe strategjitë konkrete që jetësojnë këto angazhime.

- Gratë politikane zënë 35% të vendeve në Kryesinë e LSI-së, 33% në Kryesinë e PS-së dhe 23% në Kryesinë e PD-së. Në Asambletë Kombëtare e Këshillat Kombëtare gratë zënë 45% të vendeve në PS, 33% të vendeve në LSI, dhe 19% të vendeve në PD. Ato zënë 50% të vendeve në sekretariatit e LSI-së, 33% në sekretariatit e PD-së dhe 25% në sekretariatit e PS-së. Gratë drejtojnë 12 nga 61 degët e PS, si dhe 40 nga 383 njësitë administrative të PS. Në PD dhe LSI nuk kanë asnjë grua kryetare në 61 kryetarët e degëve lokale të secilës parti. Ky trend negativ vihet re edhe në partitë e tjera politike parlamentare. Për pasojë, mund të konkludohet ky përfaqësim është ende larg standardeve të larta dhe raporteve të barabarta gjinore për partitë respektive.
- Partitë politike kanë shënuar hapa pozitivë drejt përfaqësimit të barabartë gjinor në strukturat vendimmarrëse. Në tërësi, statutet e tyre kanë sanksionuar kuota gjinore dhe kanë shfaqur interes politik dhe elektoral për rritjen e përfaqësimit të tyre. Mbi bazën e përfaqësimit politik dhe pozitës së organizatës së grave në partitë politike tabela paraqet klasifikimin e partive politike parlamentare.


Kuti. 10 treguesit kryesorë

Secili nga 10 treguesit kryesorë është vlerësuar me 10%. Treguesit kryesorë janë: 1) Aplikimi i kuotës gjinore në parti; 2) Ekzistenca e forumit të grave në parti; 3) aplikimi i kooptimit të kryetares së forumit në kryesinë e partisë; 4) Shtrirja kombëtare e forumit të grave; 5) Zhvillimi i zgjedhjeve periodike në forumin e grave; 6) Zhvillimi i zgjedhjeve konkurruese në krye të forumit; 7) Ekzistenca e një faqeje interneti për forumin e grave; 8) Ekzistenca e një programi politik aktiv të Forumit të grave; 9) Ekzistenca e një statute aktiv të forumit të grave, si dhe 10) Ekzistenca e zyrave në parti dedikuar forumit të grave.

Tri partitë kryesore politike kanë përqindjen më të lartë të përfaqësimit cilësor të grave e vajzave, duke bërë diferencë të madhe me partitë e tjera më të vogla parlamentare. Tabela nr. 1 dëshmon se standardet gjinore të përfaqësimit në partitë politike nuk janë të njëjta dhe se për standarde të larta mund të flitet vetëm në partitë e mëdha politike.

- Drejtimi i partive politike në Shqipëri vijon të konsiderohet monopol i politikanëve burra. Partitë ende nuk kanë krijuar mekanizmat e duhur të besimit, mbështetjes dhe konkurrimit transparent që të sjellë ndryshimet e nevojshme. Përfaqësimi i ulët dhe sidomos konsiderimi i drejtimit të degëve lokale si monopol i burrave përbën një

Tabela 7. Klasifikimi i partive politike mbi treguesit e përfaqësimit gjinor



devijim nga standardet që duhet të merret në konsideratë nga partitë politike.

C. PROBLEMATIKAT E PËRFAQËSIMIT

- Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i barabartë gjinor fiton vëmendje vetëm gjatë periudhave zgjedhore dhe garës politike, por ajo nuk gjen si konfigurim fundor prezencën reale të përqindjes së grave në organet politike vendimmarrëse, çka në shumicën e rasteve e bën formale kandidimin e tyre. Gjithashtu partitë i kanë përballuar lehtësisht sanksionet duke kaluar pengesën gjinore dhe vendosur vetëm burra në listat emërore.
- Me gjithë progresin në përfaqësimin e grave në vendimmarrjen e partive politike, ende ekzistojnë pengesa serioze që lidhen me vullnetin politik të liderit dhe me skema taktike, të cilat vështirësojnë mundësitë apo minimizojnë shanset reale të grave për të konkurruar apo arritur pozita të larta drejtuese në parti.
- Gratë që kandidojnë për poste politike vazhdimisht ndeshen me paragjykime me bazë gjinore, të cilat pengojnë karrierën e tyre të lirë dhe dëmtojnë shanset e barabarta për konkurrim. Gjetjet e fokus grupeve dhe intervistave e vërtetojnë këtë tezë kritike dhe janë një bazë e mirë prej nga ku duhet të nisë reformimi kulturor brenda vetë partive politike. Ky mjedis paragjykes ushqehet dhe artificialisht duke zhvilluar teza penguese për gratë që kandidojnë, si dhe për të mbajtur

në këmbë sistemin dominues mashkullor të përfaqësimit në institucionet vendimmarrëse partiake.

- Politika konfliktuale dhe ligjërimi denigrues janë faktorët më pengues për të arritur standarde më të larta të përfaqësimit gjinor pasi demotivojnë karrierën politike dhe krijojnë një mjedis jo të favorshëm për gratë politike. Gjatë legjislaturës parlamentare 2013-2017 asnjë deputete nuk është penalizuar për retorikën politike. Ndërkohë strukturat etike të Kuvendit kanë penalizuar 20 deputete, një tregues domethënës i diferencës në ligjërim dhe në sjellje.
- Shanset e grave për karrierë të lartë drejtuese janë të kufizuara për shkak se ekziston një perceptim i brendshëm në partitë politike se lufta e ashpër politike kërkon udhëheqës meshkuj dhe se vetëm burrat mund ta përballojnë sfidat konkurruese me të cilat ndeshen partitë politike në zgjedhjet lokale e parlamentare.
- Zbatimi integral i ligjit të de-kriminalizimit mund të krijojë një mjedis nxitës për rritjen e pjesëmarrjes së grave në partitë politike dhe në parlament. Asnjë grua politike si në sistemin qendror dhe në atë vendor të përfaqësimit nuk bën pjesë në listën e politikanëve të penalizuar për shkak të klauzolave të këtij ligji apo të shkruarës kriminale.
- Krijimi i Aleancës së Grave Deputete është një përvojë pozitive që meriton mbështetje për kthim në institucion të qëndrueshëm edhe

gjatë mandateve të ardhshme legjislativë. Bashkëpunimi i deputeteve nga të gjitha partitë parlamentare dhe trajtimi i çështjeve gjinore, politikave të përfaqësimit dhe të drejtave të grave duhet të jenë në fokusin kryesor të kësaj Aleance.

- Asnjë parti politike nuk ka zhvilluar mbledhje të posaçme të grupeve parlamentare ose strukturave drejtuese për të adresuar problematikat e përfaqësimit gjinor. Asnjë parti nuk ka programe të thelluara dhe të strukturuar mbi qëllimet, strategjitë, afatet dhe premtimet konkrete mbi arritjen e përfaqësimit të barabartë gjinor.
- Forumet dhe organizatat e grave të partive politike vijojnë të shihen si trupa mbështetëse të partisë. Ato nuk kanë burime financimi të veçuara, nuk zotërojnë mjedise pune të pavarura, nuk arrijnë të krijojnë një profil korrektues brenda partive në çështje të rëndësishme të politikës dhe veprojnë më shumë si mekanizma satelitor bashkë me organizatat rinore.
- Media nuk e përmbush sa duhet rolin e saj thelbësor në promovimin e parimeve të barazisë gjinore në përfaqësim, dhe në krijimin e modeleve pozitive të grave politikane në imazhin publik. Sipas ODIHR gratë kandidate morën pak vëmendje nga media; kanalet televizive publike dhe private të monitoruara nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it u kushtuan grave 13 për qind të pasqyrimit të fushatës. Rëndësia dhe bashkëpunimi me median duhet të jetë një prej fokuseve të

punës në të ardhmen për vetë gratë politikane dhe strukturat e tyre përfaqësuese dhe organizuese.

- Shoqëria civile, grupet shqiptare dhe organizatat ndërkombëtare kanë rol specifik dhe vlerësohen për kapacitetet që kanë në sensibilizimin pozitiv të partive politike për rritje të përfaqësimit të grave në partitë politike dhe në përgjithësi në politikë. Ato janë edhe aktualisht burimet më serioze të aktivitetit sensibilizues në këtë çështje.
- Ka një sërë modelesh pozitive dhe frymëzuese ndër politikanet shqiptare. Këto politikane vlerësohen pozitivisht si kandidate potenciale për të drejtuar me aftësi edhe detyrat më të larta të drejtimit shtetëror dhe politik në vend.

REKOMANDIME KRYESORE

- Për të adresuar më mirë mospërputhjen midis kapaciteteve të shumta që ofrojnë gratë në shoqërinë shqiptare dhe nivelin e ulët të përfaqësimit të tyre në vendimmarrjen politike, ISP sugjeron rritjen e nivelit përfaqësues horizontal dhe vertikal në partitë politike, në institucionet politike dhe në proceset elektorale.
- Përfaqësimi gjinor në strukturat vendimmarrëse të partive politike e shoqëruar me demokratizimin e brendshëm të tyre dhe vendosjen e një sistemi meritokracie në promovimin e anëtareve duhet të rregullohet nga ligji i partive politike.
- Kodi Zgjedhor duhet të vendosë kuotat gjinore në çdo 3 emra të listës shumë-emërore edhe për zgjedhje parlamentare, dhe të sanksionojë praktika më të forta penalizuese ndaj partive politike parlamentare, të cilat nuk zbatojnë me korrektesë këtë sistem në zgjedhjet parlamentare dhe lokale.
- Kodi Zgjedhor duhet të sanksionojë të njëjtin standard për përfaqësim 50% gjinor në të gjithë strukturën e administrimit zgjedhor (KZAZ, KZZ, QV, GN, BMM, etj); në emërimin e administratorëve të njësive dhe në organet e tjera vendimmarrëse në varësi strukturore nga bashkia; dhe në përfaqësimin gjinor në partnerin kryetar-nënkryetar bashkie.
- Kodi Zgjedhor duhet të përcaktojë nene të qarta penguese për praktikat e presionit për dorëheqje të kandidateve gra në listat shumë-emërore të partive politike; të parashikojë penalitete në rastet e ligjërimit publik denigrues mbi bazën e gjinisë dhe të votimit familjar, në emër të grave apo presionit për votën.
- Kodi Zgjedhor duhet të parashikojë fonde të veçanta sensibilizuese dhe promovuese për kandidatet gra në zgjedhjet parlamentare dhe vendore, përfshirë këtu dhe studime e trajnime lidhur me përfaqësimin gjinor në kandidim, administrim dhe në votime dhe për votimin individual si i vetmi mjet për shprehjen e vullnetit politik.
- KQZ duhet të krijojë një database të saktë me të dhënat e të gjithë kandidatëve në zgjedhje dhe rezultatet e tyre të përcaktuara në bazë gjinie, dhe ta bëjë këtë database të përdorshme nga publiku dhe studiuesit shkencorë.
- Partitë politike, në mënyrë të vijueshme, duhet të angazhohen në problematikën konkrete të grave duke forcuar organizatën e grave dhe institucionalizuar seanca të grupeve parlamentare e këshillave bashkiakë dhe grupit të ministrave me forumin e grave. Partitë duhet të krijojnë një program specifik elektorale për çështjet gjinore dhe rastet e ligjërimit diskriminues mbi bazë gjinore duhet t'i përfshijnë në Kodet Etike si shkelje flagrante dhe raste penalteti në karrierë.
- Shoqëria civile duhet të mbështetet nga organizata dhe institucione ndërkombëtare të monitorojë proceset e brendshme partiake, në funksion të rritjes së sasisë dhe cilësisë

së përfaqësimit të grave në të gjitha nivelet e partive politike dhe procesin e (për)zgjedhjes së kandidatëve e deputetëve përqendruar tek tërheqja e kandidatëve apo zhvendosja në listën shumë-emërore.

- Organizatat e grave dhe partitë politike, do të duhet të bashkëpunojnë nga afër me median për promovim më të madh mediatic të fushatës elektorale të kandidateve gra nga secila parti, si dhe modeleve pozitive të karrierës së grave.
- Praktikantët e deritanishme me Aleancën e Grave Deputete dhe Aleancat e Grave Këshilltare duhen nxitur të jenë aktive, të krijojnë një tribunë debati e prezantimi për problematikat gjinore, përfshirë ato të përfaqësimit politik në nivel qendror dhe vendor.
- Forumi i grave dhe gratë kandidate duhet të mbështeten të kenë fond të veçantë në fushatën në parti dhe më pas edhe elektorale, duke krijuar praktika pozitive të buxhetimit gjinor në parti, në parlament dhe në qeverisje.
- Forumet e grave në partitë politike duhet të kenë transparencë publike (faqe të internetit) të aktivitetit dhe strukturave të tyre, si dhe të mundësojnë debate aktive mbi problematika konkrete të pozitës së gruas në shoqëri e politikë.
- Shoqëria civile, partitë dhe partnerët ndërkombëtarë duhet të ndërmarrin rregullisht programe trajnimi mediatic, legjislativ dhe politik të grave kandidate dhe grave në politikë, për t'i ndihmuar ato me informacione dhe forma moderne të komunikimit dhe të aktivitetit politik.

4. HYRJA, QËLLIMI DHE METODOLOGJIA

Më 25 qershor 2017 u zhvilluan zgjedhjet parlamentare në Shqipëri. Këto ishin zgjedhjet e para parlamentare pas zgjedhjeve lokale 2015, në të cilat u aplikua vendosjen e kuotave gjinore 50% për në këshillat bashkiakë. Votimi u bazua në sistem proporcional, me lista të mbyllura dhe mbi bazë qarqesh, - një sistem i favorshëm për aplikim më të gjerë të praktikave pozitive të kuotave gjinore dhe të promovimit të grave në politikë.

Zgjedhjet duhej të ishin një test i rëndësishëm politik i Shqipërisë drejt standardeve të larta zgjedhore dhe aftësisë për të kapërcyer problematikat e të kaluarës. Ato u zhvilluan në një atmosferë të qetë, larg incidenteve dhe rezultatet e tyre zyrtarisht nuk u kontestuan nga asnjë prej partive politike konkurruese.

4.1. HYRJE

Përfaqësimi i drejtë gjinor dhe koncepti i barazisë gjinore pranohen gjerësisht nga institucionet dhe aktorët politikë, si një çështje e rëndësishme, e cila për nga rëndësia është bërë pjesë e rëndësishme e legjislacionit shqiptar, qoftë në kuadër të përafrimit të legjislacionit me atë të BE së, qoftë në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të shtetit tonë si anëtar në institucionet ndërkombëtare dhe njëkohësisht si nënshkrues të akteve të miratuara nga këto

struktura. Gjithashtu është parë edhe si nevojë e vazhdueshme në rang kombëtar për të çuar më tej nivelin e emancipimit mbi të drejtat e njeriut, barazisë ligjore dhe forcimit të parimit të mos-diskriminimit në shoqëri.

Kuadri ligjor në fuqi, tërësia e rregullave dhe të normave kombëtare dhe ndërkombëtare që rregullojnë pjesëmarrjen e grave në jetën politike aktive në Shqipëri, paraqet një zhvillim pozitiv në disa aspekte. Por, koncepti ligjor i përfaqësimit të drejtë ende nuk është shndërruar në kulturë politike dhe në detyrim ligjor. Kuadri ligjor i analizuar lidhur me shkallën e respektimit e të drejtave për një akses dhe kuota të barabarta në vendimmarrje me përfaqësuesit politik meshkuj gjatë fushatave zgjedhore, tregon se midis premtimit për sistem kuotash dhe zbatimit praktik të tij ekziston ende një hendek i madh numerik dhe cilësor.

Studimi provon se niveli i përfaqësimit të grave në partitë dhe në institucionet e tjera politike, produkt i zgjedhjeve, kërkon bashkëveprimin e dy faktorëve: normave të shkruara ligjore dhe statutore, si dhe vullnet politik të vendimmarrëseve brenda partive politike. Diferenca në pranimin e konceptit të përfaqësimit gjinor nuk është vetëm rurale – urbane, por edhe në formën sesi partitë e vlerësojnë garën elektorale, fushatën dhe përpjekjet e tyre për çdo votë. Zgjedhjet parlamentare 2013 dhe ato 2015,



midis të tjerash, shfaqen edhe dy tipare në aspektin e përfaqësimit gjinor:

- e para, në disa raste se preferenca për kandidatë të pasur dhe të fuqishëm la në hije shpeshherë potenciale cilësore e profesionale të grave kandidate e politikane; dhe
- e dyta, se partitë reflektuan më pas përmes masave të brendshme për të rritur nivelet numerike të përfaqësimit të grave dhe vajzave në parlament, në partitë politike dhe në qeveri.

Përfaqësimi i grave dhe vajzave në vendimmarrjet politike të partive dhe institucioneve politike nuk është një kriter formal apo ligjor mandatesh dhe numrash, por mbi të gjitha është një standard demokracie dhe një detyrim moral e programor për çdo parti politike. Gratë dhe vajzat përfaqësojnë gjysmën e votuesve dhe të banorëve në Shqipëri, ndaj përfaqësimi i tyre politik është jetik për të krijuar një sistem përfaqësues sa më real, funksional dhe proporcional.

4.2. KONTEKSTI I STUDIMIT

Shqipëria po kërkon të arrijë standardet e demokracisë funksionale si pjesë e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Një prej elementëve kryesorë të vlerësimit është ai i përfaqësimit politik dhe brenda tij, përfaqësimi gjinor në politikë. Për shkak të traditës konservatore dhe brishtësisë së proceseve të tranzicionit, çështja e përfaqësimit gjinor në politikë dhe vendimmarrje merr një vlerë të veçantë, përbën një sfidë të rëndësishme dhe mbetet një tregues domethënës për cilësinë e demokracisë.

Pas vitit 2008, Shqipëria ka aplikuar standarde në rritje të përfaqësimit gjinor në politikë. Zgjedhjet e fundit parlamentare (2013) dhe zgjedhjet e fundit lokale (2015) reflektuan trendin pozitiv të përfaqësimit, si dhe sfidat e përbashkëta të partive politike për të ardhmen. Zgjedhjet parlamentare 2017 zhvillohen në një kontekst të ri politik dhe ligjor, dhe në frymën e konsensusit të gjerë të partive kryesore politike për të rritur më tej përfaqësimin gjinor në aspektin cilësor dhe sasior. Në këto zgjedhje do të testohet për herë të parë ndikimi i ligjit të dekriminalizimit², si dhe nisma e një numri deputetësh nga parti të ndryshme politike për të aplikuar kuota të përfaqësimit politik gjinor në parlament në nivelet e përfaqësimit politik gjinor në zgjedhjet e fundit lokale.

Në ushtrimin e parimit kushtetues të përfaqësimit qytetar institucionet më të rëndësishme mbeten partitë politike. Ato kanë monopolin e përfaqësimit. Analiza e partive politike (bazës statusore, organizimit, funksionimit, vendimmarrjes, programit elektoral dhe programit politik, sjelljes zgjedhore dhe ligjërimit politik, etj.), krijon një tablo të qartë mbi cilësinë dhe problematikat e përfaqësimit politik dhe për pasojë, edhe të zgjedhjeve në Shqipëri. ISP mendon se analiza e përfaqësimit të grave në zgjedhje është pjesë e analizës tërësore mbi demokracinë partiake dhe sistemin përfaqësues.

Mbi këtë bazë vlerësimi, ecja drejt përfaqësimit proporcional gjinor, në përputhje me standardet më të larta demokratike dhe me përbërjen aktive

² Ligji 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", njihet si ligji i "dekriminalizimit" dhe përjashton nga politika individë që në jetën e tyre janë dëbuar brenda ose jashtë vendit për vepra të ndryshme penale.

të trupës zgjedhore dhe votuese në vend, kërkon para së gjithash një mjedis pozitiv mbështetës publik, aplikimin e standardeve të tilla brenda vetë partive politike, si dhe mekanizma të qëndrueshëm institucionalë që garantojnë trendin pavarësisht situatave e interesave specifike apo ndryshimit të rrethanave elektorale.

4.3. QËLLIMI I STUDIMIT

Qëllimi kryesor i studimit është paraqitja analitike e gjendjes dhe e tipareve kryesore të përfaqësimit të grave në partitë politike në Shqipëri. Studimi trajton bazën ligjore mbi përfaqësimin gjinor, dokumentet strategjike mbi këtë temë, si dhe paraqet e analizon të dhënat konkrete nga partitë politike. Pjesë e analizës janë zgjedhjet parlamentare 2013 dhe zgjedhjet lokale 2015, si dhe bilanci i politikave të përfaqësimit gjinor në partitë parlamentare në prag të zgjedhjeve të reja 2017.

Fokusi i këtij studimi janë partitë politike, struktura e tyre funksionale, raportet gjinore brenda tyre në aspektin e përfaqësimit dhe vendimmarrjes, jeta institucionale brenda vetë partive dhe sfidat për të ardhmen. Studimi vlerëson secilin prej faktorëve ndikues drejt përfaqësimit të balancuar gjinor, dhe vlerëson se më shumë se praktikat statusore të partive përcaktues është vullneti politik dhe vizioni i lidërshiptit partiak.

Qëllimi kryesor është që, përtej analizës së situatës së shkuar dhe të tanishme, të prodhohen rekomandime dhe ide produktive për përmirësime në të ardhmen. Punimi shoqërohet me gjetjet dhe rekomandimet kryesore, duke i vlerësuar ato në dy

faza, si rekomandime afatshkurtra dhe rekomandime afatgjata.

Përmes ndërhyrjeve ligjore apo përmirësimeve në rregulloret dhe aktet e tjera të vetë partive politike, si dhe përmes forcimit të rolit politik e përfaqësues të vetë organizatave të grave brenda partive, mund të krijohet një mjedis i qëndrueshëm institucional, me ndikim afatgjatë në cilësinë dhe raportet e përfaqësimit gjinor në parlament, në qeveri, në organet e qeverisjes vendore dhe në nivele të tjera të vendimmarrjes politike.

4.4. METODOLOGJIA E STUDIMIT

Metodologjia e studimit bazohet në kërkimin sasior dhe cilësor dhe përfshin shumicën e aspekteve të mundshme të të dhënave dhe të këndvështrimit ndaj tyre nga partitë politike parlamentare, përfaqësues të medias, të shoqërisë civile, të botës akademike dhe ekspertë të fushës.

Periodha në të cilën përqendrohet studimi është midis viteve 2013 dhe 2017 dhe partitë parlamentare të kësaj periudhe: PS (Partia Socialiste), PD (Partia Demokratike), LSI (Lëvizja Socialiste për Integrim), PDIU (Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet), PR (Partia Republikane), PBDNJ (Partia Bashkimi i të Drejtave të Njeriut), si dhe PKD (Partia Kristian-demokrate). Atje ku është parë e nevojshme, janë paraqitur të dhëna më të hershme, si dhe janë pasuruar të dhënat me partitë konkurruese në zgjedhjet parlamentare 2013.

Janë zhvilluar fokus grupe, intervista, pyetësorë gjatë ditës së zgjedhjeve 25 qershor 2017, të dhënat e të cilave janë ballafaquar me gjetjet nga puna kërkimore. Të dhënat janë mbledhur nëpërmjet shqyrtimit të dokumenteve publike dhe konfidenciale, intervistave individuale, grupeve të fokusit me përfaqësues të partive politike, institucioneve publike dhe ekspertëve të fushës.

Dokumentet kryesore të përdorura për këtë studim janë:

- Kushtetuta dhe legjislati në fuqi së bashku me aktet nënligjore dhe administrative, përfshirë Kodi Zgjedhor dhe Ligji mbi Partitë Politike,
- Dokumentet rregullatore të partive (statutet, programet elektorale, programet politike, strategjitë elektorale),
- Elementë të funksionimit të partive dhe fushatës elektorale (ligjërimi elektoral, vendimmarrja e strukturave për kandidimin, Kuvendet / Kongreset Kombëtare, periudha zgjedhore, buxheti për kandidatet gra e vajza në zgjedhje, oferta elektorale ndaj votuesve gra e vajza, roli i organizatave të grave në partitë politike, strategjitë post elektorale, etj.
- Si dhe studime e të dhëna mbi rolin e grave e vajzave në strukturat e reja drejtuese në parti dhe institucione politike, roli në vendimmarrje (Kuvend, qeveri dhe në qeverisjen vendore), kryesisht referuar partive politike parlamentare.

5. BAZA LEGJISLATIVE MBI PËRFAQËSIMIN GJINOR

Hierarkia legjislative në Shqipëri përcaktohet nga Kushtetuta e Shqipërisë, dhe përveç saj, bëjnë pjesë edhe legjislacioni ndërkombëtar i detyrueshëm për shkak të marrëveshjeve të nënshkruara, si dhe legjislacioni shqiptar në funksion të parimeve kushtetuese. Lidhur me përfaqësimin gjinor ekziston një bazë ligjore solide dhe në ndryshim pozitiv, e cila mundëson rritjen e përfaqësimit gjinor deri në nivelet e balancimit në përfaqësim. Problematika shqiptare vijon të jetë diferenca midis legjislacionit të shkruar dhe zbatimit të tij integral në praktikë. Ky tipar del në pah sidomos në çështjet e përfaqësimit të grave në zgjedhjet parlamentare dhe lokale.

Në aneksin A të studimit bëhet paraqitjen më e detajuar e bazës ligjore që lidhet me çështjet e përfaqësimit gjinor. Në këtë paragraf citohen vetëm elementët më të rëndësishëm të bazës legjislative. Kështu, në nenin 67 pikat 6 dhe 7 të Kodit Zgjedhor parashikon se për çdo zonë zgjedhore, të paktën 30% e listës shumë-emërore dhe një në tre emrat e parë të listës shumë-emërore duhet t'i përkasë secilës gjini. Subjekti paraqitës i listës deklaron vendet, sipas kuotës gjinore. Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, për çdo këshill bashkie, një në çdo dy emra të njëpasnjëshëm në renditje duhet t'i përkasë së njëjtës gjini. Në rast mospërmbushjeje të njërit prej kushteve të parashikuara në këtë nen, në lidhje me

përbërjen e listës shumë-emërore, KQZ-ja zbaton sanksione.

Neni 175 i Kodit Zgjedhor parashikon se mospërmbushja nga ana e subjektit zgjedhor e detyrimeve të parashikuara në pikën 6, të nenit 67, të këtij Kodi, në lidhje me përbërjen e listës, dënohet nga KQZ-ja me gjobë 1 000 000 lekë si dhe sanksionin plotësues, sipas pikës 2 të këtij neni, në rastin e zgjedhjeve për Kuvendin, dhe me refuzimin e listës së partisë politike të kandidatëve për këshillat bashkiakë, për zgjedhjet për organet e pushtetit vendor. Kur ndaj një subjekti zgjedhor është konstatuar shkelja, KQZ-ja zbaton si sanksion plotësues zëvendësimin e çdo vendi që krijohet në listën e subjektit, në zonën ku është konstatuar shkelja, me kandidatët vijues në listë nga gjinia më pak e përfaqësuar deri në plotësimin e kuotës gjinore. Sanksionet e përcaktuara në këtë nen vendosen për çdo zonë zgjedhore ku konstatohet shkelja. Ato u aplikuan edhe në zgjedhjet parlamentare 2013 dhe 2017.

Ligji nr. 221, më 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" është një tjetër akt i rëndësishëm i miratuar në vitin 2010 nga Kuvendi i Shqipërisë, i cili zgjeron gamën e të drejtave dhe garancive midis meshkujve dhe femrave, duke futur nocione dhe fusha zbatimi jo vetëm në aspektin politik, por edhe

në fusha të tjera, kryesisht të lidhur me ekonominë, çështjet sociale etj.

Ligji "Për Partitë Politike" rregullon organizimin dhe funksionimin e subjekteve politike. Megjithëse ky ligj ndalet në një sërë çështjesh të detajuara të krijimit të partisë duke përcjellë parimet kryesore pa të cilat një subjekt politik nuk mund të krijohet sipas ligjit, ligji ka një boshllëk lidhur me përmbajtjen e barazisë gjinore politike. Kjo tregon se ai nuk është ende i harmonizuar me ligjet e tjera të përmendura më lart që rregullojnë këtë fushë. Sanksionimi i normave dhe parimeve të përfaqësimit gjinor në strukturat drejtuese të partive politike do të ishte hap më i rëndësishëm dhe më jetëgjatë sesa rregullat elektorale periodike për jetësimin e këtij përfaqësimi. Kuotat dhe përfaqësimi proporcional brenda partive krijojnë një kulturë të re politike brenda partive, krijojnë shanse për qasje të re ndaj problematikave gjinore, detyron partitë të jenë më konkurruese në raport me votuesit e dy gjinive si dhe krijojnë mekanizma garancie të shprehura përmes programit politik me elementë ligjorë, si dhe përmes rritjes së cilësisë së përfaqësimit në dy gjinitë.

Pjesëmarrja e barabartë dhe kuptimplotë e grave në jetën politike dhe publike është një domosdoshmëri për një shoqëri demokratike që funksionon në mënyrë efektive... Gratë udhëheqëse kanë nevojë për mbështetje të rrjeteve që mund të forcojnë zërin e tyre, të reklamojmë mënyrën se si gratë udhëheqëse mund të ndërmarrin veprime reale për të mbrojtur interesat e qytetarëve dhe të krijojnë solidaritetin për të përballuar pengesat.

BRIAN J. WILLIAMS, KOORDINATOR REZIDENT I OKB & DREJTUES I PNUD NË SHQIPËRI

6. INSTITUCIONET E PËRFAQËSIMIT TË GRAVE NË PARTITË POLITIKE

Kushtetuta e partive politike janë statutet dhe parimet e tyre programore. Çdo parti politike, sipas ligjit, vepron si institucion më vete, me dokumente dhe ideologji identifikuese, me strukturë të pavarur organizimi dhe drejtimi, me organizim vullnetar të qytetarëve mbështetës dhe me funksionet klasike të partive politike në demokraci. Partitë politike shqiptare kanë gjithashtu të njëjtat karakteristika. Ato kanë statute dhe programe, kanë struktura dhe anëtarësi, kanë organizata të grave dhe të rinisë, kanë prioritete dhe parime politike. Fokusi i këtij kapitulli është analiza e gjendjes së organizatave të grave në partitë politike dhe problematika të funksionimit të tyre.

6.1. ANALIZË E DOKUMENTEVE STATUTORË TË PARTIVE

Statutet e partive politike janë dokumente të brendshme legale të organizimit dhe funksionimit të tyre, të cilat regjistrohen në gjykatë për të marrë miratimin në përputhje me parimet kushtetuese dhe ligjore. Përmbajtja e tyre është shumë e rëndësishme për të kuptuar jo vetëm nivelin e respektimit të rendit juridik në tërësi, por edhe të garancive të veçanta, veçanërisht në fushën e barazisë politike në aspektin gjinor.

Më poshtë kemi renditur një pjesë të përmbajtjes së statuteve të partive politike të cilat janë prezent në Kuvendin e Shqipërisë, për t'i analizuar lidhur me shkallën e tyre të përafrimit ligjor lidhur me barazinë gjinore që diktohet nga një sërë aktesh të tjera të përmendura më lart.

- **PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË (PS)** në Nenin 3 të statutin garanton shanse të barabarta në përfaqësimin midis grave dhe burrave. Në nenin 23 ajo sanksionon se çdo organizatë e partisë mbështetet në parim e jo më pak se 30% të përfaqësimit gjinor të grave në jetën politike të saj. Në nenin 37 të statudit ku parashikohen rregullat e përzgjedhjes së delegatëve në kongres vendoset rregulli se lista e kandidateve për t'u votuar dhe lista e fituesve si delegate duhet të sigurojë një përfaqësim të barabarte prej 50% për të dyja gjinitë. Kriteri i barabartë prej 50% vendoset edhe për kandidaturat që do të zgjidhen nga kongresi i partisë për anëtarë të Asamblesë së Kombëtare të PS. Sipas Nenit 43 përfaqësia gjinore femërore për të garuar për në kryesinë e PS duhet të jetë në një kuotë më të vogël e përbërë nga 30% të tyre. Ndërkohë që, sipas nenit 63 të Statudit, lista e kandidatëve që garojnë për Këshillat Vendore duhet të respektoje barazi të plotë gjinore prej

50%. Kjo parti ka të krijuar me statut edhe Forumin e Gruas Socialiste, i cili në zgjedhjet e dhjetorit 2016 deklaroi një anëtarësi prej 30 mijë grash dhe vajzash.

- **PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË PD** në statutin e saj në nenin 22 të tij parashikon që në kryesinë e degës duhet të ketë gjini femërore të votuar dhe pjesëmarrëse në këtë forum jo më pak se 30% të numrit të përgjithshëm. Po ashtu edhe në nenin 36 të këtij statuti ku flitet për anëtarësinë e zgjedhur në Këshillin Kombëtar të kësaj partie vendoset sërish kuota jo më pak se 30% të përfaqësisë femërore në këtë strukturë të lartë partiake. Ky statut, ashtu si edhe tek PS, nuk jep rregulla për kandidimin në zgjedhje me kuota gjinore dhe për rotacione gjinore në strukturat drejtuese monokratike të partisë. Statuti i PD ka respektuar kuotën minimale të vendosur nga ligji për barazinë gjinore. Kjo parti parashikon në statutin e saj një organizatë partnere brenda subjektit të saj politik e cila përfaqëson gjininë femërore të quajtur Forumi i Gruas Demokrate. Neni 21, pika J përcakton se Kuvendi i Degëve të partisë përfshin deri në 5% përfaqësues të zgjedhur LDG. FGD deklaroi në zgjedhjet e saj më 2016 një anëtarësi prej 20 mijë grash dhe vajzash në nivel kombëtar.
- **LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM (LSI)** në statutin e saj dhe konkretisht në kreun 17 pika 3 parashikon se Lëvizja e Gruas për Integrim përfaqësohet me lista të veçanta kandidimi për në forumet e LSI-së në të gjitha nivelet në masën jo më pak se 50%.

Parimi i barazisë gjinore është i detyruar të respektohet në përbërjen e të gjitha forumeve të LSI-së. Kjo është dispozita e vetme që përmban Statuti i LSI-së po në mënyrë imperative konfirmon vullnetin e kësaj partie për të pasur përfaqësi të barabartë në çdo forum politik brenda saj. Kjo parti ka krijuar me status edhe forumin e gruas, LGI. LGI nuk ka deklaruar anëtarësi publike.

- **PARTIA PËR DREJTËSI, INTEGRIM DHE UNITET (PDIU)** në statutin e saj dhe konkretisht në nenin 23 ku bën fjalë për delegatët në kongresin e partisë, i cili mbahet një herë në 4 vjet parashikon se një e treta e prezencës së tyre duhet të jetë e gjinisë femërore. Nëse nuk plotësohet ky numër kjo dispozitë parashikon se mund të pranohet një numër edhe më i vogël. Po ashtu ky rregull sanksionohet edhe për përfaqësinë femërore në Këshillin Kombëtar të PDIU të parashikuar në nenin 24 të statutit. Ashtu si dhe në rastin e disa partive të tjera, edhe ky statut nuk jep rregulla për kandidimin në zgjedhje me kuota gjinore dhe për rotacione gjinore në strukturat drejtuese monokratike të partisë. Gjithsesi statuti i PDIU ka respektuar kuotën minimale fillestare të vendosur nga ligji për barazinë gjinore. Edhe kjo parti parashikon në statutin e saj një organizatë partnere brenda subjektit të saj politik e cila përfaqëson gjininë femërore. Forumi i grave të PDIU nuk ka deklaruar anëtarësi të saj.

Tabela 8. Të dhënat kryesore mbi forumet / organizatat e grave në partitë tona politike

Elementë të përfaqësimit gjinor në statutet e partive politike	Partitë politike parlamentare*			
	PS	PD	LSI	PDIU
Përfaqësimi i grave në të gjitha forumet e partisë	≤30%	<30%	≤50%	<30%
Anëtarësisë së grave në organizatat e partisë	≤30%	<30%	≈30%	<30%
Përfaqësimi i grave delegate në kongres / kuvend kombëtar	50%	<30%	>30%	<30%
Përfaqësimi i grave në kandidaturat për Asamblenë / Këshillin Kombëtar	50%	<30%	>30%	<30%
Përfaqësimi i grave të zgjedhura në Asamblenë / Këshillin Kombëtar	≤30%	≤30%	30%	<30%
Përfaqësimi i grave në kandidaturat për Kryesinë e partisë	30%	30%	>30%	<30%
Përfaqësimi i grave në Këshillat Vendorë	≤50%	≤30%	>30%	<30%
Përfaqësimi i grave në Kryesitë e Degëve të partisë	-	≤30%	30%	<30%
Anëtarësia në Forumin e Gruas	30,000	20,000	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna

* Statutet e PR, PBDNJ dhe PKD nuk përmbajnë nene që trajtojnë përfaqësimin gjinor.

- PARTIA REPUBLIKANE E SHQIPËRISË (PR)** nuk provohet nga burimet e saj partiake të informacionit të ketë bërë ndryshime që nga statuti i saj, lidhur me kuotat gjinore në vendimmarrje apo pjesëmarrje në forumet drejtuese të saj. Mendojmë se ky statut duhet të përditësohet nën frymën e kritereve dhe standardeve të reja ligjore për të qenë në përputhje me kërkesat dhe frymën e kohës në këtë fushë. Forumi i grave në PR nuk ka deklaruar anëtarësi të saj.
- PARTIA BASHKIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT (PBDNJ)** në statutin e saj nuk përmban të shprehur nocione apo kritere të barazisë gjinore. Ajo vetëm mjaftohet që partia ka një organizatë partnere që është Forumi i Gruas së PBDNJ. Edhe në këtë rast është imperative të shikohet ndryshimi i këtij statuti për ta përputhur me normat dhe standardet e reja që diktojnë barazinë ligjore në jetën politike. Forumi i grave në PBDNJ nuk ka deklaruar anëtarësi të saj.

- **PARTIA KRISTIAN DEMOKRATE (PKD)** në statutin e saj nuk ka të parashikuar në asnjë dispozitë ndonjë kriter apo standard për respektimin e barazisë apo kuotave gjinore në përfaqësim apo vendimmarrjen politike të saj. Mendojmë se ky statut duhet të azhurnohet nën frymën e nocioneve dhe standardeve të reja ligjore për të qenë në përputhje me kërkesat dhe kriteret e kohës në këtë fushë. Forumi i grave në PKD nuk ka deklaruar anëtarësi të saj.

6.2. FORUMET E GRAVE NË PARTITË POLITIKE

Në hierarkinë e organizimit të partive politike shqiptare bëjnë pjesë të paktën dy organizata partnere, forumi i gruas dhe forumi i rinisë. Asnjë parti nuk ka forume të tjera, të cilat gjenden në parti të ndryshme evropiane, siç janë forumet e veteranëve, të sipërmarrësve, të sindikatave, etj. Forumet e grave dhe rinisë datojnë shumë më vonë sesa data e krijimit të partive.

Konkretisht, PD është krijuar në dhjetor 1990, por forumi i saj i grave është krijuar në gusht 1991. Gjithashtu edhe PS është krijuar në qershor 1991 (ndryshoi emërtimin), por forumi i grave daton disa muaj më vonë. Arsyeja e vonës nuk është teknike, por politike. Në fillimet e pluralizmit kishte debat publik nëse partitë duhet të kenë organizata rinore dhe të grave, për shkak të trashëgimisë negative që kishim prej modelit të njëjtë të PPSH gjatë regjimit të partisë – shtet. Vetëm kur partnerë ndërkombëtarë të partive, kryesisht PES (Internacionalja Socialiste)

dhe EDU (Bashkimi Demokratik Evropian, sot EPP), këshilluan rëndësinë e organizimit edhe mbi bazën e gjinisë dhe të rinisë, partitë vendosën krijimin e këtyre organizatave.

Raportet midis organizatave partnere dhe partisë mëmë kanë qenë dhe mbeten raporte ndërvarësie politike, financiare dhe strukturore. Pa mbështetjen e fortë të partisë asnjë prej organizatave partnere nuk mund të mbijetojë, ndaj edhe kjo mbështetje është përkthyer edhe si e drejtë e partisë për të imponuar vendimmarrje, zgjedhje dhe kursin politik të drejtimit edhe brenda vetë forumit të grave dhe të rinisë.

Më poshtë jepen treguesit statusorë të raporteve midis organizatave të grave dhe partive politike kryesore.

6.2.1 FORUMI I GRAVE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË (FGSSH)

Sipas nenit 75 të Statutit të Partisë Socialiste, “Forumi i Grave Socialiste të Shqipërisë është organizëm politik, i cili bashkon vajzat dhe gratë anëtare dhe përkrahëse të partisë, dhe i asociohet strukturave të partisë. Qëllimi i Forumit është të nxisë dhe të rrisë aksesin dhe kontributin e grave dhe vajzave në parti”. Statuti përcakton se “programi dhe veprimtaria e FGSSH-së konvertojnë me Programin, Statutin dhe veprimtarinë e partisë” megjithëse FGSSH-ja ka statutin dhe rregullat e veta të funksionimit.

- Forumi ka objektiv kryesor realizimin e mundësive të barabarta për gratë dhe vajzat në të gjithë fushat e veprimtarisë, në veçanti në sigurimin e raporteve të barabarta në

Gjatë kohës sime si ambasador këtu në Shqipëri unë kam takuar një numër të madh politikanesh të talentuara dhe profesioniste.

JOHAN NDISI, AMBASADOR I SUEDISË NË SHQIPËRI

tregun e punës, institucionet shoqërore, në përfaqësimin politik midis grave dhe burrave, nxitjen e pjesëmarrjes së grave në funksionet dhe jetën publike si edhe në qeverisjen e vendit. FGSSH-ja ndërton strukturat e veta në nivel vendor e qendror. Anëtarët e FGSSH-së mund të mos jenë anëtarë të partisë.

- Drejtueset e FGSSH-se duhet të jenë anëtarë të partisë. Drejtueset socialiste të strukturave të FGSSH-së hyjnë drejtpërdrejt në përbërje të forumeve drejtuese të niveleve përkatëse të partisë. Kandidaturat për kryetare të FGSSH-së të bashkisë miratohen nga Asambleja e bashkisë, sipas propozimeve të ardhura nga strukturat e forumit të gruas socialiste.
- Përbërja e forumeve të FGSSH-së përcaktohen në statutin dhe funksionimit të FGSSH-së. Kandidaturat për Kryetare të FGSSH-së miratohen nga Kryesia e partisë, sipas propozimeve të ardhura nga forumet drejtuese të FGSSH-së. Kryetarja zgjidhet me votim të fshehte dhe kandidaturë alternative nga Kongresi i FGSSH-se. FGSSH-ja zhvillon veprimtari të tjera për përmbushjen e nevojave dhe interesave profesionale, formuese, kulturore, arsimore, sportive dhe argëtuese të grave dhe vajzave, të cilat jo detyrimisht burojnë nga programi i partisë.

6.2.2. LIDHJA DEMOKRATIKE E GRUAS (LDG)

Lidhja Demokratike e Gruas është organizatë e grave dhe vajzave në Partinë Demokratike. Në dokumentet e PD (neni 1) përcaktohen synimet, midis të cilave

përfshihet synimi “të promovojë paritetin gjinor në jetën e partisë dhe pjesëmarrjen e barabartë të grave në organet e zgjedhura dhe ato ekzekutive”. Në një intervistë kreu i LDG deklaroi se organizata numëron 20 mijë anëtarë³.

- Në gjuhën statusore të saj quhet “organizatë partnere” dhe trajtohet në nenin 52 të Statutit të PD-së. Sipas nenit 53, “organizatat partnere synojnë që të promovojnë idetë dhe programet e PDSH në grupet shoqërore ku ato veprojnë, si edhe të paraqesin e mbrojnë interesat e këtyre grupeve në politikën e PDSH. Parimet bazë të strukturës së tyre organizative janë të ngjashme me ato të PDSH. Statuti i tyre duhet miratuar paraprakisht nga Kryesia e PDSH”.
- Statuti përcakton se organizatat partnere synojnë që të promovojnë idetë dhe programet e PDSH në grupet shoqërore ku ato veprojnë, si edhe të paraqesin e mbrojnë interesat e këtyre grupeve në politikën e PDSH. Parimet bazë të strukturës së tyre organizative janë të ngjashme me ato të PDSH. Statuti i tyre duhet miratuar paraprakisht nga Kryesia e PDSH. Miratimi i organizatave të tjera bëhet me vendim të Këshillit Kombëtar dhe duhet konfirmuar nga Kuvendi Kombëtar me ndryshimin përkatës në Statut.
- Në vetë statutin e LDG theksohet se qëllim i saj është promovimi dhe përhapja e vlerave dhe e “parimeve të botëkuptimit liberal-

3 Fuqizimi i grave në politikë. Intervistë, Albana Vokshi. OSBE, 2015.

demokrat, pasqyrimin dhe propagandimin e tyre, të shprehura në platformat dhe programet e Partisë Demokratike. LDGSH përfaqëson interesat politike të anëtarësisë së vet; kujdeset për zbatimin e politikave të Partisë Demokratike, promovon pjesëmarrjen e grave demokrate në strukturat politikë-bërëse dhe vendimmarrëse si dhe angazhimin e tyre në funksione politike”.

6.2.3. LËVIZJA E GRUAS PËR INTEGRIM (LGI)

Edhe Lëvizja Socialiste për Integrim i referohet Forumit të Grave, LGI, si një prej dy organizatave partnere. Në nenin 17.3 theksohet se “Lëvizja e Gruas për Integrim përfaqësohet me lista të veçanta kandidimi për në forumet e LSI-së në të gjitha nivelet në masën jo më pak se 50%. Parimi i barazisë gjinore është i detyruar të respektohet në përbërjen e të gjitha forumeve të LSI-së”.

- Referuar LGI dhe LRI, neni 17.5 thekson se “përfshirja në forumet e LSI-së me kuota të caktuara, nuk pengon kandidimin dhe zgjedhjen e përfaqësuesve të këtyre dy organizatave, të rinjve e të rejave apo grave, në forumet e LSI-së jashtë këtyre kuotave”.
- Në vetë statutin e LGI thuhet se ajo “është një bashkim vullnetar i grave dhe i vajzave shqiptare mbi bazën e ideve, të bindjeve, të pikëpamjeve dhe interesave të përbashkëta ekonomiko-sociale, të cilat synojnë të ndikojnë në rolin aktiv të gruas në shoqëri” dhe se funksioni i saj është zbatimi i programit politik të LSI.

Të njëjtat pozita statusore gjenden edhe në dokumentet statusore të partive të tjera në analizë, PDIU, PR, PBDNJ dhe PKD. Për shkak se këto parti kanë shtirje dhe përfaqësim simbolik, ekzistenca e një organizate të grave aktive dhe me vizibilitet publik nuk ka qenë në qëllimet e tyre kryesore. Për këtë arsye, këto dhe parti të tjera të së njëjtës masë të përfaqësuar indirekt në parlament (PAA, LZHK, PDK, etj.), kanë organizata e forume grash kryesisht simbolike, me aktivitet relativ dhe publik sidomos në periudhën elektorale.

6.3. ROLI I FORUMEVE TË GRAVE NË VENDIMMARRJEN POLITIKE

Me gjithë mbështetjen statusore dhe rëndësinë që partitë i kushtojnë në ligjërime publik problematikës së grave e vajzave, dhe forumeve partiake si zëdhënese të tyre, bilanci i ndikimit të këtyre forumeve në vendimmarrjen e madhe politike vazhdon të jetë simbolik. Në asnjë rast, në asnjë parti politike nuk ka ndodhur që në drejtimin e organizatës së grave të zgjidhen gra e vajza, të cilat kanë qëndrime kritike ose konkurruese me kryetarët e partive.

Në historikun 26-vjeçar të pluralizmit, në asnjë rast nuk ka ndodhur që një grua politikane të konkurrojë për drejtimin e partisë në dy forcat kryesore politike, Partia Socialiste dhe Partia Demokratike. Gjatë fundit të viteve '90 ka pasur një tendencë pozitive në PS për konkurrencë edhe të grave për pozitën dytësore drejtuese, kryesisht për postet e sekretarëve politikë. Në dy raste, po në PS ka pasur garë midis dy kandidatëve për kryeministër, një nga secila gjini. Rasti i parë daton më 1999 (Makbule Çeços përballë

Ilir Metës) dhe rasti i dytë më 2003 (Ermelinda Meksit përballë Pandeli Majkos). Në PD nuk ka pasur kandidatë grua për postin e kryeministrit dhe as kryetarit. Në LSI, më 2017 një grua politikane, Monika Kryemadhi, mori drejtimin e partisë, pasi ish-kryetari Meta, njëherësh bashkëshort i saj, u zgjodh President i Republikës. Nga partitë e sotme parlamentare ekziston vetëm një rast referues, në fundin e viteve '90 në PR politikania Mirela Bogdani garoi me politikanin Fatmir Mediu në garën për kryetar të PR. Nga partitë jo parlamentare vetëm dy gra ishin / janë kryetare partie, në Partinë e Gjelbër (2005) dhe në Aleancën Kuq e Zi (2017).

Forumet e grave kanë pasur në fokus të tyre kryesisht problematika sociale brenda kuadrit të partive respektive, duke iu shmangur debateve të mëdha politike apo rivaliteteve të brendshme për drejtimin politik të partisë. Kjo është arsyeja që ato nuk kanë ndikuar dhe as kanë tentuar të ndikojnë në ndryshime të rëndësishme të kursit politik dhe vendimmarrjen politike të partive respektive. Gjithsesi ka pasur raste kur drejtuesit e forumeve të grave ose personat përgjegjës për politika gjinore dhe organizata partnere janë intimiduar dhe mënjanuar nga shanset e karrierës për shkak të vendimeve të lidërshiptit politik në parti. Rasti më tipik janë zgjedhjet e vitit 2009 kur dy partitë e mëdha politike, PS e PD, megjithëse përfshinë një numër grash e vajzash në politikë, refuzuan të përfshijnë në listën proporcionale partiake kryetaret respektive të forumeve të grave në secilën parti.

Ky dhe akte të tilla të njëjta diferencuese dhe preferenciale kanë pasur ndikimin e tyre në dobësimin e rolit dhe rëndësinë së forumeve të grave si dhe në krijimin e një sistemi karriere për prurjet e reja

gjinore në politike, që nuk përputhet me kontributet e brendshme partiake. Për pasojë, kanë ndodhur rokada të imponuara nga lart në forumet kryesore të partive, përfshirë edhe dy partitë e mëdha dhe rastin e lartpërmendur.

Prej më se dy vitesh forumet e grave të partive politike, sidomos në partitë e mëdha PS e PD, por edhe në LSI, dhe më pak PR apo PDIU, kanë pasur një rol aktiv në rritje dhe përpjekje për shtrirje kombëtare strukturore. Forumet kanë bërë zgjedhje në organizatat e tyre lokale, kanë hartuar programe dhe kanë kryer trajnime të shumta, janë përfshirë në projekte bashkëpunimi dhe kanë zhvilluar aktivitete të ndryshme politike e sociale. Pjesë e bilancit pozitiv të këtyre viteve janë edhe nismat e tyre të veçuara ose konsensuale në mbështetje të promovimit të rritjes së kuotave gjinore në politikë, në deklarime e nisma kundër rasteve të dhunës në familje ose dhunës ndaj grave, në raste të ligjeve që kanë karakter thellësisht social dhe gjinor, si dhe në përpjekjen për të krijuar një network komunikimi dhe përfaqësimi edhe në aspektin gjinor.

6.4. ANALIZË E PROGRAMEVE ELEKTORALE TË PARTIVE

Në programin politik të PS (publikuar më 2013⁴) një kapitull i veçantë i kushtohet barazisë gjinore dhe problematikave të saj. Synimi i saj është “fuqizim real i grave dhe vajzave dhe mundësi të barabarta për të gjithë gratë dhe burrat, duke kthyer në realitet barazinë gjinore në çdo aspekt të jetës”. Në premtimet

4 Programi i PS, www.ps.al, 2013.

konkrete, programi trajton çështjet e dhunës ndaj grave, viktimave të dhunës, kushteve të jetesës, mbështetje në biznes e punësim, promovimi në arsim dhe karrierë, etj. Dy janë premtimet specifike që lidhen me përfaqësimin politik: kuota 30% në institucionet e zgjedhura dhe të emëruara, si dhe krijimi i një Zyre për Barazinë Gjinore monitorues të procesit legjislativ dhe jetësimin të tij.

Në programin politik të PD (2013) gjenden premtime specifike për rritjen e rolit të grave të vendimmarrjen ekzekutive dhe publike, për politika sociale, për promovimin shkencor, për mbrojtjen ndaj dhunës dhe ndaj pabarazisë, për trajtim preferencial në çështjet e kreditimit ekonomik dhe financiar, si dhe për vlerat e familjes dhe rolit të saj në shoqëri. Në lidhje me përfaqësimin politik PD premtonte kuota përfaqësimi në nivelin 30%. Më 2015 qëndrimi i saj ndaj kuotave ndryshoi duke u angazhuar për kuota përfaqësimi mbi 30%.

Tek LSI programi elektoral bazohet më shumë në aspekte sociale dhe ekonomike sesa në një agjendë reformash politike. Ajo e quan forcimin e rolit të gruas në shoqëri si vlerë demokratike, dhe shprehet se “pjesëmarrja e barabartë e gruas në kuota përfaqësimi në LSI është realitet, por ne do ta bëjmë këtë fenomen të politikës në përgjithësi dhe të administratës publike”.

Përcaktime programore për rritje të përfaqësimit të grave dhe vajzave gjenden kryesisht në ligjërimin politik të kryetarëve të partive të tjera parlamentare. Në programet e tyre të shkruara dhe të publikuara nuk ka propozime specifike me kuota ose me objektiva afatshkurtra. Gratë dhe vajzat përmenden në rastet e politikave sociale, të rëndësishme së familjes

dhe në promovimin e masave kundër dhunës dhe diskriminimit.

Në tërësi, mungesa e referimeve konkrete dhe të plota mbi politikën gjinore dhe problematikat gjinore, në programet e partive politike, shpreh edhe progresin minimal të arritur në këto vite në sistemin horizontal të përfaqësimit politik. Partitë vetë mendojnë se preokupimi kryesor për problematikat gjinore dhe përfaqësimin e grave e vajzave duhet të jetë fokus i organizatës së grave brenda tyre. Në praktikë organizatat e grave kanë qëllim dhe fokus kryesor këtë tematikë, por ato nuk janë vendimmarrëse në partitë respektive, ndaj edhe nuk e mbushin dot hapësirën e lënë bosh nga vetë programet politike dhe elektorale të partive politike.

Përballja e këtyre premtimeve me realizimet përgjatë qeverisjes kalon natyrshëm nëpërmjet përdorimit apo jo të mekanizmave ligjore që mazhoranca kontrollon në Shqipëri. Ky raport monitorues vlerëson se gjatë qeverisjes së koalicionit (Parti Socialiste dhe Lëvizja Socialiste për Integritet) është rritur vëmendja ndaj gruas. Kështu Këshilli i Ministrave ka përdorur projektligjet, urdhrat dhe vendimet për të vënë në jetë disa nga premtimet elektorale të mazhorancës në lidhje me çështjet gjinore.

Qeveria dërgoi në parlament 48 ligje që përmbajnë fjalën “grua” për periudhën 2013-2016 sipas “Fletores Zyrtare”, si edhe miratoi disa VKM dhe urdhrat që përmirësojnë pozitat e gruas në shoqëri. Këto ligje e dëshmojnë vëmendjen e shtuar të qeverisjes ndaj gruas pasi zberthehen për çdo rast në një theksim të veçantë tek kjo pjesë e shoqërisë, si në rastet kur ligjet karakter ekonomik, social apo ligje që lidhen me përfaqësimin publik.



Ndërhyrja thelbësore për sa i përket përmirësimeve ligjore në raport me premtimet është miratimi nga Kuvendi i Shqipërisë i Ligjit Nr. 136, datë 5.12.2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Këto rishikime u përqendruan në një saktësim të termit “shqetësim seksual”.

- Detyrimin e punëdhënësit për të garantuar kushtet e përshtatshme për punë të gruas shtatzënë apo për atë me fëmijë në gji, kur vendos të kthehet për të punuar pas 63 ditëve të paslindjes. Ajo përfiton një pushim të paguar prej 2 orësh, brenda kohëzgjatjes normale të punës, ose kohëzgjatje pune të reduktuar, me 2 orë, me pagë të njëjtë sikur të kishte punuar për kohëzgjatjen normale ditore të punës.
- Garanci shtesë për të siguruar rikthimin në punë të gruas pas mbarimit të lejes së lindjes.
- Mos-diskriminim në shpërblim për të gjithë dhe jo vetëm për meshkujt dhe femrat.
- Nën frymën e ndryshimeve të Kodit të Punës së fundmi është miratuar VKM për mbrojtjen e grave shtatzëna dhe nënave të reja në punë, ku janë përcaktuar në përputhje me legjislacionin evropian elementët e kohës së punës dhe pushimit, si dhe vendet e punës ku është e ndaluar rreptësisht puna për to.

Në lidhje me fuqizimin ekonomik të gruas dhe familjes, përmes disa VKM, si për shembull, VKM Nr.375, datë 11.06. 2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 904”, e cila parashikon të drejtën për të tërhequr dhe marrë në dorëzim

ndihmën ekonomike nga bashkëshortja, pasi shembujt e shumtë të sjellë nga praktika, dëshmonin për një keqadministruar të ndihmës ekonomike në kohën kur tërhiqej vetëm nga bashkëshorti.

Akt pozitiv është edhe VKM Nr.339, datë 19.06.2014, e cila miraton “Plani i Veprimit në mbështetje të gruas sipërmarrëse (2014-2020)”, apo VKM Nr.592 datë 10.09.2014 me anë të së vilës u krijua fondi në mbështetje të gruas sipërmarrëse. për të lehtësua financim direkt për gratë sipërmarrëse nga institucione jo bankare. Fondi mbulon deri në 50% të interesit të kredisë. Udhëzimi Nr.4 më 2014 “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, sugjerohet sistemi i pikëzimit sipas së cilit në kriteret konkurruese, në 15 nga 21 skema është përcaktuar përfitimi me 5 pikë më shumë, nëse aplikantët do të jenë gra fermere.

MMSR bashkë me nën/komisionin për të miturit dhe barazinë dhe dhunën në Kuvendin e Shqipërisë kane prezantuar para deputetëve dhe OJF-ve të fushës një set propozimesh të përfaqësues së legjislacionit me standardet e konventës së Stambollit. Të gjitha këto realizime nuk kanë arritur megjithatë të përmbushin premtimet elektorale të Partisë Socialiste në qasjen ndaj gruas. Ndër premtimet e pa-mbajtura veçojmë:

- Linjë kombëtare këshillimi 24 orë falas për gratë e vajzat dhe ndërtim i një partneriteti funksional me shoqërinë civile e komunitetet fetare.
- Krijim i Zyrës për Barazinë Gjinore, për të siguruar që projekt-ligjet e paraqitura për shqyrtim përputhen me detyrimet ligjore për barazinë gjinore dhe nuk përfshijnë

diskriminim me baza gjinore.

- Zbatim real i kuotës së përfaqësimit 30% të grave dhe vajzave në institucionet e zgjedhura dhe të emëruara.
- Trajnim profesional falas për çdo vajzë nën moshën 25 vjeç, brenda 6 muajve të parë të qeverisjes.
- Trajnim dhe punësim me përparësi për gratë dhe vajzat e pakicave dhe gratë e vajzat me aftësi të kufizuara.
- Zgjerim dhe përmirësim i qasjes së grave në hua, përmes programeve mbështetëse për vetëpunësim, strukturave të kujdesit dhe mbrojtjes sociale.
- Ndihmë ligjore falas për gratë që kërkojnë të drejtat e tyre për bashkëpronësi.

Me ndryshimin e MMSR dhe strukturimin e kabinetit qeveritar (2017) përgjegjësitë në çështjet gjinore dhe strategjitë referuese janë të shpërndara në disa ministri. Ky zhvillim e dobëson mekanizmin e përfaqësimit të integruar dhe mund të ndikojë edhe në rënien e vëmendjes ndaj çështjeve prioritare që lidhen me angazhimet e ekzekutivit mbi problematikat e mësipërme.

As qeveria dhe as parlamenti nuk kanë një strukturë administrative apo politike, e cila të bëjë monitorimin katër-vjeçar të programit të mazhorancës në lidhje me problematikat gjinore dhe çështje që kanë të bëjnë me angazhimet për gratë e vajzat. Mungesa e një instrumenti të tillë, e bën procesin zyrtar të bilancit të arritjeve e dështimeve të vështirë. Kjo mungesë

nuk është kompensuar as nga një proces i tillë analize nga Forumet e Grave brenda partive kryesore në qeveri, as nga grupi i grave deputete të mazhorancës dhe as nga ndonjë strukturë civile që monitoron në vijueshmëri problematika të tilla. Për më tepër, ky nuk është një defekt vetëm i kësaj mazhorance por një sjellje institucionale e konsoliduar gjatë tranzicionit nga çdo qeveri, pra një mangësi e sistemit politik dhe institucioneve qeverisëse të tij.

6.5. ANALIZË E PRAKTIKAVE TË BUXHETIT GJINOR PARTIAK DHE SHTETËROR

Organizatave të grave në partitë politike shihen si pjesë strukturore e partive, jo si ente më vete në funksionim dhe financim. Drejtuesit e organizatës, si dhe baza materiale mbështetëse për aktivitetin e organizatës financohet nga vetë arka e partisë. Pjesa më e madhe e aktivitetit të organizatave të grave bëhet mbi baza vullnetare, përfshirë edhe roli aktiv politik i kryesisë dhe sekretariatit drejtues. Organizatat kanë zyra të tyre brenda selive të partive respektive, gëzojnë pagesa financiare minimale (1-2 persona) nga buxheti partiak, dhe përdorin të njëjtat mjete, mjedise dhe praktika organizimi si edhe vetë partitë e tyre.

Disa prej partive kanë norma statusore ose në rregullat e brendshme të organizimit të partive, përmes të cilave u referohen edhe aktivitetit të forumeve të grave. Konkretisht, PS në statutin e saj, neni 75, thekson se FGS “nuk mund të hyje në marrëdhënie bashkëpunimi politik dhe as të kontribuojë financiarisht dhe me mjete të tjera për parti politike, programi i të cilave është i papajtueshëm

me programin e Partisë. Ajo nuk mund të kryejë transaksione pronësie dhe të punësojë personel”. Po ashtu në referimet mbi financimin partiak, theksohet se “burimet e financimit të FGS-së janë partia dhe dhuratat. Rregullat e përgjithshme, rregullat statusore”.

PD nuk ka specifikime statusore mbi financimin apo rregulla përjashtuese për organizatat partnere, përfshirë LDG, por ka akte të brendshme administrative jopublike që rregullojnë raportet midis tyre. LSI, PDIU, PR, PBDNJ dhe PKD nuk ka rregulla specifike statusore mbi raportet parti – forumi i gruas për financimin.

Duhet theksuar se koncepti i buxhetimit gjinor brenda partive nuk aplikohet në asnjë parti politike. Partitë nuk kanë regjistra të saktë të anëtarësisë, nuk kanë financim të rregullt në buxhetin shtetëror dhe elektorale, nuk kanë burime në nivele të njëjta nga donacionet dhe kontributet e anëtarëve, si dhe nuk e lidhin përkatësinë gjinore të anëtarësisë me konceptin e buxhetimit dhe përfaqësimit të çështjeve që burojnë prej tij.

Partitë me potencial qeverisës, sidomos PS, PD dhe LSI kanë promovuar në vijimësi koncepte të buxhetimit gjinor në paketat sociale të programeve të tyre elektorale apo qeverisëse. Përpjekja bazohet në synimin për rishpërndarjen e buxhetit, që shërbimet dhe investimet publike t'u përgjigjen sa më mire nevojave të ndryshme të burrave, grave, djemve dhe vajzave⁵. Nisma mbështetet në praktikën më të mira ndërkombëtare dhe në VKM nr. 465 (VKM),

datë 18.7.2012 “Për integrimin gjinor në Programin Buxhetor Afatmesëm”, reflektuar më pas edhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2013-2020 (SKZHI).

Buxhetimi gjinor shihet si mjet për integrimin e çështjeve gjinore në proceset e zbatimit të politikave, si dhe një mënyrë efektive për gratë dhe vajzat për tu përfshirë plotësisht në diskutimet dhe debatet mbi ndarjen e burimeve që mund të sjellin si rezultat fuqizimin e tyre dhe rritjen e përgjigjes së politikave ndaj nevojave të tyre. Praktika e buxhetimit gjinor mundet gjithashtu të nxisë pjesëmarrjen qytetare dhe transparencën në qeverisjen e mirë.

5 [www.financa.gov.al/files/euser/files/Buxheti%20Buxhetimi_gjinor%20Fletpalosje-Poster-BuxhetimiSHTYP_\(1\).pdf](http://www.financa.gov.al/files/euser/files/Buxheti%20Buxhetimi_gjinor%20Fletpalosje-Poster-BuxhetimiSHTYP_(1).pdf)

Gratë po sjellin dinamikë të re në politikën shqiptare dhe një numër të konsiderueshëm iniciativash në lidhje me çështjet e grave dhe grupet e cenueshme. Ndryshimet në Kodin Zgjedhor, të shtyra nga Aleanca e Grave Deputete dhe iniciativat ndërpartiake të grave deputete janë një shembull shumë i mirë për këtë. Ato kanë vërtetuar se partitë e ndryshme mund të vijnë së bashku dhe të bashkëpunojnë në çështje të rëndësishme.

BERND BORCHARDT, KRYETARI I PREZENCËS SË OSBE NË SHQIPËRI

7. MBI PËRFAQËSIMIN E GRAVE NË PARTITË POLITIKE DHE ZGJEDHJE

Fokusi thelbësor i studimit është prezantimi i të dhënave mbi përfaqësimin e grave në partitë politike në Shqipëri. Objekti i kërkimit përbën risi dhe dokumenti ofron për herë të parë të dhëna të detajuara dhe profesionale mbi përfaqësimin e grave në partitë kryesore politike, në qeveri dhe në parlament, në bashki dhe në këshillat bashkiakë, si dhe në proceset e fundit zgjedhore. Të dhënat janë të shoqëruara me analiza të gjetjeve dhe të problematikave, si dhe me krahasime midis vetë partitë politike parlamentare. Kapitulli thekson se pa një përfaqësim sasior dhe cilësor në standarde të larta të grave në partitë politike është e vështirë të ketë përfaqësim të njëjtë në institucionet e tjera, produkt i vullnetit politik të vetë partive politike.

7.1. TË DHËNAT KRAHASUESE MBI FORUMET E GRAVE NË PARTITË POLITIKE

Analiza e gjendjes statusore dhe programore të forumeve të grave në partitë politike parlamentare nxjerr në pah një sërë të dhënash dhe problematikash. Konkretisht, referuar tabelës nr. 1, vetëm partitë kryesore (PS, PD dhe LSI) kanë tregues cilësor të

përfaqësimit, kurse partitë e tjera politike kanë tregues formalë të përfaqësimit. Kjo diferencë lidhet edhe me potencialin përfaqësues dhe vendin që zënë partitë respektive politike në spektrin politik. Partitë e mëdha synojnë qeverisjen e vendit dhe kanë interes të kenë strukturë aktive edhe në organizimin gjinor, kurse partitë e vogla kanë synime minimale përfaqësimi dhe kanë interes të fokusohen në kategori votuesish, tek të cilit mund të sigurojnë mbështetje elektorale.

Tabela tregon se në përgjithësi partitë respektojnë kuotat e përfaqësimit përmes rregullave të tyre statusore. Në dallim nga vitet e para të tranzicionit kur kuotat gjinore ishin deri në 25% të vendeve në kryesinë qendrore dhe kryesinë lokale, në vitet e fundit kjo përqindje është rritur dhe ka tendencën të rritet edhe më tej. Për shembull, krahasuar me partitë e tjera, dy partitë kryesore qeverisëse, PS dhe LSI aplikojnë kuota më të larta gjinore në listat e delegatëve dhe strukturat e kongresit kombëtar, si një mekanizëm që mund të prodhojë më pas rritje të numrit të grave dhe vajzave në vendimmarrjen politike.

Të dhëna pozitive të tabelës mund të konsiderohen edhe ato që lidhen me ekzistencën e zgjedhjeve periodike në forumet e grave, sidomos në degët e

Tabela 9. Të dhëna mbi forumet / organizatat e grave në partitë politike, 2017.

TË DHËNA MBI FORUMET E GRAVE NË PARTITË POLITIKE PARLAMENTARE							
PROBLEMATIKA	PS	PD	LSI	PDIU	PR	PBDNJ	PBK
Kuota gjinore	30%	30%	50%	30%	30%	30%	25%
Forumi aktiv i grave	Po	Po	Po	Jo	Jo	Jo	Jo
Kooptim në kryesi	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po
Shtrirje kombëtare	Po	Po	Po	Jo	Jo	Jo	Jo
Zgjedhje periodike	Po	Po	Po	Jo	Jo	Jo	Jo
Zgjedhje konkurruese	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
Faqe aktive interneti	Po	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
Program aktiv i forumit	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
Statut aktiv i forumit	Po	Po	Po	Jo	Jo	Jo	Jo
Zyrë dedikuar forumit	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po


rretheve, si dhe me ekzistencën e zyrave në partitë politike dedikuar forumit të grave apo ekzistencës së dokumenteve statusore prej këtyre forumeve.

Elementë kritikë mund të konsiderohen fakti se në tërësi, zgjedhjet për kryetare në forumet e grave kanë qenë formale, për sa kohë në të gjitha rastet e mandateve aktuale ka pasur vetëm një kandidat në garë, dhe se forumet e grave nuk kanë faqe të rregullt interneti, nuk kanë program specifik aktiv që lidhet me problematikat gjinore dhe si dhe nuk kanë një regjistër kombëtar të anëtarësisë, bazuar edhe në elementë gjinorë.

7.2. POZITA E GRAVE NË STRUKTURAT VENDIMMARRËSE TË PARTIVE POLITIKE

Një element i rëndësishëm i vlerësimit të pozitës së grave në vendimmarrjet politike të partive lidhet me vendin që ato zënë në këto struktura. Referuar të dhënave krahasimore në shtatë partitë parlamentare, rezulton se asnjëra nga dy partitë e mëdha nuk ka pasur dhe as ka grua kryetare ose candidate potenciale për kryetare partie. LSI zgjodhi një grua kryetare më 2017, një zgjedhje jo konkurruese që lidhet me historikun dhe identitetin e kësaj partie. Vlerësim pozitiv është fakti se në qeverinë “teknike” të periudhës maj – shtator 2017 PD delegoi një grua

Tabela 10. Të dhëna mbi pozitën e grave në postet drejtuese në partitë politike



për zv/kryeministre, kurse në qeverinë e re të dalë nga zgjedhjet parlamentare 2017, PS vijoi të njëjtën praktikë, duke zgjedhur një grua në postin e zv/kryeministrit.

Disa parti aplikojnë modele të ndryshme organizimi, p.sh, bazuar në sekretariat aktiv ose në ekzistencën e postit të nënkryetarëve. PS nuk ka nënkryetar, PD ka dy nënkryetarë, por të dy meshkuj. Në LSI një në tre zv/kryetarë është grua. Në pozitën e sekretarëve ekzekutivë të partive, raportet janë më

solide dhe përfaqësuese. Konkretisht, gratë zënë 25% të vendeve në sekretariatit e PS-së, 33% në sekretariatit e PD-së dhe 50% në sekretariatit e LSI-së. Në kryesitë e partive LSI ka 35% gra e vajza, ndjekur nga PS me 33% dhe më pas PD me 23%.

Referuar të dhënave për kryetare bashkie nga tri partitë kryesore, LSI ka përqindje më të lartë të grave kryesore, ndjekur nga PS me 18% dhe PD në fund me 7% ose vetëm 1 kryetare bashkie nga 14 kryetarë në total. Referuar drejtimit të degëve në rrethe, PD

dhe LSI nuk kanë asnjë kryetare grua në krye të 61-67 degëve lokale, PS ka rreth 16% të zgjedhur në ristrukturimin e vitit 2016. Përpara këtij procesi zgjedhor në parti as PS nuk kishte kryetare grua në degët e saj lokale.

Referuar të dhënave nga grupet parlamentare, PS ka përqindjen më të lartë të grave deputete 27% ndjekur nga PD me 25% dhe LSI në fund me 21%. Në strukturat partiake kombëtare raportet janë gjithashtu interesante. Në Asamblenë e PS gratë e vazjat zënë 45% të vendeve, në Komitetin Drejtues të LSI ato zënë 33% të vendeve, kurse në Këshillin Kombëtar të PD ato zënë vetëm 19% të vendeve. Penalizimi në rastin e PD vjen edhe nga fakti se nuk ka gra në drejtimin e degëve lokale, drejtues të cilët automatikisht janë edhe anëtarë të Këshillit Kombëtar.

7.3. KONCEPTI I KUOTAVE GJINORE DHE IMPAKTI I TYRE POLITIK

Koncepti i vendosur me ligj i “kuotës gjinore” në zgjedhjet parlamentare e lokale është i vonë në politikën shqiptare. Ai u aplikua për herë të parë në zgjedhjet 2009, pas ndërhyrjeve në Kodin Zgjedhor (2008). Aplikimi lidhej vetëm me kuotën e kandidimit prej 30%. Në amendimet në Kod u përcaktua detyrimi se “për çdo zone elektorale, të paktën 30% e listës shumë-emërore dhe 1 nga 3 emrat e listës shumë-emërore duhet ti përkasin çdo gjinie”. Për shkak se praktika nuk dha rezultatet e pritura atëherë ligjvënësi, nën presionin publik të grupeve të interesit dhe këshillimin ndërkombëtar, në 2012, vendosi penalitete dhe gjoba më të ashpra për subjekte

politiket, të cilat nuk përmbushin kriteret e kuotës gjinore në lista shumë-emërore të kandidatëve. Gjoba arrinte nga gjysmë-milion lekë në zgjedhjet lokale në 1 milionë në zgjedhjet parlamentare.

Testi i parë i ndryshimeve ishin zgjedhjet parlamentare 2013. Në këto zgjedhje KQZ aplikoi masa penalizuese ndaj subjekteve kryesore politike për shkak të mosrespektimit të kuotës gjinore në kandidim. Konkretisht, PS u penalizua⁶ me 6,000,000 lekë gjobë për mosrespektim të kuotës për gjininë femër në qarqet Tiranë, Durrës, Elbasan, Kukës, Dibër dhe Gjirokastrë. PD u penalizua⁷ me 4,000,000 lekë gjobë për të njëjtin motiv në shkelje të listave shumë-emërore në qarqet Elbasan, Kukës, Dibër dhe Berat. LSI u penalizua 4,000,000 lekë për mosrespektim të kuotës gjinore në qarqet Berat, Kukës, Durrës dhe Gjirokastrë⁸. Për herë të parë në zgjedhjet shqiptare KQZ penalizoi një parti politike për mosrespektim të kuotës gjinore 30% për gjininë mashkull. Objekt ishte Partia Popullore Kristiandemokrate⁹, e cila nuk e kishte respektuar kriterin e gjinisë në listat shumë-emërore për qarkun Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Tiranë dhe Vlorë.

Në zgjedhjet 2017 PS vijoi masat penalizuese përfshirë tri partitë kryesore politike, - në një rast për gjininë mashkull (LSI, lista proporcionale në Tiranë) dhe në gjitha rastet e tjera për mosrespektim të kuotës gjinore për gjininë femër (PD, PS, LSI, etj).

6 Vendim i KQZ, nr. 337, datë 11.05.2013.

7 Vendim i KQZ, nr. 340, datë 11.05.2013.

8 Vendim i KQZ, nr. 341, datë 11.05.2013.

9 Vendim i KQZ, nr. 373, datë 14.05.2013.

Ndryshimi më me ndikim në debatin politik lidhej me praktikën e zëvendësimit të deputetëve, në rastet e dorëheqjes ose papajtueshmërisë midis funksioneve. Me amendimet në Kodin Zgjedhor 2012 u përcaktua se “kur vakanca i përket një mandate të fituar sipas pikës 6 të nenit 67, ajo plotësohet nga kandidati i parë në listë i gjinisë përkatëse, pavarësisht renditjes në listë.” Mbi këtë bazë një sërë ndryshimesh në përbërjen parlamentare post 2013 (raste të dorëheqjeve, raste të papajtueshmërisë midis funksionit, raste të heqjes së mandatit nga Gjykata Kushtetuese, etj.), përfitues ishin gjinia femërore, e cila fillimisht ishte më pak e përfaqësuar nga lista fituese.

Ky proces shkaktoi debat politik dhe publik në të paktën dy raste: rasti i listës së deputetëve të PS Lezhë dhe rasti i listës së deputetëve të LSI Durrës. Në qarkun Lezhë pas dorëheqjes së ministres Kodheli nga mandati parlamentar, mandati i saj, sipas këtij kriteri, duhet të kalonte tek njëra nga dy gratë e tjera në listë, përkatësisht numrat 5 dhe 8 të listës së PS në Lezhë. Dy kandidatet dhanë dorëheqje nga pretendimi për deputete duke ia kaluar mandatin emrit të parë të gjinisë tjetër në listë, një deputet mashkull. E njëjta praktikë u aplikua edhe në listën shumë-emërore të LSI në Durrës, ku pas dorëheqjes së ministrit Koka, katër gra pjesë e listës shumë-emërore dhanë dorëheqje nga mandati parlamentar, për t’ia kaluar mandatin numrit 3 të listës, një kandidat mashkull.

Gjithsesi ka pasur raste kur ky përcaktim në Kodin Zgjedhor ka krijuar pozita të favorshme për kandidatet gra e vajza në listat shumë-emërore. Në një numër të konsiderueshëm rastesh, mandati i deputetëve meshkuj që e kanë lënë detyrën, për çfarëdo lloj arsyeje, i është kaluar kandidateve femra,

duke tejkaluar kandidatë meshkuj që ishin të renditur më sipër tyre. Për shembull, tejkalime të tilla kanë ndodhur në grupin parlamentar të PD-së për deputetë të rretheve Dibër, Elbasan, Shkodër, Kukës etj. Zhvendosje të tilla balancuese në aspektin gjinor (deri në shtatë vende) ndodhën më me shumicë në PS për deputetë të rretheve Tiranë, Berat, Durrës, Elbasan, Vlorë, etj. Tek LSI në Tiranë, mandati i dorëzuar nga numri dy i listës shumë-emërore tejkaloi tre kandidatë meshkuj për t’i kaluar kandidates së parë grua, numrit 7 të listës. Zhvendosje të njëjtë pati edhe në listën shumë-emërore të kësaj partie në Elbasan.

Në tetor 2016 një grup deputetesh¹⁰ të parlamentit shqiptar propozuan amendim në Kodin Zgjedhor duke kërkuar aplikimin me ligj të kuotave gjinore për listat shumë-emërore të partive politike dhe të koalicioneve në zgjedhjet e përgjithshme në masën 50 %. Në nismën e deputetëve theksohej se pavarësisht vendosjes së kuotave gjinore në KZGJ më 2008, partitë politike e shmangën këtë detyrim ligjor, duke i vendosur kandidatet gra ne fund të listës, e cila në disa raste kalonte numrin maksimal të deputetëve që mund të fitonin. Të dhënat referuese të nismës konstatojnë se me parimin e kuotës në ligj në parlamentin 2009-2013, vetëm 16 për qind e deputeteve ishin gra dhe se disa parti iu shmangën hapur kuotat gjinore të imponuara nga ligji akt për të cilin u dënuan së bashku në një vlerë me 22 milionë lekë nga KQZ në shtator 2013.

Bazuar në përvojën 2009-2015 me sistemin e kuotave në kandidim dhe në zgjedhje, iniciuesit e ndryshimit në Kodin Zgjedhor, kërkuan përfaqësim të barabartë gjinor (50% me 50%) për të rritur në mënyrë të

10 <http://wwfgs.alw2016w10w24wligji-ri-50-relacione>

cilësore përfaqësimin e grave ne politikë dhe për të forcuar rendin demokratik në vend.


Referuar të dhënave të listave shumë-emërore, siç tregon tabela nr.3, në vitin 2013 në katër raste gratë ishin udhëheqëse të listave në qarqe (Kodheli në Lezhë e Hafizi në Shkodër (PS), Topalli në Shkodër (PD) dhe Kryemadhi në Lezhë (LSI). Të detyruara nga Kodi Zgjedhor partitë kryesore preferuan më shumë kandidimin e grave në vendet e dyta (në 10 raste për tri partitë kryesore) ose në vendet e treta (në 13 raste për tri partitë kryesore).

Për shkak se Kodi Zgjedhor nuk përcakton detyrimin për përfaqësim me kuota gjinore në çdo tre kandidatë,

bie dukshëm numri i grave që kanë arritur të renditen në listat e partive kryesore në vendet e katërta (vetëm 3 gra), në vendet e pesta (vetëm 5 gra), në vendet e gjashta (vetëm 8 gra) dhe në vendet e shtata (vetëm 5 gra), ndërkohë që sa më në fund të listave shkohet aq më shumë gjenden gra kandidatë. Konkretisht, në vendet e teta ose të nënta në renditje gjenden përkatësisht 11 dhe 13 gra kandidatë nga PS, PD e LSI. Duke pasur parasysh se nga 12 qarqe vetëm 8 qarqe kanë më shumë se 8 deputetë, atëherë rezultojnë se renditja pas numrit 8 ose 9 i dedikohet vetëm këtyre qarqeve me numër të lartë mandatesh.

Në zgjedhjet parlamentare 2017 pati ndryshim pozitiv për sa i përket renditjes në listat shumë-emërore,


Tabela 11. Renditja e grave në listat shumë-emërore të PS, PD e LSI 2013



Është një fakt i njohur që cilësia e punës dhe e vendimit rritet kur gratë dhe burrat janë të dy së bashku në të njëjtin pozicion. Më shumë gra në politikë krijon mundësi për më shumë tematika në axhendë, siç janë çështjet e edukimit, sigurisë në rrugë, masat kundër dhunës së grave, etj.

DEWI VAN DE WEERD, AMBASADORE E HOLANDËS NË SHQIPËRI

Tabela 12. Renditja e grave në listat shumë-emërore të secilës parti konkurruese në zgjedhjet 2017



ndaj edhe pati rritje të numrit të grave deputete. Megjithatë, kjo risi nuk ishte proporcionale në të gjitha partitë politike, por vetëm në disa prej tyre. Tabela ilustron numrin e grave kandidate në vendet e para dhe të fundit në secilën nga subjektet konkurruese 2017.

Siç shihet, dy partitë kryesore PS e PD kanë vendosur përkatësisht gra në vendin e parë të listës shumë-emërore në 4 dhe 2 qarqe, si dhe në vendin e fundit në 6 dhe 2 qarqe. Edhe LSI ka dyfish më shumë gra në fundin e listës sesa në krye të saj. Nga partitë e tjera politike PR ka listën më përfaqësuese të grave e vajzave në vendet e para të listave të qarqeve, në 12 qarqe udhëheqin gratë e vajzat, - një rast unik,

por edhe skemë taktike për të tërhequr vëmendjen pozitive në zgjedhje. Vetëm 1 nga 18 subjektet elektorale, Partia Demokracia Sociale, nuk ka asnjë grua në krye të listave në qarqe, po ashtu PDS e PAD kanë rekord negativ, vendosje të femrave në vendin e fundit të listës së kandidatëve në 9 qarqe.


7.4. PËRFAQËSIMI I GRAVE NË PARLAMENT NË PERIU DHËN 1991 – 2017

Për të kuptuar më mirë ndikimin e praktikës së kuotës gjinore në kandidim (2009) dhe më pas me elementë në drejtim të kuotës në zgjedhje (2013) tabela nr. 4 ilustron tendencën e përfaqësimit gjinor përgjatë tranzicionit në Shqipëri. Tabela tregon se një nga faktorët ndikues në përfaqësimin gjinor, përveçse vullneti politik dhe niveli demokratik shoqëror dhe i partive politike, është edhe vetë sistemi zgjedhor. Në

sistemin mazhoritar (1991) vetëm 4% e parlamentit përbëhej nga gra e vajza. Kjo shifër vjen në kontrast të thellë me memorien e atyre viteve, kur në protestat dhe lëvizjet qytetare të kohës gratë dhe vajzat kishin një rol po aq aktiv dhe të rëndësishëm sa edhe gjinia tjetër e popullsisë.

Me sistemet mikse të votimit (1992-2005) pati rritje të vogël të përfaqësimit gjinor, midis 5.7 deri 15%. Kuota më e lartë u shënua në zgjedhjet e vitit 1996, të cilat janë një prej dy zgjedhjeve më të kontestuara të kësaj periudhe. Numri i madh i grave dhe vajzave deputete të asaj periudhe i dedikohet zonave të sigurta të kandidimit në mazhoritar si dhe prurjeve nga vende të sigurta në listën proporcionale. Me kalimin në sistemin

Tabela 13. Të dhënat në numër e përqindje të grave deputete 1991-2017



proporcional rajonal (2008) zgjedhjet pasuese 2009 sollën rritje të numrit të grave në parlament dhe përqindjes së tyre në raport me gjininë tjetër. Ky trend u ruajt edhe më 2013 dhe tashmë në 2016 është thelluar, për shkak të zhvillimeve brenda vetë parlamentit.

Një nga faktorët kryesorë të rritjes së numrit të grave deputete gjatë viteve të fundit është edhe klauzola ligjore e cituar më lart, sipas të cilës zëvendësimi i mandateve në listën shumë-emërore tek partitë kryesore, sidomos PS e LSI, bëhet me preferencë gjininë më pak të përfaqësuar. Me këtë kriter numri i grave deputete u rrit nga 25 më 2013 në 33 më 2017, edhe pse gjatë kësaj periudhë nuk ka pasur zgjedhje të reja parlamentare.

7.5. PËRFAQËSIMI I GRAVE NË ZGJEDHJET PARLAMENTARE 2009, 2013 DHE 2017

Në tri zgjedhjet e fundit politike, zgjedhjet parlamentare 2013, 2017 dhe zgjedhjet lokale 2015 ka tendencë rritjeje të përfaqësimit të grave / vajzave në politikën vendimmarrëse, si dhe tregues të ecjes drejt një politike më të balancuar gjinore. Konkretisht, në Kuvendin e Shqipërisë, më 2016, pas ndryshimeve të reja që ndodhën në listën e deputetëve pas kandidimit të disa prej tyre në zgjedhjet lokale, numri i grave/vajzave deputete arriti në shifrën 33 shifër rekord për të gjitha vitet e mëparshme të tranzicionit në Shqipëri. Në totalin e 140 deputetëve ato zinin 23% nga 18% që u regjistruan menjëherë pas zgjedhjeve 2013. Në krahasim i të dhënave midis zgjedhjeve me sistem të përzierë dhe proporcional rajonal tregon se

numri i i grave dhe vajzave kandidate u rrit nga 8.6% (kandidate direkt dhe ne lista) në 31.9% më 2009 në 39.6% më 2013.

Në zgjedhjet 2017 numri u rrit në 39, shifër më e lartë se në çdo zgjedhje tjetër parlamentare prej vitit 1991.

Për një vend si Shqipëria me burime të kufizuara njerëzore për një numër të madh partish konkurruese në zgjedhje siç ndodhi në zgjedhjet e vitit 2013 (66 parti politike), numri prej 7149 kandidatësh është dukshëm i lartë dhe kandidimi i 2839 grave e vajzave shënon një rekord historik. Gjithsesi një analizë e brendshme e listave shumë-emërore të partive politike, sidomos e partive të vogla dhe atyre që kanë vetëm përfaqësim simbolik lokal rezultojnë se kandidatet femra janë pjesëtare të afërta të drejtuesve të partive dhe rritja e numrit të grave mund të jete fiktive. Kjo tezë u vërtetua në zgjedhjet 2017, ku me përjashtim të 3-4 partive kryesore, të gjitha partitë e tjera krijuan lista me elementë fiktivë, kryesisht familjarë të drejtuesve qendrorë apo lokalë, për të arritur respektimin formal të detyrimit ligjor në numrin total të kandidatëve dhe brenda tyre, edhe për kuota gjinore të kandidimit.

Referuar raporteve gjinore të vitit të fundit të legjislaturës së kaluar (janar – korrik 2017) rezultojnë se qarku me përqindjen më të lartë të përfaqësimit gjinor (deputete gra / vajza) është Shkodra me 36,63%, ndjekur nga Elbasani e Lezha me nga 28,57%, si dhe Berat, Korçë, Kukës e Vlorë me nga 25%. Durrësi kishte kuota përfaqësimi prej 23% pasuar nga Tirana me 21,87% dhe Dibra me 16,66%. Qarku i vetëm pa asnjë deputete në parlament ishte Gjirokastra, qark në të cilin 5 deputetët janë të së njëjtës gjini (mashkullore). Kjo renditje e përfaqësimit gjinor në

Tabela 14. Të dhëna mbi gratë kandidate në zgjedhjet parlamentare 2005, 2009 dhe 2013.

	KANDIDATE	TOTAL	GRA / VAJZA	MESHKUJ		
2005	Kandidatë direkt	1235	98	7,94%	1137	92,06%
	Kandidatë lista	1968	169	8,59%	1799	91,41%
2009	Kandidatë lista	3713	1185	31,91%	2528	68,09%
2013	Kandidatë lista	7149	2834	39,64%	4315	60,36%
2017	Kandidatë lista	2666	1073	40,25%	1593	59,75%


qarqe dalloj dukshëm nga tabela e njëjtë për vitin 2013, dhe më pas dallon dukshëm edhe me listën e produktit elektoral të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2017.

Të dhënat krahasuese midis zgjedhjeve 2009, 2013 dhe 2017 pasqyruar në tabelë, tregojnë se vetëm qarqet Korçë e Berat kanë qëndrueshmëri në nivelin e përfaqësimit të grave në parlament. Tirana ka shifra të njëjta në dy zgjedhjet 2009 dhe 2013, por ka ndryshim thelbësor në zgjedhjet 2017. Dibra, Kukësi e Gjirokastra kanë bërë korrektime më 2017, duke evituar vlerësimet negative në zgjedhjet e mëparshme (Kukësi e Dibra më 2009 e 2013 dhe Gjirokastra më 2013). Në qarkun Durrës në zgjedhjet 2017 ka pothuajse më shumë gra deputete në përqindje sesa në dy zgjedhjet e mëparshme parlamentare. Në këtë qark më 2017, PS kandidoi me një listë të kryesuar nga dy gra deputete, ashtu siç LSI në Tiranë pati tre gra deputete në tre vendet e para të listës. Në Lezhë ka rënie të përqindjes së kandidimit kryesisht për shkak të zhvendosjes së kandidatës kryesore të LSI më 2013 drejt Elbasanit më 2017.

Vlora, Lezha e Shkodra janë tri qarqet me rënie të përqindjes së grave deputete nga zgjedhjet e mëparshme. Në Shkodër rënia i dedikohet ndryshimeve që ndodhën në listën e PD (në dy zgjedhjet e mëparshme një grua ishte kryesuese e listës së PD në këtë qark), kurse në Vlorë në zgjedhjet 2017 përqindja e grave në vendet fituese ose me potencial fitimi, ishin shumë larg pritshmërive dhe modeleve pozitive të disa prej qarqeve të tjera.


Referuar të dhënave të zgjedhjeve parlamentare 2017, PD pati përqindje minimale të përfshirjes së grave dhe vajzave në listat e kandidimit në krahasim me dy partitë e tjera konkurruese, PS dhe LSI. PD nuk kandidoi asnjë grua në Kukës dhe pati përqindje minimale në qarqe të mëdha si Elbasani apo Berati. Përqindja më e lartë e PD shkon në 33% në Gjirokastrë ku fitoi vetëm një mandat parlamentar dhe më pas 28% në Tiranë. Nga ana tjetër, për PS përqindja më e lartë e përfshirjes së grave dhe vajzave në listën shumë-emërore shënohet në Gjirokastrë me 71% dhe në Kukës me 50%, kurse kuota më e vogël është shënuar në Berat me 13%, e vetmja nën 30% e

Tabela 15. Përqindja e grave deputete në tri zgjedhjet e fundit parlamentare



kuotave të tjera në qarqe. Tek LSI kuota më e lartë e kandidimit të grave dhe vajzave është në Gjirokastrë, Shkodër e Dibër, dhe kuota më e vogël është në Fier, Korçë e Kukës, - në çdo rast, mbi 30% të listës shumëemërore.

Tabela 16. Përqindja e grave kandidatë në listat shumë-emërore të partive politike 2017



7.6. PËRFAQËSIMI I GRAVE NË ZGJEDHJET VENDORE 2011 DHE 2015

Në zgjedhjet lokale 2015, ndryshe nga zgjedhjet parlamentare 2013, partitë aplikuan rregulla më strikt të kandidimit dhe përfaqësimit gjinor. Për shkak se sistemi i votimit ishte miks, mazhoritar për kryetarët e njësive vendore dhe proporcional për listat e


këshilltarëve, partitë aplikuan sistem kuotash 50% vetëm për listën e këshilltarëve. Tabela 16 reflekton përfaqësimin sipas shifrave.

Bazuar në të dhënat zyrtare të vitit 2015, gratë e vajzat vijojnë të jenë të nën-përfaqësuara me vetëm 9 kryetare në 61 bashki, ose 14% të numrit total. Kandidate për kryetare bashkie pati në Shkodër (dy kandidatet Voltana Aademi dhe Keti Bazhdari),

Partitë politike, si bartëse e aksesit në pushtetin politik, luajnë një rol qendror në fuqizimin politik të grave. Udhëheqësit e partive politike kanë fuqinë për tu hapur dyert mundësive kritike, për të ofruar pozita udhëheqëse në parti ose për të krijuar kuota vullnetare për përfaqësim të barabartë. Gjatë fushatave, partitë politike mund të sigurojnë financim të barabartë për fushatat e grave. Partitë mund të krijojnë programe për të mbështetur kandidatët që konkurrojnë për herë të parë dhe të zhvillojnë politika të cilat sjellin avantazhe për gratë e tyre candidate. Pas zgjedhjeve, partitë mund të sigurojnë mbështetjen e nevojshme për të garantuar që politikanet e zgjedhura të vijojnë jetën politike dhe të ecin përpara.

BRIAN J. WILLIAMS, KOORDINATOR REZIDENT I OKB & DREJTUES I PNUD NË SHQIPËRI

Tabela 17. Të dhënat e përfaqësimit të grave në zgjedhjet 2011 dhe 2015



Durrës (Grida Duma), Sarandë (Florjana Koka), Pogradec (Diana Mile), Gjirokastrë (Zamira Rami), Patos (Rajmonda Balilaj), Përrenjas (Miranda Rira), Klos (Valbona Kola), Gramsh (Luljeta Dollani), Ura Vajguore (Juliana Memaj), Rroskovec (Majlinda Bufi), Libohovë (Luiza Mandi), Mat (Adelina Fariçi), Himarë (Lefteri Prifti), Selenicë (Alma Golemaj). Nga të gjitha kandidatet në zgjedhje, vetëm Golemaj në Selenicë ishte kandidate e pavarur.

Në votimin e dytë, atë proporcional, për në këshillat

bashkiake, kemi rritje të dukshme të prezencës dhe përqindjes së grave/vajzave, duke arritur 35% të numrit total të këshillave, ose 560 fituese në totalin e 1595 këshilltarëve në 61 bashkitë e reja. Në raport me zgjedhjet 2011 kemi një rritje të dukshme të kryetareve të bashkive, nga 1.3% në 14% në totalin e numrit të kryetarëve të bashkisë e komunave. Në krahasim me vitin 2007 (me 1.5%) rritja është gjithashtu e lartë, kurse në krahasim me vitin 2003 është shtatë herë më e lartë, nga 2% në 14%. Interesant është edhe fakti se bazuar në numrin e

grave/vajzave që kanë kandiduar për kryetare bashki/komunë në katër zgjedhjet e fundit, rezultoi se më 2015 patëm rreth 8 herë më shumë rritje të numrit të grave, 3 herë më shumë rritje sesa më 2007 dhe afërsisht po kaq herë në raport me vitin 2000.

Referuar numrit të grave/vajzave këshilltare lokale zgjedhjet 2015 shënojnë një progres të madh në raport me të kaluarën. Konkretisht, më 2015 u zgjedhën 31% e numrit total të këshilltarëve që kandiduan ose 35% e atyre që fitojnë, krahasuar me 12% në zgjedhjet e mëparshme të vitit 2011. Rritja me 2.5 herë më shumë më 2015 i dedikohet sistemit të ri zgjedhor, sipas të cilit, lista e kandidatëve për këshill duhej të reflektonte balancim gjinor në masën 50 me 50%.

Në nivel vend më 2015 kur për herë të parë u zbatua kuota 50% në listat e kandidatëve u zgjedhën 14% (ose nëntë) kryetare bashkie dhe 35% këshilltare bashkiake në 61 bashkitë e vendit. Në të dy rastet ky është një përfaqësim shumë herë më i lartë edhe sesa në 2011 dhe 2007. Së fundmi, gratë këshilltare po angazhohen duke krijuar aleanca të grave këshilltare në disa bashki të vendit. Ky është një hap pozitiv, që duhet nxitur dhe mbështetur për të forcuar realisht pozitën e grave vendimmarrëse.

7.7. 2017: KABINETI ME 10 MINISTRE, - PËRFAQËSIM REKORD I GRAVE NË QEVERI

Një nga aspektet kryesore të përfaqësimit të grave në partitë politike dhe në nivele të larta vendimmarrëse është edhe përfaqësimi në kabinetin qeveritar.


Referuar këtij treguesi, siç shihet në tabelën 9, e cila pasqyron numrin e grave ministre prej vitit 1991 dhe deri në mars 2017, së fundi është arritur numri më i lartë i grave ministre në historinë e tranzicionit dhe në historinë e Shqipërisë. Tabela 9 tregon më qartë kurbën e rritjes dhe diferencën e madhe midis aktualitetit dhe periudhës së fillimeve të tranzicionit.

Në qeveritë e para politike nuk kishte asnjë grua ministër derisa më 1995 emërua ministrja e parë (Suzana Panariti) për të rritur përfaqësimin më 1996 me katër gra ministre ose sekretare shteti. Kurba e përfaqësimit vijoi të ketë rënie e ngritje, në varësi nga kabinetet dhe krizat politike, - me tiparin, se sa më në krizë ishte vendi, aq më minimal ishte përfaqësimi i grave në qeveri, parlament dhe në parti politike.

Një tipar tjetër i kabineteve qeveritare midis 1997-2005 është fakti se në tërësi kemi 2-3 politikane gra që qarkullojnë në kabinete, pa zgjerim të numrit të grave konkurruese për poste të larta drejtuese. Të kësaj periudhe janë edhe tentativat e pasuksesshme brenda mazhorancave të majta për zgjedhjen e një gruaje kryeministri, në garën e brendshme partiake. Dy politikane, Meksi e Çeço konkurruan për kryeministre por humbën votimin përballë politikanëve Majko e Meta.

Midis viteve 2005-2013 numri i grave ministre ishte minimal, - kurse pas 2013 pati rritje të konsiderueshme të numrit të tyre, 6 ministre. Gjatë periudhës zgjedhore 2017, në qeveri u përfshinë edhe ministra teknikë të propozuar nga opozita. Në total numri i ministereve gra shkoi në 10 nga 21, shifra më e lartë në vite në numër (10) dhe përqindje (48%). Krijimi i kabinetit të ri të dalë nga zgjedhjet parlamentare 2017 ruajti këtë trend, dhe aktualisht

Tabela 18. Numri i grave ministre prej vitit 1991-2017



kemi 7 ministre në një kabinet me 15 portofola, ku një grua është zgjedhur zv/kryeministre. Në përqindje kemi 47% të kabinetit me përfaqësim nga gratë ministre, - shifër e lartë dhe unike për fillimin e legjislativës parlamentare dhe modelet ekzekutive në Shqipëri.

Një lexim i brendshëm i ecurisë së emërimeve, tregon se e majta dhe qeveritë e drejtuara prej tyre kanë qenë më të hapura ndaj grave politike dhe kanë përqindje shumë herë më të lartë përfaqësimi sesa qeveritë e djathta, - trend që provohet edhe nga studimet mbi sjelljen elektorale të votuesve gra e vajza.

7.8. KUVEND 2016-17: GRATË DEPUTETE 4 HERË MË SHUMË FJALIME SESA BURRAT

Të dhënat krahasuese flasin se gratë deputete janë në përqindje shumë më aktive sesa burrat deputetë. Konkretisht, bazuar në të dhënat në përqindje, rezultojnë se 90% e grave deputete kanë diskutuar në parlament, dhe vetëm 3 (10%) prej tyre nuk kanë diskutuar. Në total, të dhënat zyrtare tregojnë se 30 gra dhe 77 deputetë meshkuj kanë diskutuar në parlament përgjatë sesionit legjislativ të vitit 2016.

Dy elementë të tjerë me rëndësi, sidomos për

Tabela 19. Numri i diskutimeve të deputeteve gjatë dy sesioneve parlamentare të vitit 2016.

EMRI DHE MBIEMRI	PARTIA	SES I	SES II	TOTAL	EMRI DHE MBIEMRI	PARTIA	SES I	SES II	TOTAL
JOZEFINA TOPALLI	PD	14	10	24	ARTA DADE	PS	6	2	8
ALBANA VOKSHI	PD	0	8	18	EDLIRA CEKRI21	LSI	4	3	7
MIMOZA HAJDARMATA	PD	10	7	17	DHURATA CUPI	PD		7	7
MESILA DODA	PDIU	9	7	16	IRMA KOPLIKU	PD	2	5	7
MIMOZA HAFIZI	LIBRA	6	8	14	MAJLINDA BREGU	PD	3	4	7
JORIDA TABAKU	PD	5	9	14	ELEINA QIRICI	PD	2	4	6
ANTONETA DHIMA	PS	8	4	12	OLTA XHACKA	PS	4	2	6
ARBIOLA HALIMI	PD	7	5	12	SILVA CAKA	LSI	1	4	5
BLEFUNA GJYLAMETI	PS	8	3	11	ERJETA ALHYSA	PS	3	2	5
VASILIKA HYSI	PS	7	4	11	ADELINA R1STA	PS	3	1	4
MIDI MEHMETAJ	LSI	8	2	10	ESMERALDA SHKJAU	PS	3	1	4
EVIS KUSHI	PS	7	3	10	MIRA SHEHU	PS	2	0	2
KLODIANA SPAHIU	PS	6	4	10	MIRELA FERRACAKU	PKD	1	0	1
ALBINA DEDA	PD	3	6	9	MONIKA KRYEMADHI	LSI	0	0	0
LILIANA ELMAZI	PD	5	4	9	ENKELEJDA SHKRELI	PS	0	0	0
ANILA AGALLIU	PS	6	2	8	LULJETA ARAPI	PS	0	0	0

MONITORIMI I KUVENDIT: JANAR-DHIE7OR 2016. ISP

ligjërimit parlamentar, kanë vlerë në statistikat gjinore të Kuvendit. E para, me lidhet me numrin e lartë të grave e vajzave diskutuese në seanca. E dyta, diskutimet dëshmojnë se problematikat që lidhen me

pozitën e gruas dhe çështjet sociale nuk kanë zënë ndonjë vend parësor në këto fjalime. Në listën e 32 grave më me shumë fjalime në parlament, dominuese janë gratë opozitare (zënë përkatësisht vendet 1-3 dhe

*Perceptimi i demokracisë partiake në Shqipëri
përgjithësisht është i ulët dhe një fushë që
unë besoj se partitë politike në Shqipëri
duhet të punojnë dhe përpiqen më shumë.
Demokracia e brendshme partiake është
shumë e rëndësishme në mënyrë që të sjellë
vendime më të mira, si dhe për të promovuar
gra të talentuara dhe të përgatitura njësoj si
udhëheqësit politikë burra.*

JOHAN NDISI, AMBASADOR I SUEDISË NË SHQIPËRI

4-6); tre deputete të PS kame mbajtur 10-11 fjalime dhe kaq te LSI kane mbajtur kaq fjalime. Tre deputete nuk kane mbajtur asnjë fjalim parlamentar, dy nga PS dhe një nga LSI. Më me shumë fjalime figurojnë Topalli, Vokshi, Hajdarmataj (PD) me nga 24, 18 dhe 17 fjalime, ndjekur nga deputetja Doda (PDIU) me 16 fjalime, dy deputetet Hafizi e Tabaku me nga 14 fjalime, Dhima e Halimi me nga 12 fjalime, etj. Grupi i deputeteve të PS (Gjylameti, Hysi, Kushi, etj), pasojnë me 10-11 fjalime, kurse në fund të listës, kemi tre deputete pa asnjë fjalim parlamentar, dy nga PS dhe një nga LSI.

Nga analiza që ISP ka bërë mbi brendësinë e fjalimeve të deputeteve, rezulton se fjalimet e deputeteve gra e vajza kanë qenë kryesisht politike dhe në sinkron me ligjërimin politik të liderit të partisë. Gjithashtu, rezulton se vetë midis disa grave deputete ka pasur replika të ashpra, siç janë debatet në komisionin e shëndetësisë apo në replikat për meritat në nisma ligjore të ndërmarra nga deputete të PS, PDIU e PS. Nga deputetet ka një pritshmëri më të lartë për të përdorur gjuhë më korrekte jo vetëm politikisht, por edhe mes tyre në mënyrë që edhe përpjekjet për të arritur barazi gjinore të justifikohen. Pavarësisht se gratë politikane fillimisht janë të tilla dhe kanë këtë rol primar, publiku por dhe mbështetësit e tyre kërkojnë më shumë, kërkojnë që ato të sjellin një ndryshim të mirëpritur në uljen e agresivitetit të politikës shqiptare.


7.9. GRATE POLITIKANE DHE DEKRIMINALIZIMI

Gjatë 2016 dhe 2017 temë dominuese e debatit politik ka qenë zbatimi i ligjit të de-kriminalizimit. Ky ligj parashikon përjashtimin nga postet politike dhe zyrtare të individëve që kanë kryer vepra kriminale brenda e jashtë Shqipërisë.

62 raste dorëheqjesh, shkarkimesh ose hetimesh janë regjistruar në fund të vitit kalendarik të zbatimit të ligjit (mars 2016 – mars 2017). Nga këto raste, vetëm 5 raste janë gra politikane ose drejtuese. Në asnjë nga rastet e grave nuk kemi të bëjmë me akuza për vepra kriminale, por për mosdeklarime të rregullta të të ardhurave/pasurive, dhe moszbatim të periudhës administrative të deklarimit. Ndërkohë, në listë bëjnë pjesë disa deputetë meshkuj, (tre të dorëhequr, 3 të larguar dhe 6 nën hetim), si dhe rreth 25 të shkarkuar, pjesa më e madhe e tyre me rekorde kriminale në të kaluarën.

Elementë të kriminalizimit të politikës, sidomos të kandidimit në zgjedhjet 2013 dhe 2015 të individëve me rekorde kriminale për të pasur poste politike në parlament apo në bashki, konsiderohen gjerësisht si një nga pengesat serioze për një klimë cilësore përfaqësimi gjinor. Sipas të dhënave nga fokus grupet dhe nga intervistat, rezulton se gratë në politikë e kanë të vështirë të drejtojnë fushata konkurruese në zona dhe bashki ku përballen me politikanë me rekorde kriminale. Për këtë arsye, ecja drejt frymës së ligjit, - largimit nga postet politike të individëve me rekorde kriminale, shihet edhe si një tregues pozitiv në përpjekjet për përfaqësim më të lartë të grave në partitë politike, në parlament dhe në poste të tjera politike.

Tabela 20. Të dhënat e shkarkimeve për shkak të dekriminalizimit, nga këndvështrimi gjinor 2016-2017



8. GJETJET KRYESORE NGA INTERVISTAT DHE FOKUS GRUPET

ISP zhvilloi 15 intervista me drejtues politikë: në nivel partie dhe në nivel organizatash të grave në partitë politike parlamentare. Në intervista u përfshinë shtatë partitë parlamentare, prej tyre, 4 janë politikanë dhe 11 janë politikane. Nga këto 4 janë intervista nga drejtues në PS, 3 në PD, 2 në LSI, 2 në PR, 2 në PDIU, 1 PBDNJ dhe 1 LIBRA. Për partitë kryesore intervistat kanë përfshirë 3 kategori: kryetaren e forumit të grave në parti, politikanin më të lartë përgjegjës për organizimin e partisë, dhe një figurë lokale të partisë. Për partitë e tjera janë përgjigjur drejtuesi i partisë që mbulon organizatat partnere ose kryetaren e forumit të gruas. Qëllimi i intervistave ishte ballafaqimi i gjetjeve tona me këndvështrimet zyrtare të partive politike, dhe marrja prej tyre e eksperiencave konkrete në dy nivele, në vendimmarrjet politike dhe në aktivitetin normal organizativ të partive.

Në intervista u përfshinë edhe përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar në Tiranë si delegacionit të BE, ambasadave amerikane, gjermane, suedeze, holandeze, etj., si dhe organizatave ndërkombëtare UNDP, OSBE dhe USAID. Ndryshe nga përzgjedhja në rastin e partive politike përzgjedhja e organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare është bërë kryesisht mbi informacionet nëse ato kanë fokus çështjet gjinore dhe nëse kanë vullnet për tu përfshirë në studim.

ISP zhvilloi dy fokus grupe me përfaqësuese nga partitë politike, nga këshilltaret në Tiranë, nga bota akademike, nga media, OJF të njohura dhe aleanca e grave këshilltare. Gjithsej ishin 18 pjesëmarrëse të ndarë në dy grupe. Tematika e fokus grupeve u përqendrua në tiparet kryesore të raporteve të përfaqësimit të grave në partitë politike, raportet e grave në proceset e brendshme zgjedhore, raportin me fushatat zgjedhore, raportin me median dhe me ligjërimin publik.

8.1. OPINIONE MBI KODIN ZGJEDHOR DHE LIGJIN E PARTIVE

Të gjithë të intervistuarit kanë vlerësim parimor pozitiv për ndryshimet ligjore që mundësuan realizimin e kandidimit gjinor 30% në zgjedhjet parlamentare dhe 50% në zgjedhjet lokale, por ka pikëpamje të ndryshme mbi produktivitetin dhe aplikimin afatgjatë të sistemit të kuotave.

Në intervista nuk ka kritika të drejtpërdrejta ndaj neneve ligjore apo praktikave interpretuese të tij. Partitë citojnë rregullat e tyre statutores dhe secila përpiket të paraqitet si model pozitiv i harmonisë dhe përfaqësimit gjinor. Ato, në tërësi, e konsiderojnë



promovimin përmes kuotës si çështje standardesh dhe vullneti politik, dhe duke vlerësuar politikat e tyre shprehin kritika ndaj mënyrave sesi palët rivale politike e kanë aplikuar atë.

Në vlerësimin mbi bazën ligjore aktuale për zgjedhjet parlamentare mbi 80% e pjesëmarrësve e fokus grupeve ishin kritikë, duke evidentuar nevojën e kalimit nga kuota gjinore kandidimi në kuota gjinore zgjedhore. Ecuria e sistemit të kuotave gjinore vlerësohet pozitivisht nga të gjitha forumet e grave dhe zërat e angazhuar në çështjet gjinore. Evoluimi është i dukshëm kur krahasohet me fillimet e debatit mbi kuotat. Në fillim të viteve 2000 koncepti i kuotave duhej utopik¹¹ kurse 1.5 dekada më vonë sistemi i kuotave 30% është pranuar dhe debati lidhet me propozimin për rritjen e tyre.

8.2. VLERËSIMI PËR SISTEMIN ZGJEDHOR

Vetëm dy nga të intervistuarit shprehën opinione konkrete për efektin e sistemit zgjedhor në përfaqësimin gjinor. Znj. Mesila Doda, kryetare e Aleancës së Grave Deputete, mendon se “një sistem proporcional kombëtar i korrigjuar në një zonë zgjedhore proporcionale e pastër do të ishte shumë mirë që të dilnin gra,”¹². Sekretari i përgjithshëm i LSI Z.Rama mbështet idenë e rritjes së kuotës por edhe të sistemit me lista të hapura, “në mënyrë që votuesi

e vlerëson dhe mbështet atë që bind, ka vota dhe ka njohje publike”.

Duhet theksuar se ndryshimi i sistemit elektoral nuk ka qenë dhe nuk është pjesë e agjendës dhe as propozim për debat në komisionin parlamentar për reformën zgjedhore 2015-2017 ku partitë e dy politikanëve të mësipërm kanë përfaqësuesit e tyre.

8.3. VLERËSIMI PËR APLIKIMIN E KUOTAVE GJINORE

Vlerësimi pozitiv për kuotat gjinore ishte unanim mes të intervistuarve individualisht. Deklarime të tilla, si “pa kuota, - kam binden absolute, se përfaqësimi i nivelit të grave në politike do të ishte shumë më i ulët nga ai që është sot”¹³ apo “jam e bindur se do kishim shumë më pak gra deputete nëse shohim numrat reale të grave në parlament përpara se të vihej kuota¹⁴” janë tregues i vlerësimit pozitiv. Një deputete vlerëson shoqërinë shqiptare si “në një stad të shoqërisë duhet një ndërhyrje pak e fortë sepse po të presësh një rritje graduale nuk premtan koha. Masa të forta për të rritur pjesëmarrjen e grave duhet të jenë të dobishme për shoqërinë”¹⁵.

Pjesëmarrësit e fokus grupeve u shprehën pozitivisht për sistemin e kuotave pasi kuotat kanë rritur numrin e grave në politike, interesimin e grave për politikë dhe

11 Mirela Bogdani, keshilltare FRD, Tiranë, deklarim në fokus grup

12 Mesila Doda, Kryetare e Aleancës së Grave ë Sekretare e Përgjithshme, PDIU

13 Olta Xhaçka, Kryetare e Forumit të Grave, Partia Socialiste

14 Albana VOKSHI – kryetare e Lidhjes Demokratike të Gruas (LDG) në Partinë Demokratike

15 Mimoza Hafizi, Zv.kryetare, Aleanca e Grave Deputete, PS Lista

Përshtypja ime personale, natyrisht subjektive, mbi rolin e grave në politikën shqiptare është shumë pozitive. Unë i perceptoj argumentet e grave në debate shpesh shumë më racionale, më mirë të mbështetura me një logjikë bindëse, ndërkohë që burrat më shpesh argumentojnë bazuar në bindjet politike dhe përdorin slogane dhe gjuhë të ashpër.

BERND BORCHARDT, KRYETARI I PREZENCËS SË OSBE NË SHQIPËRI

konkurrim në zgjedhje. Por interesimi për kuotat ka qenë ciklik duke u rritur në prag zgjedhjesh dhe ulur pas tyre.

Argumente të tjerë kritike ishin paqartësitë në bazën ligjore¹⁶, qasja e vetë partive politike ndaj përfaqësimit gjinor¹⁷, abuzimi me përcaktimin ligjor “dhe” – “ose” referuar kuotave, mundësia që partitë të kandidojnë shumë më tepër se 140 emra duke vendosur në renditjet e fundit kandidatët gra e vajza¹⁸, listat fiktive nga partitë e vogla dhe masat e lehta të penaltetit mbi subjektet që shkelin ligjin. Grupet ngritën nevojën e një mekanizmi të qartë detyruës që lidh respektimin e kuotës gjinore me regjistrimin e subjektit, pasi mekanizmi i gjobës financiare nuk është efektiv¹⁹, subjektet kryesore politike nuk e kanë shqetësim pagesën e shumës financiare.

8.4. VLERËSIMI MBI VËSHTIRËSITË NË APLIKIMIN E KUOTAVE

Rreth gjysma e të intervistuarave bashkohen në vlerësimin se perceptimi dominues brenda partive politike është i tillë, që politika konsiderohet një fushë “ku gratë hyjnë me vështirësi sepse është një çështje pushteti dhe pushtetmbajtësit kanë qenë burrat”²⁰.

16 Erisa Xhixho, këshilltare, LSI, deklaram në fokus grup

17 Klotilda Ferhati, keshilltare PS, Tiranë, deklaram në fokus grup

18 Anna Xheka, pedagoge, deklaram në fokus grup

19 Klotilda Ferhati, keshilltare PS, Tiranë, deklaram në fokus grup

20 Mesila Doda, Kryetare e Aleancës së Grave ë Sekretare e Përgjithshme, PDIU

P.sh., në zgjedhjet 2009 Kukësi apo Dibra nuk kanë pasur grua në listën e kandidimit për deputet (PD), ku “kanë preferuar më shumë të paguanin gjobën sesa të vinin një grua në listë”. E njëjta gjë vlen për PS në Gjirokastër 2013, LSI në Kukës 2009 dhe PD në 12 qarqet më 2017, etj. Devijime të tilla janë pranuar nga partitë politike si praktika që rezultojnë prej kapaciteteve të kufizuara lokale, skemave taktike për më shumë vota dhe diferencave në zhvillimin demokratik midis zonave të ndryshme. Të intervistuarit e tjerë bashkohen në vlerësimin se kuotat ndihmojnë të kalohen pengesat kulturore dhe politike dhe të krijohet baza e besimit për një sistem më përfaqësues.

8.5. VLERËSIMI MBI MODELIN E GRUAS DEPUTETE

Rreth 60% e të intervistuarave mendojnë se ka modele pozitive, por vlerësimi lidhet me modelin që kërkohet. Sipas Znj. Vokshit (PD), “është e vështirë të thuash se cila grua është më e mirë dhe cila mund të jetë modeli i vërtetë sepse gra te ndryshme kane modele të ndryshme. Por mendoj që shumë gra deputete mund të jenë modele për gra dhe vajzat dhe janë shumë serioze, pjesa më e madhe e tyre edhe profesioniste”. Znj. Braho (PDIU) shikon pozitivisht përfaqësimin e grave në pushtetin vendor, në dallim nga parlamenti ku “shikoj një ashpërsi te grave ne politike dhe kjo vjen si rezultat i luftës që gruaja duhet të bëjë vazhdimisht çdo ditë me burrat si rezultat i politikës së momentit”²¹. Megjithatë, në një rast, një

21 Vjollca Braho, kryetare e grave, PDIU

e intervistuar (Z. Isufi, drejtuese e grave të PD në Vlorë), thotë se “pas marrjes së mandatit nuk zbrasin poshtë të shikojnë çfarë ndodh me qytetarët që i kanë votuar”²², i cili është një koment i përgjithshëm nga qytetarët për politikanët.

8.6. VLERËSIMI I POLITIKANËVE MBI KUOTAT DHE REZULTATIN E TYRE

Kryesisht kritikën ndaj konceptit të kuotës, modelit të grave në politikë dhe prurjeve cilësore vijnë nga të gjithë deputetët meshkuj e intervistuar, për të cilët dy janë problemet: diskriminimi në konkurrencë dhe keqpërdorimi i kuotës për sasi përfaqësimi. Sipas sekretarit organizativ në PD z.Bozgo, megjithëse mbështet sistemin e kuotave gjinore, apelon që “nuk duhet të abuzohet në emër të kuotave sepse artificialiteti i kuotës ka një limit, tejkalimi i limitit pastaj sjell një problematikë tjetër, në emër të kuotës nuk mund të hyjnë njerëz që nuk kanë lidhje me politiken dhe janë të paafte për t’u marrë në politikë. Kuotën unë e kuptoj më shumë si shans për t’u promovuar se sa si një lëvizje me një detyrim”.

Edhe PS ka të njëjtin qëndrim kritik. Sipas deputetit Sterkaj “çdo grua të luftojë për t’u futur në politikë, kushtet ligjore janë, mundësitë janë, dhe kanë hapësirën e mjaftueshëm për të dhënë kontributin e tyre. Por, asgjë nuk dhurohet, çdo grua që kandidon për të qenë diku, duhet të hedhë hapa të guximshëm për të dalë nga mentaliteti, duhet ta fitojë vetë garën”²³.

22 Barie Isufi, drejtuese e LDG, Vlorë

23 Paulin Sterkaj, Deputet, Koordinator, PS qarku Shkodër

Zoti Karamelo (PBDNJ) ruan të njëjtën linjë. Sipas tij²⁴, “tendenca për të rritur kuotën gjinore në partitë politike, në mënyrë thjesht sasiore nuk më duket bindëse, sepse përvoja parlamentare, ndoshta dhe zhvillimet e fundit politike, megjithëse është rritur numri i grave, dëshmojnë se cilësia e diskutimeve dhe aktivizimi i tyre nuk është në ato nivele që duhet”. Ai sugjeron karrierë graduale, fillimisht në strukturat e partisë dhe më pas në jetën politike publike.

Zoti Luan Rama, drejtues i rëndësishëm politik në LSI, thotë se sistemi i kuotave “deri tani ka prodhuar më shumë numra sesa vlera. Unë jam deputet, por nëse do të më pyesësh, të të them 10, 15 emra deputetesh nuk do të mund t’i numëroja dot. Pse? Sepse një pjesë e tyre vijnë për shkak të numrit të kuotës. Me gjithë respektin që kam për to, nuk përfaqësojnë vlerën reale me të cilën do të duhej të përfaqësohej gruaja në këtë institucion. Tempulli i demokracisë nuk mund të jetë tempull që nuk përmbush kriteret e demokracisë”²⁵. Ai apelon për një balancim midis prurjeve gjinore sasiore e cilësore, pasi sipas tij, sistemi aktual me lista të mbyllura ka krijuar një model përfaqësimi gjinor “në të cilin deputetët gra shfaqen shpeshherë më mashkullorë sesa meshkujt e Kuvendit dhe nuk përfaqësojnë realisht atë që është femra në realitetin shqiptar”²⁶.

24 Ligorag Karamelo, Nënkyetar, Partia Bashkimi i të Drejtave të Njeriut

25 Luan Rama, Nënkyetar, Lëvizja Socialiste për Integrim

26 Luan Rama, Nënkyetar, Lëvizja Socialiste për Integrim

8.7. VLERËSIMI I GRAVE DEPUTETE PËR PRURJET E SISTEMIT TË KUOTAVE

Opinione të tjera nga politikanët meshkuj kanë gratë politike në lidhje me sistemin e kuotave dhe produktivitetin e tyre në këtë fazë të zbatimit. Sipas tyre²⁷, “po t’i njohësh nga afër gratë e parlamentit ndoshta është pjesa më e mirë e parlamentit në Shqipëri”.

Znj. Xhaçka (PS) i përgjigjet kritikës “mashkullore” duke theksuar se “nuk besoj se në rastin e grave duhet bërë një analizë sasie dhe cilësie për sa kohe që nuk ka një diskutim të tillë për burrat në politike, dhe për atë kohë sa konsensusi për një përkufizim të dakordësuar se çfarë përbën një politikan “cilësor” mungon²⁸. Nuk ka pse numri më i madh i grave që futen përmes kuotave të mos përkojë edhe me një cilësi të shtuar në detyrën e ligjvënësit”.

Edhe znj. Voshki (PD) shkon në të njëjtën linjë. Sipas saj “shumica e grave deputete janë shumë herë më të mira se shumë burra deputetë, dhe këtë e bazoj tek statistikën që gratë kanë folur shumë më tepër sesa burrat, kanë trajtuar shumë herë me shumë tematika sociale se sa burrat dhe e marrin punën shumë herë më shumë me seriozitet sesa burrat”²⁹.

27 Mimoza Hafizi, Zv.kryetare, Aleanca e Grave Deputete, PS dhe më pas “Lista”

28 Olta Xhaçka, Kryetare e Forumit të Grave, Partia Socialiste

29 Albana VOKSHI – kryetare e Lidhjes Demokratike të Gruas (LDG) në Partinë Demokratike

Faktor pengues në standarde më të larta të përfaqësimit gjinor identifikohet ligjërimi i ashpër politik midis partive. Znj. Laboviti (PR) citon³⁰ edhe rastet e denigrimit të figurës femërore në parlament dhe bën diferencën midis grave politike të ardhura përmes meritës dhe atyre të ardhura për shkak të kuotës. Të parat, sipas saj, “janë më të afta të përballojnë debatet dhe i rezistojnë retorikës denigruese”, të dytat frikësohen prej saj.

8.8. OPINIONE MBI PROPOZIMIN PËR KUOTA 50% PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE

Nisma e grave deputete të PS dhe LSI për ndryshimin e Kodit Zgjedhor dhe aplikimin e kuotës 50% të zbatuar në zgjedhjet e fundit vendore në këshillat bashkiakë, edhe në zgjedhjet parlamentare 2017 përbën një fokus të veçantë në intervistat e zhvilluara.

Nga përgjigjet rezulton se propozimi për rritjen e kuotës së përfaqësimit parlamentar në 50% nuk ka të njëjtin konsensus si në rastin e kuotës 30%. PS është nismëtare dhe e mbështet idenë, dhe këmbëngul se “ky është një vendim që kërkon dhe përfshin shumë më tepër aktorë se gratë brenda partive politike”³¹. Opozita nga ana e saj e sheh si nismë të njëanshme, “pa u shtruar, e pa konsultuar e pa debatuar nga Aleanca e Grave deputete” dhe i druhet përdorimit

30 Brunilda Laboviti, Nënkryetare e Partisë Republikane

31 Olta Xhaçka, Kryetare e Forumit të Grave, Partia Socialiste

“në kuadër të propagandës³². Znj. Doda, mendon gjithashtu se “për të arritur në një rezultat pozitiv, do duhet të kishite një qasje që tejkalon ndasinë partiake, gjë që nuk ndodhi me iniciativën e PS³³. Preferenca e saj ishte debatimi i nismës brenda aleancës së grave deputete dhe më pas, kalimi në parlament. Asnjë prej kryetarëve të partive politike parlamentare nuk ka shprehur publikisht mbështetje për nismën dhe kjo nisme shihet me skepticizëm nga të gjithë politikanët meshkuj.

Shumica e ekspertëve bashkohen në vlerësimin se vetëm vendosja me ligj e detyrimit për 30% ose 50% mund të detyrojë palët politike të aplikojnë sistemin e kuotave. Lënia jashtë ligjit por si detyrim moral apo angazhim politik nuk sjell ndërgjegjësimin dhe presionin e nevojshëm. Vendosja e kuotave gjinore prej 50% në Kodin Zgjedhor kërkon konsensus dhe përfshirje më të gjerë të Aleancës së Grave, të gjitha partive politike dhe shoqërisë civile dhe jo thjesht.

Referuar përvojave dhe studimeve³⁴ ne momentin që arrihet përfaqësimi prej 30% është arritur masa kritike që i bën gratë të identifikohen si grup përfaqësues, të afta të krijojnë brenda tyre mekanizma promovues për rritjen e përfaqësimit. Më shumë se kalimi në kuotën 50% merr rëndësi cilësia e përfaqësimit, pasi kuotat janë zgjidhje e përkohshme, ndërsa cilësia e përfaqësimit garanton vazhdimësi.

32 Albana VOKSHI – Kryetare e Lidhjes Demokratike të Gruas (LDG) në Partinë Demokratike

33 Mesila Doda, Kryetare e Aleancës së Grave e Sekretare e Përgjithshme, PDIU

34 Ada Huibregtse, eksperte, OJF, deklaram në fokus grup

8.9. VLERËSIMI MBI KUOTAT LIGJORE VS KUOTAT STATUTORE NË PARTITË POLITIKE

Të gjithë të intervistuarit u pyetën nëse gjejnë kritere të përbashkëta apo dallime midis praktikës së kuotave gjinore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe atyre të përcaktuara në statutet e vetë partive politike për proceset e brendshme zgjedhore. Vlerësimi i tyre ishte se sistemi i kuotave ligjore dallon nga sistemi i kuotave statutore në partitë politike. Të parat janë detyrim ligjor, të dytat janë orientuese dhe realizohen vetëm nëse ka vullnet e klimë politike mbështetëse në parti. Znj. Vokshi (PD) thekson se “është shumë e vështirë për një grua nëse nuk i jep kuotën 30% që të futet në strukturat partiake. Është më e lehtë të futesh në struktura të larta si deputete sesa të futesh në strukturat në një degë çfarëdo lokale”³⁵. Propozimi i saj është ndryshimi i karakterit të strukturave partiake, nga struktura thellësisht politike në struktura edhe të karakterit social. Argumenti i saj mund të shpjegohet në kontestin kur partitë, sidomos degët lokale, funksionojnë kryesisht si organizime militante, për fushatë, mitingje, protesta, etj, dhe jo si qendra të debatit politik.

Duke e parë nga perspektiva e partisë së saj, edhe znj. Braho (PDIU) mendon PDIU ka evoluar nga “parti mashkullore” në një parti që ofron mbështetje për gratë dhe rolin e tyre në parti.³⁶ Duke pranuar potencialet e grave në përfaqësim, z. Karamelo citon

35 Albana VOKSHI – kryetare e Lidhjes Demokratike të Gruas (LDG) në Partinë Demokratike

36 Vjollca Braho, kryetare e grave, PDIU

Disa parti janë duke vendosur një standard të ri me aplikimet e kuotave gjinore me strukturat partiake të tyre. Ky është një trend i ri i cili shpresoj të përkrahet dhe nga partitë e tjera politike, veçanërisht nga partitë e mëdha në Shqipëri.

DEWI VAN DE WEERD, AMBASADORE E HOLANDËS NË SHQIPËRI

me tone kritike edhe partinë e tij, duke thënë³⁷ se “kemi pasur raste në Sarandë, Korçë por edhe këtu në Tiranë, ku disa gra kanë qenë edhe aktiviste dhe e meritonin të ishin në vend të parë të listës papritur e kanë parë veten në pjesën e fundit të listës, dhe kjo i dekurajon ato dhe i bën ato që të tërhiqen”.

8.10. DEMOKRACIA E BRISHTË BRENDA PARTIAKE, PENGESË PËR PËRFAQËSIM

Mungesa e demokracisë funksionale brenda partive politike identifikohet nga intervistat si një pengesë e rëndësishme për karrierë mbi bazë vlerash, meritash dhe konceptesh cilësore përfaqësimi. Partitë me demokraci funksionale do të ishin institucione me hapësirë “shumë herë më të madhe edhe për më shumë gra në politikë, më shumë hapje dhe më shumë prurje të reja”³⁸.

Ekspertja Majlinda Keta, ish-drejtuere e grave në PS, është kritike për kontrastin real që forumet e grave kanë me partitë e tyre³⁹. Ajo e krahason raportin mes tyre si raportet midis Shqipërisë reale dhe Shqipërisë virtuale. Sipas saj, forumet nuk kanë buxhete të formuara, nuk kanë struktura permanente, nuk kanë aktivitet të qëndrueshëm dhe kanë rol minor në vendimmarrjen politike. Ajo mendon se sistemi

37 Ligorag Karamelo, Nëkryetar, Partia Bashkimi i të Drejtave të Njeriut

38 Albana VOKSHI – kryetare e Lidhjes Demokratike të Gruas (LDG) në Partinë Demokratike

39 Majlinda Keta, pedagoge, ish kryetare e grave, PS.

piramidal i drejtimit të partive politike, sistem i cili preferon promovime individuale dhe jo produkte të votimit, konkurrencës dhe vlerave politike, është një arsye për mosfunksionim të forumeve të grave.

8.11. NDIKIMI I “TË FORTËVE” NË GARËN ZGJEDHORE

Duke iu referuar përvojës elektorale 2013 ka një dakortësi midis politikanëve të intervistuar se “të fortët”⁴⁰ që hynë në politikë dhe në parlament përbëjnë kërcënimin kryesor për një garë elektorale të ndershme dhe me shanse në përfaqësimin gjinor.

Problematika pranohet nga të gjithë aktorët e intervistuar. Kështu, p.sh. zonja Xhaçka (PS) thotë se “të fortët në politikë janë pa diskutim një pengesë për gratë në politikë. Gjykoj që kjo ndoshta është një nga arsyet kryesore pse partitë politike nuk preferojnë të kenë shumë gra në ballë të garave elektorale. Ato paragjykojnë si “jo të forta” mjaftueshëm për t’u përballur me gjithë ndryshoret e ekuacionit zgjedhor⁴¹. Edhe zonja Hafizi (Libra) pranon se problematika e të “fortëve” ishte dominuese sidomos në disa zona veriore, ku “vetoja e “të fortëve” ka qenë dominante, bashkë me kryetarin që personalisht vendosi”. Zonja Doda (PDIU) citon përvojat negative të detyrimit për dorëheqjen e grave deputete në Lezhë e Durrës, dhe thekson se “ajo që ishte e rëndë ishte që

40 “Të fortët” konsiderohen kandidatë me rekorde të kaluara kriminale ose individë me mbështetje të fuqishme financiare dhe krahinore, të cilët u shfaqën si dukuri në zgjedhjet parlamentare 2013 dhe zgjedhjet lokale 2015.

41 Olta Xhaçka, Kryetare e Forumit të Grave, Partia Socialiste

sistemi bënte sikur nuk e kuptonte dhe pas 6 muajsh pastaj kur pasi konflikti i hapur atëherë, u kujtuan që kishte ndodhur...Si zakonisht në Shqipëri fiton më i forti dhe pastaj ai sjell faturën me vete”⁴².

8.12. DIFERENCAT MIDIS FUSHATËS NË ZONAT RURALE DHE URBANE

Shumica e të intervistuarve dhe pjesëmarrësve të fokus grupeve e shohin pjesëmarrjen dhe promovimin e grave në zonat rurale më të ulët se në ato urbane dhe në Tiranë më të lartë se jashtë saj, si rrjedhim i mentalitetit dhe kulturës me të theksuar patriarkale dhe rezistencës mashkullore në zonat me përfaqësim të ulët, si dhe indiferencës partiake për t’i përfshirë gratë në politike. Lidhur me kulturën patriarkale, një deputet sjell rastin e Kukësit, ku partia e tij e kishte të pamundur pajisjen me kartë anëtarësie të grave e vajzave anëtare, pasi “burrat e kishin të vështirë të jepnin fotografinë e gruas për t’u vendosur në kartën elektronike të anëtarësisë”⁴³. Një tjetër deputet, lidhur me gjendjen e përfaqësimit gjinor në Malësinë e Madhe, një bashki në veri, e cila në zgjedhjet 2015 kishte përqindjen më të ulët të grave votuese mendon se gratë e asaj zone nuk angazhohen në politikë, për shkak se janë familjare dhe i kushtojnë vëmendje shumë të madhe familjes.

Problematika lokale pranohet edhe nga një deputet i PD sipas të cilit, “veçanërisht zonat malore si në veri

si në jug, vijnë nga shoqëri akoma më të mbyllura ku roli i mashkullit është përcaktues dhe ka situata ku kandidatet femra vërtetë mund të jenë shumë të mira, por ka vështirësi reale në vendosjen e tyre sepse ka një preferencë gjinore në pjesën e votimit që në fund të ditës t’i nuk e kontrollon dot. Pra, kur një grua hyn në garë me një burrë në një zone rurale, burri është i avantazhuar sepse trupa votuese janë burra”⁴⁴. Një deputete e PS thotë “kur kam biseduar me shumë burra kryesisht në zona të thella i nxis të anëtarësojnë më shumë gra në parti më thonë “nuk ka gra këtu”⁴⁵.

Megjithatë, ekzistojnë modele të thyerjes së mitit gjinor si në periferi me traditë konservatore si Dibra apo Mirdita⁴⁶, si dhe në qytete të mëdha si Shkodra, Korça apo Berati. Teza e diferencës së Tiranës me zonat periferike lidhet me kufizimet e promovimit të kandidimit gjinor dhe promovimit të grave, me problemet social-ekonomike, me traditën konservatore, si dhe me vetë interesin e partive për maksimalizim të votave. Në zgjedhjet e fundit në Dibër (2016) nuk pati gra e vajza në komisionet e qendrave të votimit⁴⁷, pjesëmarrja e grave dhe vajzave në komisione sidomos në zonat e periferisë, tradicionalisht vijon të jetë minimale.

42 Mesila Doda, Kryetare e Aleancës së Grave ë Sekretare e Përgjithshme, PDIU

43 Luan Rama, Nëkryetar, Lëvizja Socialiste për Integrim

44 Enno Bozgo, Sekretar organizativ, Partia Demokratike

45 Olta Xhaçka, Kryetare e Forumit të Grave, Partia Socialiste

46 Aranita Brahaj, AIS, OJF, deklaram në fokus grup

47 Englantina Aliaj, Barazi në Vendimarrje, OJF, deklaram në fokus grup

8.13. ALEANCA E GRAVE DEPUTETE, NJË RISI NË POLITIKË

Të intervistuarit u pyetën mbi vlerësimet e tyre ndaj nismës së krijimit të Aleancës së Grave Deputete, aktivitetit të Aleancës dhe pritshmërive prej saj. Të gjithë, direkt ose indirekt, ishin të mendimit se krijimi i Aleancës së Grave Deputete përbën risi në organizimin e grave në parlament, pavarësisht dallimeve politike. Projekti fillestar bazohej në një përfaqësim të balancuar, bashkëdrejtim nga opozita e mazhoranca. Në praktikë, problemet u shfaqën kur dy drejtueset e Aleancës ndryshuan kah politik dhe vetë struktura e nisur minimizoi aktivitetin në funksion të qëllimeve të saj promovuese.

Vokshi (PD) mendon gjithsesi se “Aleanca e Grave deputete, mund të them pa frikë, është një ndër gjërat më të mira të këtij parlamenti”⁴⁸ pasi “për herë të parë uli në një tavolinë të gjitha gratë e të gjitha partive politike, të cilat luftonin e lobonin së bashku për sa i takon çështjeve që kishin të bënin me gra, me fëmijë, me dhunën, me fuqizimin ekonomik të grave”.

Zonja Hafizi (Libra), shprehet se, Aleanca “ka vlejtur në momentin fillestar dhe në dy vitet e para kemi pasur një komunikim të mirë me gratë e krahut tjetër”. Më pas edhe ajo mendon se rrjedha e Aleancës mori drejtim tjetër dhe tani mbetet vetëm formale. Shumë më entuziaste shfaqet kryetarja e Aleancës, deputetja Doda (PDIU), sipas të cilës⁴⁹, “Aleanca ka funksionuar në mënyrë të jashtëzakonshme dhe ka pasur iniciativa

ligjore shumë të mira”. Ajo mendon se duke qenë njerëz politikë është normale të kenë divergjenca dhe përballje edhe me njëra tjetrën, por ende beson se ky eksperiment do të jetë funksional, pasi “gratë në ndryshim nga burrat gjejnë rrugë bashkëpunimi dhe kur ka mes tyre gjëra të pakuptimta apo probleme në çështje të caktuara”.

8.14. PROBLEMATIKA E PËRFAQËSIMIT TË GRAVE NË PARTITË POLITIKE

Lidhur me promovimin e grave brenda partive politike, mekanizmat kryesorë janë organizatat e grave dhe strategjitë elektorale. Në kuadër të afrimit të më shumë grave në partitë politike, PS e PD kanë aplikuar praktikën e “hapjes së dyerve”⁵⁰, të mos ketë parakushte për anëtarësimin e grave në parti, kufizimin e burokracisë, promovimin e grave me kontribute publike, civile e akademike, etj. Edhe LSI, PDIU dhe parti të tjera më të vogla kanë të njëjtin trend hapjeje sidomos në nivelet e para të përfaqësimit (listat e kandidatëve në zgjedhjet parlamentare e lokale).

Mbi bazën e praktikës së hapjes (nevojës që partitë të tërheqin figura të reja për imazh elektorale) dhe nevojës së partive për cilësi përfaqësimi, u afruan dhe nisën karrierë edhe disa prej grave politikane, pjesëmarrëse në debatet në fokus grupe. Ato konfirmuan se nuk kanë pasur më parë karrierë politike dhe ndaj iu bashkuan praktikës së “rekrutimit” nga lart, si një mekanizëm normal dhe shans në

48 Albana VOKSHI – kryetare e Lidhjes Demokratike të Gruas (LDG) në Partinë Demokratike

49 Mesila Doda, Kryetare e Aleancës së Grave e Sekretare e Përgjithshme, PDIU

50 Meri Pone, këshilltare, PD, deklarim në fokus grup

Barazia gjinore në udhëheqjen politike është thelbësore për arsye që shkojnë përtej përmirësimit të mundësive dhe kushteve për gratë. Barazia gjinore në politikë është e domosdoshme, sepse shoqëritë, të cilat nuk fuqizojnë gjysmën e qytetarëve të tyre të luajnë një rol në vendimmarrjen politike, janë shoqëri qartësisht jo gjithëpërfshirëse dhe që rrezikojnë të lënë në harresë shumë qytetarë. Për të arritur vizionin tonë për një botë të drejtë dhe gjithëpërfshirëse, për të arritur Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm deri në vitin 2030, ne nuk mund të marrim hap tjetër më të rëndësishëm sesa të zgjerojmë me shpejtësi rolin e grave në jetën politike.

BRIAN J. WILLIAMS, KOORDINATOR REZIDENT I OKB & DREJTUES I PNUD NË SHQIPËRI

kushtet e sistemit tonë partiak dhe zgjedhor, si dhe e sugjeruan aplikimin e tij edhe në të ardhmen në partitë politike.

Në tërësi nuk ka rregulla të shkruara, gjithçka është subjektive nga partia, janë në funksion të qëllimit që ka një parti politike që synon të fitojë zgjedhjet⁵¹, gjë që kërkon, - kandidatë të shkolluar, të kenë influence publike ose në komunitet, të kenë tipare pozitive familjare.

Zyrtarisht konfirmohet mbështetja e madhe e partive për organizatat e tyre të grave, por në praktikë rezultati shpesh është tjetër. Për shembull, prurja në politikë në kuadër të kuotave gjinore të disa emrave të rinj, kryesisht gra me karrierë jo partiake dhe jo politike, por aktiviste në shoqërinë civile apo në profesione të ndryshme, është shoqëruar me kritika nga forumet partiake të grave⁵². Strukturat e vjetra dhe arkaike janë pengesë për hapjen dhe përfaqësimin gjinor. Zyrtarët tradicionalë kalcifikohen në struktura dhe nuk lëvizin deri sa dalin në pension⁵³.

Koncepti i “nënës mbretëreshë”, sipas të cilit figurat drejtuese të grave në politikë bëhen pengesë për prurjet e reja të grave e vajzave, u konfirmua nga shumica e ekspertëve të fokus grupeve. Argumentet e tyre lidheshin me ruajtjen e influencës, ndjenjës së inferioritetit, natyrës së frustruar, etj. Perceptimi është se burrat janë më të zotë të krijojnë aleanca dhe të mbështesin njeri-tjetrin sesa gratë. Solidariteti midis

51 Anna Xheka, pedagoge, deklaram në fokus grup

52 Mirela Alqimadriti, OJF, deklaram në fokus grup

53 Klodeta Dibra, këshilltare, PS, deklaram në fokus grup

tyre është më i madh⁵⁴. Problemi kryesor nuk është pengesa, por mungesa e motivimit dhe e hapjes.

Prurjet e jashtme nga njëra anë injoruan sistemin e karrierës brenda partive, nga ana tjetër rritën cilësinë e përfaqësimit dhe peshën e grave në vendimmarrje. Midis ekspertëve të thirrur në fokus grupe kishte qëndrim të balancuar midis atyre që mbështesin prurjet e reja dhe atyre që janë kundër prurjeve nga jashtë sistemit të meritës dhe konkurrimit partiak. Gjithashtu i njëjti raport u shfaq edhe në ndikimin në parti të prurjeve të reja, nëse kjo krijon pakënaqësi e grindje të brendshme ose nëse kjo krijon konkurrencë më të madhe brenda vetë grave dhe forumeve partiake.

8.15. BUXHETIMI GJINOR NË ZGJEDHJE DHE NË PARTI POLITIKE

Një nga mangësitë në forcimin e strukturës përfaqësuese të grave në partitë politike është çështja e financimit dhe burimeve njerëzore të angazhuara. Në PD pranohet se forumi i grave nuk ka financim nga partia⁵⁵. Si forum partiak ata nuk mund të aplikojnë për fonde për aktivitete në burimet e financimit të shoqërisë civile dhe një sërë donatorësh ndërkombëtarë. Në PS është e njëjtë situatë, megjithëse zyrtarisht organizata e grave mund të krijojë fond financiar më vehte, nëse siguron fonde të tilla të ligjshme. Edhe në LSI situata është e njëjtë. Në partitë e tjera politike parlamentare ose

54 Erjona Rusi, gazetare, deklaram në fokus grup

55 Meri Pone, këshilltare, PD, deklaram në fokus grup

konkurrense në zgjedhjet parlamentare 2017, për shkak të fiktivitetit në strukturat përfaqësuese të grave e vajzave, dobësive financiare dhe pamundësisë organizative, koncepti i buxhetimit gjinor është ende i huaj.

Buxhetimi gjinor elektoral në dy nivele, në zgjedhjet brenda partisë dhe më pas në zgjedhjet e përgjithshme lokale e parlamentare, do të mund të krijonte automoni më të madhe të organizatave të grave brenda partive dhe do të mund të ndikonte në rritjen e interesit dhe të cilësisë së përfaqësimit. Nga debati në fokus grupe dhe intervistat u mbështet teza e nevojës për buxhetim elektoral gjinor për dy aspekte: në nevojën e ndarjes së buxhetit partiak në varësi nga numri i kandidatëve, si dhe nevojën e caktimit të prioritetëve duke i kaluar buxhet vetëm kandidatëve me potencial real për të fituar në zgjedhje. Argumenti i dytë vlerëson se nëse një grua është renditur në një pozicion jo të rëndësishëm, nuk gjykohet e arsyeshme t'i jepen fonde⁵⁶. Vetë forumet e grave dhe partitë politike nuk kanë praktika të buxhetimit gjinor dhe as nisma konkrete në këtë drejtim. Disa institucione politike e kanë mbështetur tezën: për shembull, bashkia Tiranë dhe ndonjë bashki tjetër përbëjnë raste pozitiv të buxhetimit gjinor dedikuar aktiviteteve dhe trajnimeve të grave këshilltare⁵⁷, praktikë, e cila ende nuk është zbatuar në Kuvend apo në grupet parlamentare.

8.16. TRAJNIMI I GRAVE KANDIDATE

56 Ada Hyso, eksperte, OJF, deklaram në fokus grup

57 Klodeta Dibra, këshilltare, PS, deklaram në fokus grup

Lidhur me programet e trajnimit për gratë në politikë, secila nga partitë e konfirmon ekzistencën e programeve të tilla, por secila konfirmon se prurjet e reja elektorale nuk janë pjesë e këtyre trajtimeve përpara zgjedhjes në poste drejtuese. Ato hyjnë në procese trajnimi pas zgjedhjes në post, një proces i kundërt me praktikat normale të trajnimit, konkurrencës dhe zgjedhjes.

Ekspertët e shoqërisë civile të ftuar në fokus grupe theksojnë se gratë, duke qenë grupe të marginalizuara, kanë nevojë shumë më tepër sesa burrat për trajnime politike dhe elektorale, dhe se zgjidhja më e mirë do të ishte programimi vjetor i aktiviteteve të trajnimit brenda partisë, për gratë dhe rininë. Pjesa e hartimit të politikave dhe programeve zgjedhore është e rëndësishme për një parti politike që këto politika mos vazhdojnë vetëm para zgjedhjeve në një program elektoral dhe të mos ndiqen me pas, të humbasin. Fokusi duhet të jete në vazhdueshmëri⁵⁸. Partitë politike kujtohen të shkojnë në terren apo të kenë këto konsultime para zgjedhjeve. Nuk ka një mbështetje të vazhdueshme për këto programe.

8.17. ROLI I MEDIAS NË IMAZHIN DHE PROMOVIMIN GJINOR

Një çështje me rëndësi në debatin e përfaqësimit gjinor në partitë politike është edhe roli i medias dhe raportet e saj me konceptet gjinore të përfaqësimit. Në tërësi ka një vlerësim kritik për mënyrën sesi media i trajton gratë politikane dhe debatin e përfaqësimit gjinor.

58 Gasper Gjeluçi, NDI, deklaram në fokus grup

Pjesëmarrësit në fokus grupe konstatuan se gratë politike nuk janë sa duhet të pranishme në debate të rëndësishme politike televizive. Ato sollën raste dhe të dhëna të shumta sesi gratë ftohen kryesisht në tema soft dhe se media ka krijuar stereotip negativ për gratë e suksesshme dhe është sipërfaqësore në raportimet ndaj grave politike. Sipas tyre, ka paragjykime dhe stereotipa sipas të cilave gratë nuk duhet të debatojnë, duhet të jenë të frenuara në debate televizive, femrat kanë vetëvlerësim më rigoroz ndaj vetes sesa meshkujt, ambienti dominues politik është maskilist, media përdor kryesisht gjuhë seksiste, etj. Sipas vetë ekspertëve të medias dhe të OJF-ve gratë atakohen në media më shumë se burrat për jetën personale, ashpërsia e debatit politik frenon gratë të angazhohen dhe se ligjërimi i ashpër politik i liderëve politikë është përgjegjës, gjuha e medias është një refleksion i gjuhës së përditshme dhe mentalitetit e kulturës.

Të dhënat e dala nga debatet në fokus grupe dhe në intervista theksojnë disa zhvillime pozitive, si p.sh, presionin e vetë grave për tu prezantuar në media për atë që ato përfaqësojnë, si eksperte politike ose të fushave specifike, pra me CV e plotë profesionale, si dhe nga nevoja e prezantimit sa më të balancuar përpara publikut mik. Në fokus grupe dhe intervista, por edhe sic doli nga anketimi i zhvilluar ditën e zgjedhjeve, rezultoi se një numër grash politike tashmë kanë krijuar profil të lartë publik, sidomos gratë që drejtojnë në parlament (komisione ose grupe parlamentare), janë ministre në kabinetin ekzekutiv ose që drejtojnë në bashki dhe në institucione të rëndësishme publike. Modele të tilla pozitive, u vlerësua, se duhen promovuar më tej nga media dhe vetë organizatat e grave brenda partive politike apo shoqëria civile e angazhuar në çështjet gjinore.

Gratë duhet të jenë në politikë sepse përfaqësojnë gjysmën e popullsisë dhe sepse vendet publike duhet të merren në bazë të meritës dhe jo të gjinisë. Ndërkohë, unë nuk besoj se kjo automatikisht do të thotë se një numër më i madh i grave në politikë do ta bënin politikën më pak konfliktuale, pasi kjo do të supozonte që gratë sillen në një mënyrë të caktuar në bazë të stereotipeve gjinore.

JOHAN NDISI, AMBASADOR I SUEDISË NË SHQIPËRI

9. GJETJET KRYESORE NGA PYETËSORËT E ZHVILLUAR

Gjatë muajit mars 2017 stafi i ISP zhvilloi një pyetësor mbi çështje specifike të përfaqësimit të grave dhe vajzave në partitë politike, në fushatën elektorale dhe në poste të rëndësishme drejtuese në parti dhe në

sistemin qeverisës. Pjesëmarrës në pyetësor ishin 130 persona, 65 nga secila gjini. Pyetësori përfshiu persona që jetojnë në Tiranë (50%) dhe në bashki të tjera (50%), nga të cilët 60% ishin anëtar partie ose

Tabela 21. Të dhënat mbi pyetësorin e zhvilluar 2017.

Gjinia	Numri	Grupimi	Ne %
Meshkuj	65	OJF	28,4%
Femra	65	Media	19,8%
		Universite	16,4%
		Zyrtare	7,6%
Banimi	Numri	Tjeter	28%
Tiranë	65		
Rrethe	65	Mosha	Ne %
		18-25 vjeç	21%
		26-35	59%
Parti/Pa angazhim	Numri	36-45	30%
Anëtar në parti	78	46-55	11%
Pa angazhim partiak	52	Mbi 55	8%
		Pa përgjigje	3%


kishin qenë të tillë, dhe 40% nuk kishin eksperiencë direkte politike. Pyetësi përfshiu 28% pjesëmarrës nga shoqëria civile, 19% nga media, 16% nga stafet akademike universitare, 7% nga zyrtarë në partitë politike, si dhe pjesa tjetër nga qytetarë të zakonshëm, të përzgjedhur në mënyrë rastësore.

Qëllimi i pyetësit ishte të ballafaqonim gjetjet e studimit, të intervistave dhe të fokus grupeve me të dhëna që mund të vijnë nga pjesë të tjera të shoqërisë, pa një zë direkt në përfaqësimin dhe drejtimin politik.

9.1. ZGJIDHJA E PËRFAQËSIMIT GJINOR? SHUMICA MBËSHTET KUOTAT ME LIGJ

Personat e përfshirë në pyetësor u pyetën se cila nga format e cituara në tabelë është më efektive për kalimin nga kuotat e detyrueshme të kandidimit për në zgjedhjet parlamentare në kuota të detyrueshme zgjedhjeje. Rreth gjysma e të pyeturve e gjejnë zgjidhjen tek nenet detyruese në Kodin Zgjedhor.

Grupi i dytë më i madh është ai që mbron idenë se



qëllimi mund të arrihet edhe përmes lobimit tek partitë politike (20%), vetëm 12% mendojnë se kuotat duhet të përcaktohen në ligjin mbi partitë politike, dhe 9% mendojnë se zgjidhja mund të vijë nga rregullat e shkruara në statutet e partive politike.


Së fundi, besimi tek vullneti personal i kryetarëve të partive për të aplikuar kuota zgjedhore bashkë me kuotat e kandidimit në zgjedhje, është minimal, vetëm 6%.

Këto përfundime mund të nxjerrin në pah mosbesimin e qytetarëve të pyetur te vullneti politik i liderëve politikë apo te dokumentet e brendshme rregullatore

brenda partive, si dhe besimi i tyre se vetëm detyrimi ligjor mund ti detyrojë partitë të sigurojnë aplikimin e kuotave gjinore zgjedhore edhe në rastin e parlamentit, ashtu siç u veprua në zgjedhjet lokale me këshilltarët bashkiakë.

9.2. MEDIA, ROL THELBËSOR NË PROMOVIMIN E GRAVE NË POLITIKË

Në pyetjen se cila është forma më e mirë për rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë midis katër





ISP
INSTITUTI I STUDIMEVE
POLITIKE

www.isp.com

www.m...
www...

GONE
CRAZY


alternativave të ofruara, “promovimi përmes medias” merr përqindjen më të lartë të mbështetjes, 56%, ndjekur nga rritja e kuotave ligjore të kandidimit për gratë në parti dhe në zgjedhje. Duke bashkuar dy kategoritë, “dakord” dhe “plotësisht dakord” rezultoi se medias i besohet deri në 84% si faktor kryesor. Rreth 69% mbështetën idenë e buxhetimit të veçantë të grave në partitë politike dhe në fushatën elektorale, rreth 70% idenë e përcaktimit me detyrim ligjor.

Në përgjigjet e dhëna bie në sy edhe fakti se rreth 50% e të pyeturve janë kundër opsionit “nuk duhet zbatuar masa që favorizojnë gratë” në përfaqësimin e tyre në politikë. Kjo tregon një ndërgjegjësim të lartë

të grupeve shoqërore të përfaqësuara në pyetësor, për nevojën e mbështetjes së grave në përpjekje për rritjen e përfaqësimit të tyre në parti politike dhe jetën politik në vend.

9.3. ROLI I ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE

Të pyetur mbi rolin që mund të luajnë kategori të caktuara në promovimin më të mirë të grave dhe vajzave në politikë (media u la jashtë opsioneve të zgjedhjes) rezultoi se rreth gjysma e të pyeturve



Në Shqipëri, kam takuar shume gra të përfshira në politika qendrore dhe lokale që kanë arritur aty nëpërmjet një rruge të gjatë. Do të doja që ai numër të rritej. Ka shumë prej tyre në politikë, media, biznes, dhe akademi. Shembujt pozitivë të femrave të suksesshme patjetër duhet të promovohen.

DEWI VAN DE WEERD, AMBASADORE E HOLANDËS NË SHQIPËRI

i njohin rol specifik organizatave kombëtare e ndërkombëtare. Me organizata kombëtare nënkuptohet shoqëria civile, me ndërkombëtare organizatat prezent në Shqipëri.


Kategoria e dytë, e cila rezultoi në përgjigjet e dhëna se mund të ketë rol specifik pozitiv janë vetë gratë politike përmes modelit që ato krijojnë në karrierë e publik, por edhe përmes lobimit të tyre brenda partive politike dhe institucioneve vendimmarrëse.

Nga përgjigjet del qartë se ka mosbesim në angazhimin e politikanëve meshkuj për promovimin

e përfaqësimit të grave në politikë, rreth pesë herë më pak sesa tek besimi ndaj shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare.

9.4. VLERËSIMI PËR KONTRIBUTIN E GRAVE NË POLITIKË

Shqipëria gjatë tetë legjislativave parlamentare ka pasur dhe ka një numër grash në nivele drejtuese partiake dhe politike. Bilanci i punës dhe ndikimit të tyre ka interes për të kuptuar ekzistencën e



modeleve referuese dhe rolit që mund të kenë ato në përmirësimin e raporteve të përfaqësimit.


ISP adresoi pyetjen për të vlerësuar sa grave politikane kanë kontribuar në politikën shqiptare. Numri i atyre që i njohin kontribut maksimal grave në politikë është rreth tre herë më i lartë sesa numri i atyre që nuk u njohin grave politikane kontribute pozitive. Vlerësimi për shumë kontribut është gjithashtu dy herë më i lartë sesa vlerësimi me kontribut minimal.

Pjesa më e madhe, rreth 45% mendojnë se kontributi

i grave në politikën shqiptare ka qenë mesatarisht pozitiv, por në tërësi kategoritë vlerësuese pozitive kanë kuota mbështetëse 2.8 herë më të larta sesa vlerësimet kritike.

Në pyetjen nëse gratë e angazhuara në politikë kanë kontribut pozitiv në politikë-bërje vetëm 14% japin vlerësim shumë pozitiv, 23% njohin kontribute pozitive, dhe kategoria e luhatur midis vlerësimit pozitiv e negativ është kategoria dominuese me mbi 45% e të pyeturve. Kategoritë e atyre që mendojnë se gratë politikane dukshëm nuk kanë kontribute pozitive është i vogël, rreth 15%. Në tërësi, i njëjti qëndrim vlen

Kur do të aplikohet kuota 50% në zgjedhjet parlamentare?



si për përgjigjet e ardhura nga gratë ashtu edhe nga meshkujt e intervistuar.

9.5. KUOTAT 50%? NË ZGJEDHJET 2017 APO 2021?

Personat e përfshirë në pyetësor u pyetën nëse vendosja e kuotës gjinore 50% duhet aplikuar menjëherë apo në një fazë tjetër kohore, përgjigjet anonin dukshëm nga varianti i parë. Përfundimi ka rëndësi për të krijuar një axhendë lobuese për reformën zgjedhore për zgjedhjet parlamentare 2017, zgjedhjet pasuese apo parimisht, për vetë nismën e aplikimit të kuotave të zgjedhjeve vendore edhe në zgjedhjet parlamentare.

Sipas të dhënave të pyetësorëve rreth 42% mbështesin idenë e aplikimit të sistemit të kuotave 50% në zgjedhjet parlamentare 2017. Kjo shifër është relativisht më e lartë sesa opinionet e marra përmes intervistave apo nga fokus grupet.

Ata që mendojnë se kuota 50% mund të zbatohet në zgjedhjet 2021 janë rreth 24%, ose rreth 5% më shumë sesa ata që mendojnë se kjo mund të arrihet pas vitit 2021. Në tërësi, numri i atyre që e shohin aplikimin e kuotës pas 2021 është më e lartë sesa ata që mbështesin aplikimin në zgjedhjet parlamentare 2017. Kategoria e atyre që mendojnë se kuota 50% nuk do të aplikohet asnjëherë është 7.6%, po aq sa e vlerësojnë sistemin e kuotës të panevojshëm në kushtet e një sistemi merite konkurrimi brenda partive dhe më pas në zgjedhjet parlamentare.

9.6. IMPAKTI MBI RITJEN E NUMRIT TË GRAVE NË POLITIKË

Në pyetësor u prezantuan disa alternativa të mundshme për aspektet pozitive që mund të sjellë rritja e numrit të grave në politikë. Referuar përgjigjeve të dhëna, rezulton se alternativa “zvogëlon mentalitetin e ndarjes së roleve gjinore” merr rreth 55% të mbështetjes pozitive nga ata që përgjigjen, alternativa “minimizon seksizmin në politikë” merr mbështetje të balancuar midis opsioneve “pjesërisht” dhe “plotësisht” dakord.

Alternativa “minimizon retorikën e ashpër politike” merr mbështetje në dy të tretat e atyre që iu përgjigjen pyetjes. Alternativa “i bën partitë më demokratike dhe më përfaqësuese” ka raport 40 me 1 ndaj atyre me mbështetje maksimale dhe atyre me mbështetje minimale. Alternativa “minimizon korrupsionin në politikë” i jep mbështetjen më të lartë përgjigjes “dakord”, më shumë se dyfishi i atyre që mendojnë të kundërtën. Vlen të theksohet se kjo alternativë ka përqindjen më të lartë të atyre që shprehen jo dakord. Alternativa se sistemi politik bëhet më legjitim e përfaqësues ka diferencë të vogël midis përgjigjes “pjesërisht” dhe “plotësisht” dakord. Alternativa se rritet pjesëmarrja në votime ka kuotat më të ulëta të përgjigjes “plotësisht dakord”. Në tërësi, përgjigjet maksimale “plotësisht dakord” janë më të mëdha në zvogëlimin e mentalitetit të ndarjes së roleve gjinore dhe në treguesin se partitë bëhen më demokratike e përfaqësuese.

Tabela 21. Numri i grave në politikë.

RRITJA E NUMRIT TË GRAVE NË POLITIKË DO TË PËRMIRËSOJË ASPEKTE TË NDRYSHME	"Jo dakord"	"Pjesërisht dakord"	Dakord	"Plotësisht dakord"	Nuk e di
Zvogëlon mentalitetin e ndarjes së roleve gjinore	11.40	35.60	9.10	40.20	3.80
Minimizon seksizmin në politikë	8.30	34.10	16.70	34.10	6.80
Minimizon retorikën e ashpër politike	3.80	28.80	27.30	35.60	4.50
Minimizon korrupsionin në politikë	13.60	19.70	34.10	20.50	12.10
I bën partitë më përfaqësuesel	1.50	31.10	18.90	40.20	8.30
E bën më legjitim sistemin politik	4.50	32.60	17.40	38.60	6.80
Rrit pjesëmarrjen në votime	6.80	32.60	26.50	24.20	9.80

9.7. PREFERENCAT NË KANDIDIMIN E GRAVE DEPUTETE

Një pyetje specifike adresuam në lidhje me një problematikë të kandidatëve të vërejtura gjatë zgjedhjeve të fundit parlamentare 2013, kandidatimin në zona të periferisë së kandidatëve nga Tirana dhe përfshirjes në lista të figurave jo politike. Të pyetur nëse gratë kandidatë do të duhet të zgjidhen ë caktohen, p.sh, politikane nga Tirana që dërgohen në zona, dukshëm dominon përgjigja refuzuese. Rreth 41% janë kundër dhe vetëm 8% plotësisht pro. Në alternativën e zgjedhjes së politikaneve nga vetë zona lokale grafiku përmbysset, 38% janë plotësisht dakord dhe vetëm 5.3% kundër.

Në alternativën e një forme mikse zgjedhjeje numri i atyre që e mbështet plotësisht është vetëm dy

herë më i lartë sesa refuzuesit e saj. Në alternativën se duhen përzgjedhur gra me karrierë politike ka përgjigje thujtë të njëjta midis tri kategorive, pjesërisht dakord, dakord dhe plotësisht dakord. Në alternativën se duhen përzgjedhur gra të suksesshme nga fushat shoqërore jo politike, raportet përmbysen me mbështetje maksimale mbështetëse. Vetëm 3% janë kundër dhe mbi 15 herë më shumë janë plotësisht dakord.

Në alternativën e një përzgjedhje miks, me gra politikane dhe jo politikane, interesant është fakti se asnjë i pyetur nuk është kundër, ndërkohë që rreth gjysma e të pyeturve janë dukshëm pro këtij opsioni.

9.7. PREFERENCAT NË KANDIDIMIN E GRAVE DEPUTETE

Një çështje e adresuar në pyetësor lidhej me kapacitetet drejtuese të grave aktuale në politikë. Pyetjet ishin nëse midis grave aktuale në politikë gjendet të paktën një emër, i cili mund ta kryejë më mirë funksionin drejtues të Presidentit, kryeministrit, kryetarit të Kuvendit, kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe kryetarit të PS dhe të PD. Duhet theksuar fakti se këto funksione aktualisht kryhen nga meshkuj Supozohet se përgjigjet kanë marrë në konsideratë emrat aktual drejtues në këto institucione.

Te anketuarit i shohin gratë të afta të kryejnë me mire se personat aktuale rolin e Kryetari të Kuvendit (72%), Presidentit, Kryetarit të PD dhe të Bashkisë

Tiranë (51-53%). Për postin e kryetarit të PS vetëm 44% mendojnë se ka politikane më të aftë për ta kryer, kurse për postin e kryeministrit vetëm një në tri përgjigje mbështet alternativën se midis grave politikane më kapacitete më të afta sesa kryeministri aktual për ta përmbushur këtë funksion.

Përpara faktit se asnjë nga gjashtë funksionet nuk mbulohet aktualisht nga gratë politikane, kjo përgjigje shpreh dukshëm një kontrast midis asaj që të pyeturit theksojnë dhe asaj që politika ka ofruar.

Tabela 21. Gratë kandidate në lista.

GRATE KANDIDATE NE LISTAT SHUMEEMERORE TE PARTIVE TË ZGJIDHEN	"Jo dakord"	"Pjesërisht dakord"	Dakord	"Plotësisht dakord"	Nuk e di
Politikane nga Tirana që dërgohen në zona	40.90	28.80	9.10	8.30	12.90
Politikane nga vetë zona lokale	5.30	25.80	22.00	37.90	9.10
Formë miks nga Tirana dhe nga zona lokale	11.40	31.80	18.20	23.50	15.20
Gra me karrierë të njohur politike	7.60	28.20	26.70	25.20	12.20
Gra të suksesshme në fushat shoqërore	3.00	25.00	15.90	47.00	9.10
Formë zniks,, gra politikane dhe gra të suksesshme	0.00	26.50	21.20	45.50	6.80

Investime më të mëdha në barazinë gjinore në të gjitha nivelet e jetës publike dhe politike do të sjellin ndryshime dhe do të krijojnë hapësirë të barabartë për qytetarët e saj pa marrë parasysh gjininë e tyre.

BERND BORCHARDT, KRYETARI I PREZENCËS SË OSBE NË SHQIPËRI


9.8. GRATË ME POTENCIAL PËR POSTET E LARTA DREJTUESE

Në pyetësor është dhënë opsioni nëse të pyeturit janë në gjendje të ofrojnë emra konkrete nga gratë politike aktuale, për postet e mësipërme politike dhe kushtetuese. Nga të pyeturat 43% kanë refuzuar të japin emra konkretë për të gjitha kategoritë në pyetje. Pjesa tjetër ka cituar emra konkretë. Bazuar në të dhënat e këtyre të fundit, gratë më potencialin më të madh për qenë Presidente e Republikës kuotohen Jozefina Topalli (nga e djathta) dhe Arta Dade (nga e

majta), për kryeministre kuotohen Mimi Kodheli (nga e majta) dhe Majlinda Bregu (nga e djathta).

Më të kuotuarat për postin e kryetares së Partisë Socialiste janë Arta Dade dhe Mimi Kodheli, kurse më të kuotuarit për kryetare të Partisë Demokratike janë Majlinda Bregu dhe Albana Vokshi. Lidhur me postin e kryetarit të bashkisë Tiranë emrat më të kuotuarat janë Majlinda Bregu dhe Jorida Tabaku nga PD dhe Mirela Kumbaro nga PS.

Së fundi, të pyetur nëse ekzistojnë shembuj suksesi dhe frymëzuese të grave politike në qytetin apo



në zonën ku janë kryer anketimet, pothuajse 90% e përgjigjeve janë konfirmuese. Të pyetura për emra konkretë, kuotat më të larta pozitive u shkojnë politikaneve M.Bregu (PD), A.Dade (PS), G.Duma (PD), M.Kodheli dhe E.Gjermani (PS), J.Topalli (PD), L.Nikolla e V.Hysi (PS), si dhe M.Doda (PDIU). Midis përgjigjeve dhe emrave ka një lidhje të fortë të orientimit politik, ku personat e intervistuar me prirje të majta mbështesin kryesisht emrat e politikaneve të majta dhe e njëjta edhe për të djathtët. Pjesa e atyre që nuk tregojnë identifikim politik mbështesin kryesisht gra të partive politike që kanë qëndrime publike kritike brenda tyre ose janë përjashtuar nga partia për shkak të kritikave të tyre.

10. REKOMANDIME TË SPECIFIKUARA

ISP ka hartuar edhe raportin mbi përfaqësimin e grave në zgjedhjet lokale 2015 me 33 rekomandime konkrete. Në zgjedhjet e vitit 2017 pati përmirësime në disa rekomandime, por asnjë prej tyre nuk pati përmbushje në nivelin 100%. Ky përfundim tregon se pozita përfaqësuese e grave në partitë politike dhe në jetën politike vijon të ketë të njëjtat tipare dhe pozita që prej 2015, dhe se ndryshimi pozitiv është i ngadalshëm.

Studimi mbi përfaqësimin e grave dhe vajzave në partitë politike dhe institucionet politike e bën të domosdoshme caktimin e disa prioritetëve në listën e rekomandimeve, për të shënuar progres në zgjedhjet e radhës, zgjedhjet lokale 2019 dhe zgjedhjet parlamentare 2021.

ISP ka bindjen se kapacitetet dhe nevojat e shoqërisë shqiptare për nivel më të lartë të përfaqësimit të grave në vendimmarrjen politike janë shumë më të madha sesa niveli aktual i përfaqësimit.

Rritja e nivelit përfaqësues horizontal dhe vertikal, në partitë politike, në institucionet politike dhe në proceset elektorale, duhet të jetë prioritet në arritjen e standardeve më të larta demokratike, si dhe produkt i një sërë masash e faktorësh ndërveprues. Bazuar në këtë synim, ISP sugjeron rekomandimet e mëposhtme:

10.1. LIDHUR ME LIGJIN E PARTIVE POLITIKE DHE LEGJISLACIONIT ZGJEDHOR

- Hartimin fillimisht të një axhende politike me tematikë përfaqësimin gjinor dhe miratimin e një rezolute parlamentare që detyron institucionet për të pasur fokus konkret të punës çështjet që lidhen me këtë problematikë.
- Ligji i partive politike duhet të përmirësohet për të përfshirë nene referuese me fokus përfaqësimin gjinor në strukturat vendimmarrëse të partive, për standarde më të larta të organizimit të brendshëm dhe krijimin e një sistemi meritokracie në promovimin e karrierës. Ligji duhet të detyrojë partitë politike që në të gjitha nivelet të respektojnë kuota të barasvlershme kandidimi por edhe zgjedhjeje, sidomos në postet me rëndësi politike, sic janë parlamenti, kabineti qeveritar dhe qeverisja vendore.
- Kodi Zgjedhor duhet të reflektojë ndryshimin e bërë në zgjedhjet lokale, për kuota gjinore jo vetëm kandidimi, por edhe zgjedhjeje në të gjitha nivelet e përfaqësimit, përfshirë atë parlamentar. Detyrimi i kuotave nuk duhet kufizuar vetëm në tri vendet e para të

listës shumë-emërore por në çdo 3 emra të listës shumë-emërore. Kjo kërkesë kërkon një vullnet politik në vendimmarrje dhe një reformim rrënjësor të vetë organizatave të grave brenda partive politike, për t'iu përgjigjur sfidave të reja me prurje cilësore e konkurruese.

- Kodi Zgjedhor duhet të sanksionojë praktika më të forta penalizuese ndaj partive politike parlamentare, të cilat nuk zbatojnë me korrektesë sistemin e kuotave të kandidimit në zgjedhjet parlamentare dhe lokale. Masa e penalizimit financiar, pavarësisht ecjes drejt rritjes, nuk është zgjidhje e qëndrueshme. Zgjidhje e qëndrueshme është lidhja midis sistemit të kuotave dhe regjistrimit të subjektit politik në zgjedhjet lokale e parlamentare.
- Kodi Zgjedhor duhet të sanksionojë të njëjtin standard për përfaqësim 50% gjinor në të gjithë strukturën e administrimit zgjedhor (KZAZ, KZZ, QV, GN, BMM, etj.) siç përcaktohet detyrimi për KZAZ për vetëm dy partitë kryesore politike. Rritja e numrit të grave e vajzave në nivelet e administrimit zgjedhor, sidomos në nivele të ulta, do të ndikonte edhe në minimizimin e incidenteve dhe kontestimeve zgjedhore.
- Kodi Zgjedhor duhet të përcaktojë nene të qarta penguese për praktikën e gabuara të presionit për dorëheqje të kandidatëve gra në listat shumë-emërore të partive politike. Partitë dhe subjektet që aplikojnë forma të tilla presioni duhen proceduar penalisht nga KQZ.
- Kodi Zgjedhor duhet të parashikojë fonde të veçanta sensibilizuese dhe promovuese për kandidatet gra në zgjedhjet parlamentare dhe lokale. Pa buxhetim gjinor dhe mbështetje reale të organizatave të grave dhe kandidatëve në zgjedhje është e pamundur të flitet për aktivitet autonom, konkurrues dhe cilësor.
- Kodi Zgjedhor duhet të detyrojë bashkitë për respektim të përfaqësimit gjinor përmes kandidimit në kuota për kryetarët ose detyrimin që zv/kryetari në çdo bashki të jetë i gjinisë tjetër. Praktika e kuotave 50% duhet të aplikohet edhe në emërimin e administratorëve të njësive dhe në organet e tjera vendimmarrëse në varësi strukturore nga bashkia.
- Kodi Zgjedhor duhet të parashikojë penalitete në rastet e ligjërit publik denigruës mbi bazën e gjinisë dhe sidomos denigruës ndaj kandidatëve gra e vajza në fushatat elektorale. Kodi e Etikës në parlament dhe në zgjedhje duhet zgjeruar me përfshirjen e Kodeve të Etikës edhe në partitë politike, me mekanizma verifikimi dhe veprimi në rast shkeljeje.
- Kodi Zgjedhor, KQZ dhe strukturat e tjera zgjedhore, duhet të nxisin platforma konkrete penaliteti dhe sensibilizimi në rastet e konstatimit të votimit familjar, votimit në emër të grave e vajzave, deformimit të votimit apo presioneve për votën.
- KQZ duhet të aplikojë studime dhe trajnime speciale lidhur me politikën dhe përfaqësimin gjinor në kandidim, administrim dhe në votime, si dhe të nxisë me mjete moderne

të komunikimit pjesëmarrjen më të lartë të grave dhe të vajzave në zgjedhje. KQZ mund dhe duhet të investojë edhe në studime të thelluara në raporte dhe raste specifike, në mënyrë që të ndikojë tek aktorët politikë dhe publiku për sensibilizim më të madh.

- KQZ duhet të krijojë database të saktë me të dhënat mbi kandidimet e grave dhe vajzave në zgjedhje, rezultatet e tyre në vite dhe me përfaqësimin e votuesve mbi bazë gjinie në të gjitha zonat zgjedhore, si tregues transparence dhe objekt studimi të mëtejshëm.

10.2 LIDHUR ME PARTITË POLITIKE DHE PËRFAQËSIMIN POLITIK

- Problematikat e përfaqësimit gjinor duhet të mos trajtohen në formë fushatash dhe vetë në prag të zgjedhjeve, por si çështje me prioritet e vëmendje të vazhdueshme dhe në secilën nga periudhat ndërmjet dy proceseve zgjedhore. Partitë duhet të publikojnë axhendë vjetore të aktiviteteve që lidhen me progresin drejt standardeve më të larta të organizimit të tyre, të funksionimit dhe sidomos të përfaqësimit demokratik.
- Partitë do të duhet të fokusohet në problematikën konkrete të grave, duke forcuar organizatën e grave dhe duke pasur një program specifik elektoral adresuar çështjeve gjinore. Programi duhet reflektuar me saktësi në programin qeverisës post-zgjedhor për

partinë a koalicionin politik fitues në zgjedhje, si bazë referimi e monitorimi në të ardhmen.

- Partive politike u sugjerohet zhvillimi i rregullt i seancave të posaçme (çdo 6 muaj) të grupeve parlamentare dhe grupit të ministrave dhe bashkive (brenda partive) me forumin e grave dhe fokus, problematikat institucionale dhe çështje të përfaqësimit gjinor
- Partitë politike duhet të përfshijnë në Kodet Etike të tyre, si shkelje flagrante dhe raste penaliteti në karrierë, ato rastet e ligjërimit diskriminues mbi bazë gjinore, në aktivitetin partiak, në fjalime, në aktivitetet elektorale, etj. Strukturat apeluese dhe gjyqësore brenda partive duhet të jenë aktive në rastet e shkeljes së këtyre rregullave.
- Shoqëria civile duhet të mbështetet nga organizatat dhe partnerët ndërkombëtarë që të monitorojë edhe proceset e brendshme partiake, vendimmarrjet e tyre të brendshme, dokumentet e tyre organizative, garën e brendshme dhe të gjithë elementët e tjerë të funksionimit partiak në funksion të rritjes së sasisë dhe cilësisë së përfaqësimit të grave në të gjitha nivelet e partive politike
- Shoqëria civile duhet të mbështetet të monitorojë procesin e (për)zgjedhjes së kandidatëve e deputetëve, sidomos për eliminimin e praktikave negative të zgjedhjeve të kaluara, përfshirë ato të tërheqjes së kandidatëve apo zhvendosjes në listën shumë-emërore më 2013. Shoqëria civile duhet të ketë akses brenda partive politike për standardet e tyre zgjedhore dhe më pas,

të jetë më aktive për një network funksional lotues.

- Forumet e grave dhe partitë politike, do të duhet të bashkëpunojnë nga afër me median për promovim më të madh mediatik të fushatës elektorale të kandidateve gra nga secila parti, si dhe modeleve pozitive të karrierës së grave. Vetë media duhet të punojë për më shumë standarde etike e profesionale në raportim, monitorim dhe pasqyrim të fushatës elektorale dhe të zhvillimeve cilësore apo problematike brenda partive politike.
- Praktikat e deritanishme eksperimentale me Aleancën e Grave deputete dhe Aleancën e Grave Këshilltare duhet nxitur të jenë aktive, të krijojnë një tribunë debati e prezantimi për problematikat gjinore, përfshirë ato të përfaqësimit politik në nivel qendror dhe lokal. Modeli i tyre funksional mund të jetë katalizator për nxitjen e akteve dhe nismave konkrete parlamentare dhe për përfshirjen e çështjeve të përfaqësimit në axhendën prioritare të parlamentit, të qeverisjes vendore dhe të partive politike.
- Forumi i grave dhe gratë kandidatë duhet të mbështeten të kenë fond të veçantë në fushatën elektorale, harmonizuar me premtimin për konceptin e buxhetimit gjinor në parlament dhe në qeverisje. KQZ duhet tu kërkojë partive politike që në raportimin vjetor financiar, të përfshijnë edhe të dhëna specifike mbi buxhetin e organizatës së gruas dhe të rinisë.
- Forumet e grave në partitë politike duhet të ketë transparencë publike (faqe të internetit) të aktivitetit dhe strukturave të tyre, si dhe të mundësojë debate aktive mbi problematika konkrete të pozitës së gruas në shoqëri e politikë. Forumet duhet të reformohen në koncept dhe veprim, për më shumë konkurrencë, prurje cilësore, përfaqësim tematik dhe për të kryer me sa më shumë cilësi funksionin ndërmjetësues midis vendimmarrjes në parti dhe komunitetit të madh të grave dhe vajzave
- Organizatat e grave në partitë politike ose Aleanca për Gratë Deputete duhet të mbështetësin një memorandum etik bashkëpunimi me median shoqëria civile, për promovimin dhe mbështetjen e nevojës për më shumë balancim gjinor në vendimmarrjen politike
- Shoqëria civile, partitë dhe partnerët ndërkombëtarë duhet të ndërmarrin rregullisht programe trajnimi mediatik, legjislativ dhe politik të grave kandidate dhe grave në politikë, për t'i asistuar ato me informacione dhe forma moderne të komunikimit dhe të aktivitetit. Shoqëria civile mund të iniciojë krijimin e një database publike për tematikat e përfaqësimit gjinor dhe të mbajë në informim publikun për çdo ndryshim pozitiv apo negativ që ndodh në partitë politike dhe në përfaqësimin në institucionet politike.

Kuotat gjinore nuk janë formula magjike. Ato janë një instrument që mund të përdoret për krijimin e disa balancave aty ku realiteti nuk është i aftë të sigurojë mundësi të drejta. Unë besoj në ndikimin pozitiv të kuotave, siç besoj shumë se fuqizimi i grave në ekonomi dhe në dimensione sociale është vendimtar në rritjen e rolit të tyre në shoqëri.

DEWI VAN DE WEERD, AMBASADORE E HOLANDËS NË SHQIPËRI





ANEKS A

11 BAZA KUSHTETUESE DHE LIGJORE E PËRFAQËSIMIT GJINOR

Kushtetuta është akti ligjor themeltar, i cili parashikon parimet e organizimit dhe funksionimit shtetëror, harmonizon parimet kryesore me legjisllacionin kombëtar, duke synuar të krijojë një frymë uniformiteti, veçanërisht për çështje parësore si të drejtat e njeriut, duke i përafuar ato me të drejtën ndërkombëtare.

Neni 3 i Kushtetutës së Shqipërisë parashikon se: “Të drejtat dhe liritë e njeriut janë baza e këtij Shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe mbrojë ato”. Parimi i barazisë dhe mos-diskriminimit gjen pasqyrim në Nenin 18, i cili parashikon midis të tjerash se: “të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etniciteti, gjuha, besimet politike fetare apo filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale apo përkatësie prindërore. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe të përmendura në paragrafin e mësipërm në rast se nuk ekzistojnë shkaqe ligjore të arsyeshme dhe objektive”.

Kushtetuta shqiptare parashikon dhe trajton konceptin e barazisë. Vetëm dy nene të kushtetutës e trajtojnë aspektin gjinor në mënyrë të veçantë: Neni 18, i përmendur më sipër, dhe neni 54ë1 në të cilin midis të tjerash thuhet se: “fëmijët, të rinjtë, gratë

shtatzëna, dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti”. Neni 54ë1 shprehet vetëm mbi barazinë sociale dhe diskriminimin pozitiv, por jo mbi të drejtat apo liritë në kontekstin politik, të vendimmarrjes apo përfaqësimit të barabartë. Në formulimet e tjera, gjuha e përdorur në kushtetutë është neutrale, e shprehur më së shumti me përemra asnjans si gjithkush, çdo person etj. E vetmja dispozitë ku përmendet gjinia është

Edhe në ndryshimet kushtetuese që ndodhën në Korrik 2016 me anë të Ligjit 76ë2016, me gjithë amendimin që ju bë disa neneve të Kreut të II të Kushtetutës që trajtonin aspekte të zgjedhjes së deputetëve, në asnjë rast nuk është përmendur barazia gjinore në garimin elektoral apo vendimmarrjen politike, duke lënë një vakum parimor. Gjithsesi referimi në parimin kryesor të barazisë dhe mos-diskriminimit që parashikon neni 18 i Kushtetutës të harmonizuar me mbrojtjen e të drejtat e njeriut dhe respektimin e tyre nga organet shtetërore janë një premisë dhe burim që ligjet të vijojnë konkretizimin dhe zbatimin e këtij parimi në praktikë.

11.1. AKTET NDERKOMBËTARE QË LIDHEN ME PËRFAQËSIMIN GJINOR

Parimet dhe standardet ndërkombëtare mbeten një pjesë e rëndësishme e detyrimeve shtetërore

të Shqipërisë për implementim dhe përafrim, në kuadër të njohjes, pranimit dhe zbatimit të tyre në nivel kombëtar. Ato janë jo vetëm një angazhim i vazhdueshëm për të bërë pjesë në radhën e vendeve që aspirojnë të integrohen në BE, por edhe një detyrim konstant nisur nga obligimet që Shqipëria ka karshi organizatave ndërkombëtare në rang global, kontinental dhe rajonal, në të cilat është anëtare me të drejta të plota.

Në nenin 5 të Kushtetutës së Shqipërisë⁵⁹ parashikohet midis të tjerash se vendi ynë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të, ndërkohë që në nenin 122 të këtij akti thuhet midis të tjerash se marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara kanë epërsi ndaj ligjeve të vendit që nuk pajtohen me të. Po sipas këtij neni, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara përbëjnë pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohen në Fletoren Zyrtare dhe ato janë të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë me përjashtim të rasteve kur këto norma nuk janë të vetë-zbatueshme dhe kur zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji tjetër.

Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim dhe Asociimit me BE-në në Qershor 2006, i cili konsiderohet një veprim konkret që hapi perspektivën e rritjes së shanseve për një anëtarësim të vendit në Bashkimin Evropian. Aktualisht Shqipëria pret hapjen e negociatave për anëtarësim si procedura e radhës për t'u afruar akoma më tepër momentit final të anëtarësimit në BE.

59 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 1998, amenduar me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007, me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008, me ligjin nr.88ë2012, me ligjin nr.137ë2015 dhe me ligjin nr.76ë2016.

Barazia gjinore është një e drejtë themelore dhe një vlerë e përbashkët e vendeve të BE-së. Me qëllimin për një integrim të shpejtë në BE, barazia gjinore është një kusht i rëndësishëm për anëtarësimin e Shqipërisë në këtë bashkësi dhe në këtë kuadër kërkohet plotësimi i objektivave të MSA-së, si dhe i prioriteteve që kanë dalë si rezultat i hartimit dhe publikimit të Raport-Progressive nga Komisioni Evropian. Nga këto raporte lufta kundër diskriminimit gjinor dhe barazisë gjinore në përfaqësim dhe vendimmarrja mbeten ende një sfidë për vendin tonë.

Kriteret e Kopenhagënit⁶⁰ diktojnë të gjitha vendet që aspirojnë anëtarësim në BE që të ndërtojnë dhe konsolidojnë institucione që garantojnë demokracinë, shtetin ligjor, të drejtat e njeriut, respektin dhe mbrojtjen e pakicave etj. Në këtë aspekt Shqipëria ka miratuar një strategji kombëtare për zbatimin e MSA, ka miratuar një sërë ligjesh dhe amendimesh në kuadër të përafrimit me *acquis communautaire* dhe sipas fushave ndjek dhe përafrojnë vendimmarrjet e saj me direktivat dhe rekomandimet e institucioneve të BE-së.

Deklarata Universale OKB e vitit 1948, parashikon parimin e papranueshmërisë së diskriminimit dhe deklamon se të gjithë njerëzit lindin të lirë e të barabartë në dinjitet e në të drejta dhe se secili mund të gëzojë të gjitha të drejtat dhe liritë që përmenden në deklaratë, pa asnjë dallim. Kjo deklaratë ka shprehur parimin e barazisë dhe të mos-diskriminimit në nenin 7 të saj, ku parashikohet se "të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim të mbrohen barabar nga ligji. Të gjithë

60 European Commission. http://www.europa.eu/rapidwpress-release_DOC-93-3_en.htm?locale=en (per tu pare linket)

kanë të drejtën për t'u mbrojtur barabar kundër çdo diskriminimi që cenon këtë Deklaratë, si dhe kundër çdo nxitje për një diskriminim të tillë". Po ashtu, sipas Nenit 21 të kësaj deklarate parashikohet midis të tjerash se cilido ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit duke u përfshirë si në drejtimin e saj të drejtpërdrejtë, ashtu dhe nëpërmjet zgjedhjes indirekte të tyre nëpërmjet votës. Kjo dispozitë hap perspektivën e qartë ndaj shteteve anëtare për të kontribuar edhe në kuadër të barazisë gjinore në të drejtat politike.

Konventave kundër çdo Forme të Diskriminimit ndaj Grave të OKB, CEDAË është dokumenti më i rëndësishëm global, të cilin, Shqipëria e ratifikoi në vitin 1993 me anë të Ligjit Nr 1769 datë 9.11.1993. Kjo konventë detyron Shtetet Palë të luftojnë me masa politike, ligjore dhe shoqërore inferioritetin apo superioritetin e secilës gjini. Ky dokument harmonizon të drejtat politike të grave në kuadrin normativ të mos-diskriminimit dhe të barazisë. Neni 7 i Konventës CEDAË, me titull "Pjesëmarrja e grave në vendimmarrje" përcakton midis të tjerash se partitë politike duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për eliminimin e diskriminimit ndaj grave në jetën politike dhe publike të vendit dhe veçanërisht duhet të sigurojnë se gratë trajtohen në kushte të barabarta me burrat.

Në Protokollin shtesë të Konventës CEDAË, të cilin Shqipëria e ratifikoi me Ligjin nr 9052 datë 17.4.2003 u sanksionua e drejta e raportimit dhe hetimit të rasteve individuale duke i hapur rrugë procedurave të komunikimit individual. Kjo procedurë mund të përdoret vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet e tjera në nivel kombëtar, duke rritur garancitë e zbatimit të parimeve të CEDAË. Nuk kanë qenë të

pakta rastet kur Komiteti i CEDAË ka monitoruar situatën e barazisë gjinore në Shqipëri, në kuadër të përfaqësimit politik në zgjedhje dhe ka dalë me raporte dhe rekomandime, lidhur me përmirësimin e situatës. Një nga kushtet e rekomanduara për ligjet kombëtare të vendit tonë kanë qenë edhe kuotat gjinore, të cilat janë marrë në konsideratë për implementim dhe janë konkretizuar me amendimet përkatëse.

Konventa Evropiane e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut është ratifikuar nga Shqipëria me anë të Ligjit nr. 8137, datë 31.07.1996, "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore". Në nenin 14 të saj parashikohet midis të tjerash se gëzimi i të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Konventë, do të sigurohet pa diskriminim, për çdo lloj arsyeje si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimi politik apo të tjera, origjina kombëtare apo sociale, të shoqëruarit me statusin e pakicës kombëtare, pronës, lindjes, apo ndonjë status tjetër. Kjo dispozitë trajton në mënyrë të tërthortë edhe rastet e përfaqësimit politik dhe angazhimit të barabartë në këtë fushë më aspektin gjinor, ndaj është një dokument që referohet shpesh edhe në kontekstin kombëtar për barazinë.

Zgjerimi i mos-diskriminimit si nocion i parashikuar fillimisht sipas Nenit 14 u plotësua me Nenin 1 të Protokollit 12 të KEDNJ-së në të cilin barazia dhe trajtimi i barabartë u sanksionua e zgjeruar për çdo të drejtë të përcaktuar me ligjet kombëtare, duke nënkuptuar në këtë rast edhe barazinë gjinore. Por KEDNJ është e fokusuar në përmbajtjen e saj më tepër në masat anti-diskriminim sesa në ato të garantimit të barazisë, madje edhe ajo fushë në protokolle të veçanta qaset më tepër me çështje

sociale, duke i kushtuar vëmendje trajtimit dhe garancive të grupeve sociale për një kohezion të plotë dhe gjithanshëm. Pavarësisht kësaj edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në çështjet që ka trajtuar është ndaluar më së shumti në këtë aspak, duke mos pasuruar mjaftueshëm jurisprudencën e saj me vendime lidhur me barazinë në përfaqësimin gjinor politik apo çështje të tjera në këtë fushë.

11.2 LIGJI PËR BARAZINË GJINORE DHE NDIKIMI I TIJ

Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri", trajton çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, të mbrojtjes dhe trajtimit të barabartë të grave e burrave, garanton mundësitë dhe shanset e barabarta për ushtrimin e të drejtave, si dhe për pjesëmarrjen e ndihmesën e tyre në zhvillimin e të gjitha fushave të jetës shoqërore. Ky ligj sanksionon dhe vë në zbatim parimin e barazisë e të mos-diskriminimit, i cili buron nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nga Konventa "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas", si dhe nga të gjitha aktet e tjera ndërkombëtare, të ratifikuara nga vendi ynë.

Për garantimin e barazisë gjinore dhe eliminimin e diskriminimit për shkak të gjinisë, neni 7 i ligjit parashikon një sërë masash të domosdoshme që duhet të ndërmerren nga organet shtetërore, ndërsa për të plotësuar përfaqësimin e barabartë gjinor, neni 8 i tij parashikon disa masa të veçanta të përkohshme, të cilat përfshijnë "kuotat për të arritur përfaqësim të barabartë gjinor, rritjen e pjesëmarrjes së gjinisë më pak të përfaqësuar në vendimmarrje

dhe në jetën publike, fuqizimin ekonomik dhe të pozitës së personave të secilës gjini në fushën e punës, përmirësimin në mënyrë të barabartë të nivelit arsimor, si dhe masa të tjera në çdo fushë, ku personat e njëjës gjini nuk gëzojnë pozitë të barabartë me personat e gjinisë tjetër".

Pika 2 e nenit 8, parashikon se "nuk përbëjnë diskriminim për shkak të gjinisë rastet kur organet shtetërore marrin masa të veçanta të përkohshme, përfshirë edhe dispozita ligjore, që synojnë përshtetimin e vendosjes së barazisë faktike ndërmjet femrave dhe meshkujve. Këto masa duhet të pushojnë së ekzistuari sapo të jenë arritur objektivat e barazisë gjinore, për të cilat janë krijuar".

Në Nenin 15 të ligjit 9970, datë 24.08.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri" ofrohen mundësinë e aplikimit të kuotave gjinore si një masë e përkohshme e implementimit të kuotave gjinore në realitet, duke parashikuar midis të tjerash se: "Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe në institucionet e tjera publike arrihet kur:

- a) sigurohet përfaqësim në masën mbi 30 për qind për secilën gjini, përfshirë edhe në organet e tyre drejtuese;
- b) sigurohet respektimi në mënyrë të njëjtë për secilën gjini i procedurave dhe kriterëve të konkurrimit, gjatë emërimit në këto organe;
- c) sigurohet përfshirja mbi 30 për qind e secilës gjini në listën e kandidatëve për zgjedhjet në organet përfaqësuese vendore;
- ç) sigurohet përfshirja jo më pak se 30 për qind e

secilës gjini në listën e kandidatëve të paraqitur nga partitë politike për sistemin proporcional për zgjedhjet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;

d) sigurohet përfshirja mbi 30 për qind të secilës gjini në organet administruese të procesit të zgjedhjeve qendrore dhe vendore.

2. Partitë politike përcaktojnë mënyrat dhe masat për të përmbushur kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni. 3. Partitë politike paguajnë një gjobë deri në një të dhjetën e fondit shtetëror për financimin e fushatës zgjedhore, nëse shkelin dispozitat e këtij neni, deri në ndreqjen e shkeljes".

Në një analizë të përgjithshme për sa më lart, vihet re se ky ligj ofron një bazë parimore dhe rregullatore mjaft të plotë dhe të detajuar për barazinë gjinore lidhur me garimin politik dhe përfaqësinë në vendimmarrjet publike. Megjithatë mbetet problem pasqyrimi, dhe përditësimi i akteve të tjera ligjore dhe nënligjore nën frymën e këtyre rregullave.

Referuar propozimeve dhe ndryshimeve të fundit në Kodin Zgjedhor që janë përmendur më lart, bie në sy fakti se kuota 30% e pjesëmarrjes së grave në jetën politike tashmë është e tejkaluar dhe po tejkalohet si në zgjedhjet administrative ashtu dhe në ato politike. Ndaj duhet parë që edhe dispozitat ligjore që parashikon ky akt të mos shikohen më nën dritën e normave minimale, por të sanksionohen kuota të reja për të pasur një barazi të plotë gjinore. Vendosija e kuotës 50% për çdo garim apo vendimmarrje të barabartë publike dhe politike midis burrave dhe grave duhet të gjejë vend edhe në ligjin e mësipërm.

11.3 LIGJI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI NË ASPEKTIN GJINOR

Ligji nr. 221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" është një tjetër akt i rëndësishëm i miratuar në vitin 2010 nga Kuvendi i Shqipërisë, i cili zgjeron gamën e të drejtave dhe garancive midis meshkujve dhe femrave, duke futur nocione dhe fusha zbatimi jo vetëm në aspektin politik, por edhe në fusha të tjera, kryesisht të lidhur me ekonominë, çështjet sociale etj.

Neni 1 i këtij ligji parashikon midis të tjerash se ai rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

Në nenin 9 të këtij akti parashikohet krahas të tjerash se ndalohet diskriminimi në ushtrimin e së drejtës për të zgjedhur, për t'u zgjedhur dhe për t'u emëruar në një detyrë publike, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji. Kjo dispozitë është një tjetër pikë e fortë në fushën legale të barazisë ligjore që krijon një infrastrukturë për tu ndjekur nga shumë akte të tjera nënligjore në këtë fushë.

Risi e këtij ligji është krijimi i një institucioni të pavarur siç është Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), i cili ka për detyrë të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje

që nxit diskriminimin, duke përfshirë midis të tjerash afërmendsh edhe çështje të barazisë gjinore dhe mos-diskriminimit në fushën dhe vendimmarrjen politike.

Neni 32 i ligjit të mësipërm parashikon midis të tjerash se KMD ka kompetence të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi, të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji.

Përveç sa më lart, ligji i atribuon KMD të drejtën të vendosë sanksione administrative nëse vëren shkelje diskriminatore të çdo natyre, çka i jep një autoritet të madh këtij organi në zbatimin efektiv të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi. KMD ka të drejtë gjithashtu në bazë të Nenit 32 të monitorojë zbatimin e këtij ligji, t'u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues, të kontribuojë në raportimet dhe sipas rastit të paraqesë raporte para organizmave ndërkombëtarë dhe rajonale, të përfaqësojë ankuesin në organet gjyqësore në çështje civile me miratimin e tij. Ligji parashikon se të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin KMD-në, në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke dhënë informacionin që i nevojitet atij.

Në nenin 33 të ligjit parashikohet midis të tjerash se çdo person fizik që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë nga 10 000 deri në 60 000 lekë dhe personi

juridik nga 60 000 deri në 600 000 lekë. Në këtë rast personi fizik brenda personit juridik, i cili është përgjegjës për shkelje, dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 80 000 lekë, ndërsa personi, i cili ushtron funksion publik dhe është përgjegjës për shkelje në bazë të këtij ligji, dënohet nga 30 000 deri në 80 000 lekë.

Me gjithë atributet që jep ky ligj, në realitet fuqia dhe roli i KMD, mbetet relativisht i dobët dhe deri diku mbivendoset me kompetencat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në lidhje me praktikën e pazbatuar ligjore të barazisë së kuotave përfaqësuese gjatë zgjedhjeve administrative ose politike. Kodi Zgjedhor dhe Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi duhet të gjejnë zgjidhje imediate për të harmonizuar dispozitat e tyre dhe kompetencat e institucioneve që mbikëqyrin barazinë gjinore me qëllim që kjo veprimtari të jetë efektive dhe korrekte për të parandaluar praktika jo ligjore në këtë fushë.

11.4 ANALIZË E KODIT ZGJEDHOR LIDHUR ME ASPEKTIN GJINOR

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë i miratuar me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, dhe ndryshuar me ligjin nr. 74ë2012, datë 19.07.2012 dhe ligjin nr. 31ë2015, datë 02.04.2015 përfshin për herë të parë kuotat gjinore me qëllim rritjen e përfaqësimit të grave në parlament. Në kuadër të zbatimit të barazisë gjinore ky kod shënon një pikë kthese në përpjekjet e Shqipërisë në respektimin e barazisë politike në përfaqësim, megjithëse në realitet ka ende çështje ende të pazgjidhura që kërkojnë amendime.

Në nenin 67 pikat 6 dhe 7 të Kodit Zgjedhor parashikohet midis të tjerash se për çdo zonë zgjedhore, të paktën 30% e listës shumë-emërore dhe një në tre emrat e parë të listës shumë-emërore duhet t'i përkasë secilës gjini. Subjekti paraqitës i listës deklaron vendet, sipas kuotës gjinore. Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, për çdo këshill bashkie, një në çdo dy emra të njëpasnjëshëm në renditje duhet t'i përkasë së njëjtës gjini. Në rast mospërbushjeje të njërit prej kushteve të parashikuara në këtë nen, në lidhje me përbërjen e listës shumë-emërore KQZ-ja zbaton sanksione.

Neni 175 i Kodit Zgjedhor, i cili parashikon sanksionet në lidhje me barazinë gjinore ka gjetur disa herë ndryshime me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012 dhe me ligjin nr. 31/2015, datë 2.4.2015. Në përmbajtjen e tij parashikohet midis të tjerash se mospërbushja nga ana e subjektit zgjedhor e detyrimeve të parashikuara në pikën 6, të nenit 67, të këtij Kodi, në lidhje me përbërjen e listës, dënohet nga KQZ-ja me gjobë 1 000 000 lekë si dhe sanksionin plotësues, sipas pikës 2 të këtij neni, në rastin e zgjedhjeve për Kuvendin, dhe me refuzimin e listës së partisë politike të kandidatëve për këshillat bashkiakë, për zgjedhjet për organet e pushtetit vendor. Kur ndaj një subjekti zgjedhor është konstatuar shkelja, KQZ-ja zbaton si sanksion plotësues zëvendësimin e çdo vakance në listën e subjektit, në zonën ku është konstatuar shkelja, me kandidatët vijues në listë nga gjinia më pak e përfaqësuar deri në plotësimin e kuotës gjinore. Sanksionet e përcaktuara në këtë nen vendosen për çdo zonë zgjedhore ku konstatohet shkelja.

Në dispozitat e mësipërme vihet re së pari se ekzistojnë dy standarde ligjore për kuotën gjinore. Në rastin e zgjedhjeve politike parlamentare kjo

kuotë është 30% ndërsa në rastin e zgjedhjeve vendore është 50%. Së dyti, barazia gjinore vihet re vetëm në pjesëmarrje në zgjedhje dhe garën politik, por nuk gjen si konfigurim fundor prezencën reale të përqindjes së grave në organet politike vendimmarrëse, çka e bën formale kandidimin e tyre. Po ashtu sanksionet e vendosura kanë qenë shpesh të buta dhe shpesh partitë politike janë përballur me dashje me këto të fundit për të anashkaluar pengesën gjinore duke vendosur burra në listat emërore. Të gjitha këto praktika e kanë vendosur barazinë gjinore të parashikuar në kodin zgjedhor në një ngërç, i cili nuk garanton zbatimin efektiv të këtij parimi të rëndësishëm. Rreptësimi i sanksioneve për shkeljet e neneve dhe rregullave të sipërpërmendura shihet si i domosdoshëm për garantimin e barazisë gjinore.

Së fundmi, një grupi deputetësh kanë paraqitur për shqyrtim dhe miratim në Kuvend një nismë legjislative, e cila ka si qëllim kryesor aplikimin e kuotave gjinore për listat shumë-emërore të partive politike dhe të koalicioneve në zgjedhjet e përgjithshme në masën 50%. Ky grup pranon midis të tjerash se me gjithë kërkesën e Kodit Zgjedhor për një kuotë 30 për qind për gratë në listat e kandidatëve për zgjedhje në çdo qark, partitë politike përfituan nga fakti që listat e deputetëve janë të mbyllura dhe i kandiduan gratë në fund të listës, ku shanset e tyre për t'u zgjedhur qenë minimale.

11.5 ANALIZË E LIGJIT MBI PARTITË POLITIKE NË ASPEKTIN GJINOR

Ligji nr. 8580, datë 17.2.2000 ndryshuar me ligjin nr. 10374, datë 10.2.2011 dhe Ligjin nr. 17/2014, datë

20.2.2014 dhe Ligjin nr. 25/2014, datë 25.9.2014 "Për Partitë Politike" rregullon organizimin dhe funksionimin e subjekteve politike duke filluar me parimet e organizimit të tyre, krijimin dhe regjistrimin në gjykatë, mënyrën e funksionimit dhe duke përfunduar me lehtësitë që përfitojnë nga shteti dhe mënyrën e financimit dhe raportimit të shpenzimeve në KQZ. Megjithëse ky ligj ndalet në një sërë çështjesh të detajuara të krijimit të partisë duke përcjellë parimet kryesore pa të cilat një subjekt politik nuk mund të krijohet sipas ligjit, ligji ka një boshllëk lidhur me përmbajtjen e barazisë gjinore politike. Kjo tregon se ai nuk është ende i harmonizuar me ligjet e tjera të përmendura më lart që rregullojnë këtë fushë.

Për këtë qëllim nevojitet që ky ligj të gjejë një amendim të shpejtë për të qenë konform të gjithë frymës së akteve të tjera, duke vendosur një kusht për barazitë në gjinore që me krijimin e partive politike, të cilat duhet ta sanksionojnë këtë si rregull themelor edhe në statutet e tyre. Saksionimi i normave dhe parimeve të përfaqësimit gjinor në strukturat drejtuese të partive politike do të ishte hap më i rëndësishëm dhe më jetëgjatë sesa rregullat elektorale periodike për jetësimin e këtij përfaqësimi. Kuotat dhe përfaqësimi proporcional brenda partive krijojnë një kulturë të re politike brenda partive, krijojnë shanse për qasje të re ndaj problematikave gjinore, detyron partitë të jenë më konkurruese në raport me votuesit e dy gjinive si dhe krijojnë mekanizma garancie të shprehura përmes programit politik me elementë ligjorë, si dhe përmes rritjes së cilësisë së përfaqësimit në dy gjinitë.

ANEX B

12 PJESËMARRJA E GRAVE NË PARTI POLITIKE – KROACIA DHE SLOVENIA

Argumenti për rritjen e pjesëmarrjes së grave në institucione politike është normativ dhe praktik. Në aspektin normativ, diskutimi fokusohet tek hendeku që ekziston ndërmjet gjinive dhe dominimin e sferës politike nga burrat. Nga ana tjetër, rritja e mundësive të grave për tu bërë pjesë e sistemit politik ka implikime praktike në politik-bërje dhe vendimmarrje.⁶¹ Angazhimi i vendeve të ndryshme në promovimin e grave në politikë ka marrë ka marrë më së shumti formën e kuotave gjinore në listat e kandidatëve të zgjedhur në poste publike. Pavarësisht natyrës së debatueshme të kuotave gjinore dhe impaktit të tyre në rritjen e numrit të grave në politikë, studime të ndryshme kanë treguar se përfshirja e tyre në legjislacion i ndihmon gratë të arrijnë pozicione udhëheqëse në parti.

Përpjekjet e lëvizjes feministe në Kroaci për të rritur pjesëmarrjen e grave në politikë në mënyrë cilësore dhe sasiore shkojnë pas në dekadën e parë pas shpërbërjes së Jugosllavisë. Kushtet e krijuara nga

ndryshimi i regjimit, fushata advokuese dhe ndryshimi i sistemit elektoral u shoqërua me një rritje prej 70% të përfaqësimit të grave në parlamentin kroat. Ky kapërcim i konsiderueshëm u arrit në periudhën para adoptimit të kuotave gjinore në vitin 2008. Që prej asaj kohe përqindja e grave në parlament ka mbetur pothuajse e pandryshuar.⁶² Pavarësisht përqindjes së ulët të grave të zgjedhura në parlamentin e vitit 2015 mbetet të theksohet se përqindja e kandidateve gra në këto zgjedhje pësoi një rritje nga 24% në 41%. Në partitë politike gratë përbëjnë afërsisht 32% të anëtarëve.⁶³

Akti i barazisë gjinore, miratuar në vitin 2008, sanksionon se çdo parti politike pjesë e Regjistrisë të partive politike duhet të adoptojë një plan veprimi çdo katër vite sa i përket përfaqësimit të barabartë gjinor, plan në të cilin duhet të parashtrohen metodat për promovimin e një përfaqësimi më të balancuar të grave dhe burrave në organet e partisë, në listat e kandidatëve për parlamentin kroat dhe organet e

61 Llubani, Megi & Arqimandriti, Mirela, Albanian Women Participation in Politics and Decision-Making, Discussion Paper, November 2015: http://www.swedenabroad.com/~/media/VaultFiles/aid_38954/efcf_347e/Women_in_Politics.PDF

62 Sirocic, Zorica, Formulation, Adoption and Implementation of Gender Quotas in Croatia, 2014, Online: <https://www.ecpr.euw/Files/ewPaperProposals/c225c7bd-7b0e-42b7-81fa-1dd2c6d6dd51.pdf>

63 The Dubrovnik Times, Gender Equality an issue in Croatia, August 2016, Online: <http://www.thedubrovniktimes.com/news/croatia/witemw920-gender-equality-an-issue-in-croatia-parliament>

qeverisë lokale.⁶⁴ Më tej, neni 12 i Aktit parashikon përfshirjen në masën 40% të seksit më pak të përfaqësuar në poste politike dhe publike, duke e zgjeruar kështu sferën e aplikimit të ligjit, i cili parashikon se kjo përqindje duhet të arrihet përmes "rritjes graduale të seksit të nën-përfaqësuar jo më vonë se në implementimin e zgjedhjeve të treta të rregullta pas hyrjes në fuqi të aktit".⁶⁵

Si anëtare e re e Bashkimit Evropian Kroacia ka arritur në disa aspekte mesataren e vendeve të tjera anëtare sa i përket barazisë gjinore. Grafiku më poshtë paraqet përqindjen e grave në poste vendimmarrëse, krahasuar me mesataren e 27 vendeve të tjera anëtare të Bashkimit Evropian. Veçanërisht në fushën ligjvënëse dhe atë të biznesit Kroacia është më pranë mesatares së BE-së.

Dispozita të ngjashme ligjore mbi barazinë gjinore në jetën politike gjenden në Slloveni. Kuotat gjinore për listat e kandidatëve të partive politike janë zhvilluar në mënyrë graduale duke kaluar nga 30 në 40%. Megjithëse deri në vitin 2008 numri i grave në parlamentin slloven ishte relativisht i ulët, 13.3%, në zgjedhjet e vitit 2011 kjo përqindje u dyfishua pothuajse, duke e rritur përfaqësimin e grave në 32.2%. Një prej arsyeve kryesore të këtij ndryshimi ishte studimi i ndërmarrë nga Lobi i Grave i Sllovenisë, i cili doli në përfundimin se "suksesi i kandidatëve gra dhe burra varet nga sa përzgjedhëse është zona elektorale ku ai ose ajo kandidon." Publikimi i raportit pak kohë para zgjedhjeve krijoi presione të jashtme dhe ndërgjegjësim ndër kandidatet gra se duhet

64 Neni 15, Akti i Barazisë Gjinore

65 Neni 15ë2

të zgjidhnin me kujdes zonën elektorale ku do të kandidonin në mënyrë që të rrisnin shanset për të fituar zgjedhjet. Si rezultat, partitë që morën pjesë në zgjedhje prezantuan në listat e tyre 41.7% gra duke rezultuar në 32.2% të përfaqësuar në parlament, që më pas arriti 34.4% për shkak të lëvizjeve të ndryshme brenda partive fituese.


Sllovenia pothuajse e ka arritur qëllimin e vendosur në Aktin Zgjedhor të Asamblesë Kombëtare në zgjedhjet e dyta që pas vendosjes së kuotave si detyrim ligjor.⁶⁶ Kuotat gjinore kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e pjesëmarrjes cilësore dhe sasiore të grave në jetën politike. Në periudhën nga 2004 deri në 2014 përqindja e grave në politikë në nivel qendror dhe lokal është dyfishuar. Disa elementë që kanë ndikuar në suksesin e kuotave gjinore përfshijnë mënyrën se si kuotat janë formuluar duke përdorur termin gjini në vend të "përfaqësimi i grave", impakti i konsiderueshëm i sanksioneve që i detyron partitë politike të respektojnë kuotat e vendosura dhe aplikimi i tyre në të tri nivelet e qeverisjes.⁶⁷

Megjithatë, duhet theksuar se si në rastin e Kroacisë ashtu edhe në rastin e Sllovenisë aplikimi i kuotave gjinore nuk është mekanizëm i mjaftueshëm. Ato duhen shoqëruar me vullnet politik, ndërgjegjësim dhe presion të jashtëm për të ofruar mundësi të barabarta për të dyja gjinitë. Një prej fushatave më

66 Ples, Tanja, Nahtigal, Klara & Ples, Angela, Women in Politics in Slovenia July 2013, Institute for Social Creativity, July 2013. Online: http://www.millennia2015.orgwfileswPublicationswSC_women_politics_slovenia.pdf

67 European Commission, Women in Political Decision-Making, Discussion Paper, June 2016. Online: http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/files/exchange_of_good_practice_si_si_discussion_paper_si_2016_en.pdf

Gratë në vendimmarrje



të suksesshme u organizua në vitin 2010 nga Lobi i Grave, titulluar 50-50 konceptuar si "presion i organizuar ndaj udhëheqjes së partive politike gjatë fushatës zgjedhore për të rritur pjesëmarrjen e grave dhe kandidimin e tyre në zgjedhjet lokale".⁶⁸

Sa i përket funksionimit të partive politike, Akti i Mundësive të Barabarta parashikon që partitë politike

të regjistruara duhet të miratojnë çdo katër vite një plan në të cilin duhet të mbajnë një qëndrim për çështjet e përfaqësimit të balancuar ndërmjet grave dhe burrave dhe në përputhje me këtë pozicion të përcaktojnë metoda dhe masa për promovimin e një përfaqësimi më të drejtë e të barabartë brenda organeve të partisë, në listat e kandidatëve si edhe në zgjedhjet për president.

68 Ples, Tanja, Nahtigal, Klara & Ples, Angela, Women in Politics in Slovenia July 2013, Institute for Social Creativity, July 2013. Online: http://www.millennia2015.org/files/files/Publications/ISC_women_politics_slovenia.pdf